

PROGRAMI

I

ZONES FUNKSIONALE TROPOJE

Realizuar nga: **Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës
Teknike (ANTTARC)**

Përgatitur për: **Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (dldp)**

Dorëzuar me: **Prill 2015**

PERMBAJTJA

| | | Faqe |
|--------------|---|-------------|
| A | ANALIZA E ZONES FUNKSIONALE TROPOJE | |
| 1 | PERSHKRIM I PERGJITHSHEM I ZONES FUNKSIONALE | 4 |
| 1.1 | Territori i zonës funksionale | 4 |
| 1.2 | Historia, kultura, traditat, atraksionet kryesore | 5 |
| 1.3 | Demografia | 6 |
| 1.4 | Tiparet kryesore të Zonës Funktionale Tropojë | 10 |
| 2 | EKONOMIA E ZONËS FUNKSIONALE TROPOJË | 12 |
| 2.1 | Të dhëna të përgjithshme mbi ekonominë e zonës funksionale | 12 |
| 2.2 | Tregu i punës dhe struktura e punësimit/papunësisë | 17 |
| 2.3 | Ndërveprimet ekonomike të zonës funksionale | 20 |
| 3 | ANALIZA E THELLUAR E EKONOMISË SË ZONËS FUNKSIONALE | 22 |
| 3.1 | Bujqësia dhe blektoria | 22 |
| <i>3.1.1</i> | <i>Bujqësia</i> | 22 |
| <i>3.1.2</i> | <i>Blektoria</i> | 29 |
| <i>3.1.3</i> | <i>Konkluzione dhe rekomandime</i> | 35 |
| 3.2 | Turizmi | 37 |
| <i>3.2.1</i> | <i>Atraksionet turistike</i> | 37 |
| <i>3.2.2</i> | <i>Kapacitetet akomoduese</i> | 38 |
| <i>3.2.3</i> | <i>Zhvillimi i turizmit në rajon</i> | 39 |
| <i>3.2.4</i> | <i>Konkluzione dhe rekomandime</i> | 44 |
| 3.3 | Ndërveprimet ekonomike në zonën funksionale | 46 |
| 4 | SHERBIMET PUBLIKE NE ZONEN FUNKSIONALE TROPOJË | 48 |
| 4.1 | Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet | 48 |
| <i>4.1.1</i> | <i>Të dhëna të përgjithshme për mbulimin me shërbim</i> | 48 |
| <i>4.1.2</i> | <i>Problematikat kryesore</i> | 50 |
| <i>4.1.3</i> | <i>Infrastruktura e shërbimit të furnizimit me ujë dhe trajtimi i ujrave të ndotura (kanalizimet)</i> | 50 |
| <i>4.1.4</i> | <i>Struktura menaxhuese</i> | 51 |
| <i>4.1.5</i> | <i>Përmbledhje e gjetjeve kryesore</i> | 52 |
| <i>4.1.6</i> | <i>Rekomandime për organizimin/integrimin e shërbimit në njësinë e re</i> | 52 |

| | | |
|------------|---|-----|
| 4.2 | Menaxhimi i mbetjeve | 53 |
| 4.2.1 | <i>Përshkrimi i situatës aktuale të shërbimit</i> | 53 |
| 4.2.2 | <i>Problematika kryesore e ZFT lidhur me menaxhimin e mbetjeve</i> | 59 |
| 4.2.3 | <i>Hapat për integrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve midis NJQV-ve pjesë e Zonës Funktionale Tropojë</i> | 60 |
| 4.2.4 | <i>Gjetjet kryesore lidhur me menaxhimin e mbetjeve</i> | 62 |
| 4.2.5 | <i>Rekomandime lidhur me menaxhimin e mbetjeve</i> | 64 |
| 4.3 | Rrugët dhe transporti publik | 65 |
| 4.3.1 | <i>Aksesi për në Zonën Funktionale Tropojë</i> | 68 |
| 4.3.2 | <i>Transporti brenda Tropojës</i> | 68 |
| 4.3.3 | <i>Investimet në sistemin e rrugëve</i> | 70 |
| 4.3.4 | <i>Transporti publik</i> | 70 |
| 4.3.5 | <i>Menaxhimi dhe financimi i rrugëve/transportit</i> | 72 |
| 4.3.6 | <i>Gjetjet kryesore lidhur me rrugët dhe transportin publik</i> | 72 |
| 4.3.7 | <i>Rekomandime lidhur me rrugët dhe transportin publik</i> | 73 |
| 5 | ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE TË QEVERISJES LOKALE NË ZFT | 74 |
| 5.1 | Shërbimet kryesore që ofrohen nga NJQV-të dhe shpërndarja e tyre | 74 |
| 5.2 | Organizimi vendor dhe struktura e personelit | 76 |
| 5.3 | Buxhetet e Njësive Vendore | 79 |
| 5.4 | Strategjitë lokale të zhvillimit | 79 |
| B | PROGRAMI I ZONES FUNKSIONALE | 80 |
| 6 | VIZIONI I ZONËS FUNKSIONALE | 80 |
| 7 | PROJEKT-IDETË KRYESORE PER ZONËN FUNKSIONALE TROPOJE | 81 |
| 7.1 | Projekt-ide të zhvillimit ekonomik | 81 |
| 7.2 | Projekt-ide të shërbimeve publike | 95 |
| 8 | PËRSHKRIMI I STRUKTURAVE DHE PROCESIVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË ZONËS: ORGANIZIMI I QEVERISJES LOKALE PAS REFORMËS TERRITORIALE-ADMINISTRATIVE | 116 |
| 9 | PROCESI I PREGATITJES SË PROGRAMIT TË ZONËS FUNKSIONALE TROPOJË | 118 |
| C | ANEKSE | 120 |

1. PERSHKRIM I PERGJITHSHEM I ZONES FUNKSIONALE¹ TROPOJE

1.1. Territori i Zonës Funktionale Tropojë

Zona Funktionale e Tropojës (ZFT) korrespondon me rrethin e Tropojës që bën pjesë në Qarkun e Kukësit së bashku me Kukësin dhe Hasin. Në përbërjen e saj janë tetë Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV) përfshirë Bashkinë e Bajram Currit dhe Komunat e Bujanit, Bytyçit, Fierzës, Lekbibajt, Llugajt, Margegajt, dhe Tropojës (shih harta 1). Këto NJQV përmbledhin 54 fshatra.

Harta 1: Rrethi i Tropojës



Tropoja ndodhet në verilindje të Shqipërisë dhe kufizohet në veri me Malin e Zi, në jug me Rrethin e Hasit, në perëndim me Qarkun e Shkodrës (rrethin e Shkodrës dhe të Pukës) dhe në lindje me Kosovën. Pjesa më e madhe e Tropojës përbëhet nga pjesa lindore e Alpeve të Shqipërisë. Kufiri me Malin e Zi dhe me Kosovën është përkatësisht 31 dhe 81 km.

Rrethi i Tropojës ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 1043 km katror. Distanca e Bajram Currit nga kryeqyteti i vendit Tiranë është 262 km.

Emri i zonës lidhet me fshatin Tropojë i cili, nga viti 1925 e deri në vitin 1952, ka qenë qendra administrative e këtij rrethi. Që nga viti 1952, qendër administrative e rrethit u bë qyteti Bajram Curri, i cili u ndërtua në ish fshatin Kolgecaj, në Pellgun e Tropojës, rrëzë bjeshkëve të Bishevës dhe Ponarit. Qyteti ka marrë emrin nga Heroi i Popullit Bajram Curri (1862-1925), figurë e shquar shqiptare për pavarësi dhe liri si para dhe pas shpalljes së pavarësisë së vendit.

¹ Termi zonë funksionale i referohet konceptit se kuptimi i një hapësire—në cfarëdo niveli, bashki, rajon, etj.—nuk përcaktohet sipas kufijve administrativë apo historikë, por në bazë të ndërveprimit që ndodh konkretisht në këtë hapësirë. (Studimi i Zonave Funktionale në Shqipëri. dldp. 2014)

Tropoja është një zonë malore. Pjesën më të madhe të sipërfaqes e zënë malet e larta. Në këtë zonë ndodhet edhe maja e dytë më lartë në Shqipëri, Jezerca me 2693 m. Lartësia mesatare e rrethit është ndër më të lartat në Shqipëri—1105 metër mbi nivelin e detit.

Klima në Tropojë është malore në zonën e Alpeve dhe mesdhetare kontinentale në pjesën tjetër. Temperatura mesatare në pellgun e Tropojës është 11.5°C, 0.2°C në dimër dhe 21°C në verë. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është rreth 1735 mm. Gjatë muajve të dimrit bie borë, sidomos në zonat më të larta. Ka maja malesh ku dëborat nuk shkrihet asnjëherë. Erërat fryjnë nga veriu—“Veriu i zi” nga verilindja nëpërmjet Qafës së Morinës dhe “Veriu i bardhë” nga veriu nëpërmjet luginës së lumit të Gashit—që sjellin masa ajri të ftohta dhe “Era” që fryn nga jugu përgjatë Luginës së Valbonës dhe sjell masa ajri të ngrohta e me lagështi.

1.2. Historia, kultura, traditat dhe atraksionet kryesore

Tropoja, ose sic njihet tradicionalisht Malësia e Gjakovës, është banuar që në periudhën e hershme të hekurit. Në kohën e ilirëve, kjo zonë ka qenë e populluar nga fisi i Dardanëve. Rosuja ka qenë qendra më e njohur qytetare në kufirin mes labeatëve dhe dardanëve dhe daton 400 vjet para lindjes së Krishtit. Gjatë Perandorisë Osmane, Tropoja ishte pjesë e Vilajetit të Kosovës. Para Luftës së Dytë Botërore, Tropoja së bashku me Hasin dhe Kukësin ishte pjesë e Prefekturës së Kosovës që ishte një nga 10 zonat administrative të Shqipërisë. Deri në fillimin e viteve 1990 (1959-1991), Tropoja ishte një nga 26 rrethet e vendit. Aktualisht, ajo është pjesë e qarkut të Kukësit.

Përcaktimi i kufijve në vitin 1913 la Kosovën jashtë Shqipërisë. Tropojën e ndau nga tregu i saj historik/tradicional—Gjakova. Tropoja/Malësia e Gjakovës ka pasur gjithmonë lidhje të ngushta të gjithanshme me qytetin e Gjakovës që para 1913 ishte ndër qendrat më të rëndësishme zejtarotregëtare të Vilajetit të Kosovës. Vendosija e kufirit shtetëror përgjithësisht armiqësor midis Shqipërisë dhe ish-Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene dhe pasueses së saj ish-Jugosllavisë dhe vështirësia për të komunikuar lirisht me pjesën tjetër të vendit për shkak të maleve të lartë dhe infrastrukturës rrugore të keqe, e izoloj Tropojën për dekada dhe vështirësoi edhe më shumë gjendjen ekonomike dhe shoqërore të banorëve të saj. Me çlirimin e Kosovës në vitin 1999, lidhjet tradicionale dhe ndërveprimi me Gjakovën dhe pjesën tjetër të Kosovës u rivendosën. Tani popullsia e Tropojës ka mundësinë e aksesit në tregjet, shkollat, apo spitalet e Kosovës. Tropoja ndodhet rreth 260 km larg Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë, dhe 120 km larg Prishtinës, kryeqytetit të Kosovës. Edhe rruga më e lehtë për në Tiranë, tani kalon nëpërmjet Kosovës—Bajram Curri-Gjakovë-Prizren-Kukës-Tiranë. Ndërtimi i Rrugës së Kombit (Shqipëri) dhe autostradës “Ibrahim Rugova” (Kosovë) e ka lehtësuar transportin për Tiranë dhe Prishtinë.

Tropoja është e njohur për bukuritë dhe pasuritë e saj natyrore. Alpet në zonën e Tropojës përbëhen nga male të larta dhe të thepisur dhe shumë tërheqës si pasojë e veprimit të akullnajave dhe erozionit, me kullota të pasura alpine. Ka kontraste të theksuara të lartësive, me qafa të kalueshme dhe lugina të thella që përshkohen nga lumenj të vegjël e që banojnë deri në thellësi të tyre. Në Alpe gjenden dy fshatra piktoresk, Valbona (fshati nga buron lumi Valbona) dhe Currajt e Epërm në krahinën e Nikaj Mërturit.

Një ndër atraksionet kryesore të Tropojës, por edhe të Shqipërisë, është Lugina e Valbonës që është Park Natyror Kombëtar. Ajo është zona malore më e vizituar në Shqipëri pas Thethit. Ajo vizitohet masivisht nga turistë të huaj dhe vendas. Ngjitja në ujëvarën dhe përgjatë lumit të Valbonës është një ndër eskursionet më popullore. Lugina e Valbonës e ka marrë emrin nga lumi i Valbonës që është rreth 50 km i gjatë dhe nis nga Qafa e Valbonës dhe përfundon në luginën e Drinit, pranë digës së hidrocentralit të Fierzës. Prurjet mesatare në Dragobi dhe Gri janë përkatësisht 12.2 m³/sekondë dhe 33.3 m³/sekondë. Lumi ka ujë të ftohtë dhe të kulluar, më të pastrin në Shqipëri, ujëvara—veçanërisht ujëvara e Rragamit është një mrekulli e natyrës—dhe ka krijuar kanione piktoreske. Lumi i Valbonës është i pasur me “troftën pikalosse”. Përgjatë luginës së Valbonës janë ndërtuar dhe/ose adaptuar disa hotele dhe shtëpi pritëse për turistët. Parku Natyror Kombëtar i Valbonës ndodhet 23 km larg nga qyteti i Bajram Currit.

Në Luginën e Valbonës, hotelet dhe shtëpitë pritëse gatujnë dhe shërbejnë gatime tradicionale si maza, flija, mishi i pjekur i qingjit dhe kecit, etj.

Atraksione të tjera të rëndësishme janë kanioni i Shoshan (3 km larg Bajram Currit) dhe luginat e lumejve të Currajt, Gashit dhe Tropojës. Tropoja ka një ndër vargmalet më të bukura në Shqipëri dhe rajon.

Zona e Tropojës ka etnografi dhe folklor të pasur. Kostumet popullore janë të bukura dhe të larmishme në ngjyra dhe motive, veçanërisht ato të grave. Elementët më të përhapur të veshjes popullore janë tek burrat tirqit e bardhë me gajtana të zi dhe kapuçi i bardhë dhe tek gratë pështjellaku i gjerë ku mbizotëron ngjyra e kuqe dhe xhubleta (në Nikaj-Mërtur). Vallet e Tropojës shquhen për dinamizmin, epizmin dhe lirizmin e tyre.

Në qendër të qytetit Bajram Curri ngrihet ndërtesa e Muzeut Historik të rrethit që dallohet për arkitekturën karakteristike, të ngjashme me atë të kullave të Malësisë së Gjakovës. Pranë muzeut ngrihet dhe statuja e Heroit të Popullit Bajram Curri.


Malësia e Gjakovës ka një kontribut të shquar në luftërat e popullit shqiptar për pavarësi dhe liri.

1.3. Demografia


Tropoja ka një popullsi prej 20,491 banorë (sipas censusit të vitit 2011). Ka një ndryshim të ndjeshëm midis të dhënave të censusit dhe numrit të popullsisë së regjistruar prej 28,216 (në vitin 2014). 75% e popullsisë jeton në zonat rurale. Dendësia mesatare e popullsisë është 20 banorë për km². Ndonëse kanë një territor relativisht të madh, komunat e Tropojës kanë një popullsi të vogël. Popullsia mesatare për njësi vendore është 2,536 banorë, shumë e ulët krahasuar jo vetëm me mesataren kombëtare (8,016 banorë) por edhe me atë të Qarkut të Kukësit (3,159 banorë). Më shumë se 25% e popullsisë banon në Bashkinë e Bajram Currit që ka një dendësi relativisht të lartë krahasuar me komunat--1749 banorë/km². Njësitë e Qeverisjes Vendore përreth Bashkisë Bajram Curri kanë dendësi më të lartë të popullsisë (rreth 33

banorë/km²) se ato më periferike (nën 28 banorë/km²). Njësitë më të vogla të Qeverisjes Vendore nga pikëpamja e popullsisë janë komunat Lekbibaj dhe Bytyç përkatësisht 1,207 dhe 1,563 banorë. Grafiku 1, 2&3 dhe Harta 2 japin të dhëna për dendësinë e popullsisë sipas NJQV-ve. Sipërfaqja relativisht e madhe, territori malor, dhe dendësia e vogël e popullsisë kanë bërë që banorët e komunave të largëta të kenë problem me ofrimin e shërbimeve publike.


Grafiku 1: Popullsia sipas NJQV-ve




Grafiku 2: Sipërfaqja e NJQV-ve



Grafiku 3: Dendësia e popullsisë sipas NJQV-ve



Harta 2: Dendësia e popullsisë sipas NJQV-ve



Burimi: Censuri 2011

Tropoja ka një popullsi relativisht të re në moshë. Sipas Censurit të vitit 2011, rreth 25% e popullsisë është nga moshën 0-14 vjeç dhe rreth 63% e popullsisë nga moshën 14-65 vjeç. Struktura e popullsisë së rrethit Tropojë të ndarë sipas grupmoshave dhe gjinisë paraqitet në


Tabelën 1 dhe Grafikon 4. Sipas NJQV-ve, struktura e popullsisë sipas grupmohave është paraqitur në Grafikon 5.

Tabela 1: Popullsia banuese sipas gjinisë, grupmohës bashkisë/komunës

| Bashkia/Komuna | Gjinia dhe grup moshë | | | | | | | | | | | |
|--------------------|-----------------------|------|-------|------|----------|------|-------|------|----------|------|-------|------|
| | Gjithsej | | | | Meshkuj | | | | Femra | | | |
| | Gjithsej | 0-14 | 15-64 | 65+ | Gjithsej | 0-14 | 15-64 | 65+ | Gjithsej | 0-14 | 15-64 | 65+ |
| BAJRAM CURRI | 5340 | 1406 | 3497 | 437 | 2717 | 774 | 1751 | 192 | 2623 | 632 | 1746 | 245 |
| BUJAN | 2550 | 565 | 1636 | 349 | 1277 | 302 | 803 | 172 | 1273 | 263 | 833 | 177 |
| BYTYÇ | 1563 | 419 | 968 | 176 | 786 | 216 | 480 | 90 | 777 | 203 | 488 | 86 |
| FIERZË | 1607 | 395 | 1015 | 197 | 803 | 224 | 477 | 102 | 804 | 171 | 538 | 95 |
| LEKBIBAJ | 1207 | 338 | 786 | 83 | 622 | 188 | 395 | 39 | 585 | 150 | 391 | 44 |
| LLUGAJ | 1787 | 424 | 1147 | 216 | 893 | 231 | 555 | 107 | 894 | 193 | 592 | 109 |
| MARGEGAJ | 2346 | 577 | 1470 | 299 | 1174 | 307 | 722 | 145 | 1172 | 270 | 748 | 154 |
| TROPOJË | 4117 | 1006 | 2643 | 468 | 2145 | 564 | 1368 | 213 | 1972 | 442 | 1275 | 255 |
| Gjithsej - TROPOJE | 20517 | 5130 | 13162 | 2225 | 10417 | 2806 | 5183 | 1060 | 10100 | 2324 | 6611 | 1165 |


Burimi: Censusi 2011

Grafiku 4: Popullsia sipas NJQV-ve dhe grupmohave



Burimi: Censusi 2011

Grafiku 5: Popullsia sipas grupmohave



Përsa i përket arsimit, i gjithë territori i rrethit është i mbuluar me kopshte për fëmijë dhe shkolla 9-vjeçare dhe të mesme. Sidoqoftë, për shkak të sipërfaqes së madhe dhe dendësisë së ulët të popullsisë së komunave, ka një numër të madh kopshtesh dhe shkollash 9-vjeçare për një numër të vogël fëmijësh dhe nxënësish. Për shembull, në se në Bashkinë Bajram Curri ka 4 kopshte për 296 fëmijë (ose mesatarisht 78 fëmijë për kopësht) dhe 3 shkolla 9-vjeçare për 1,066 nxënës (ose mesatarisht 355 nxënës për shkollë), komuna si Lekbibaj ka vetëm një kopësht për 15 fëmijë dhe 8 shkolla për 202 nxënës (ose mesatarisht 15 nxënës për shkollë). Shkolla e mesme e qytetit Bajram Curri ju shërben edhe komunave afër bashkisë si Bujan dhe Margegaj apo atyre me popullsi të vogël si Lekbibaj. Komunitat e tjera kanë shkolla të mesme, por që janë të vogla (kanë

një numër të vogël nxënësish dhe mësuesish—mesatarisht 5 mësues për 50—70 nxënës). Tabela 2 paraqet gjendjen e sektorit të arsimit në ZFT.

Tabela 2: Arsimi në Tropojë

| NJQV | Kopshte | | 9-vjeçare | | | Të mesme | | |
|------------------|---------|--------|-----------|--------|--------|----------|--------|--------|
| | # | F`mijë | # | Nxënës | Mësues | # | Nxënës | Mësues |
| Bajram Curri | 4 | 296 | 3 | 1066 | 72 | 1 | 624 | 35 |
| Bujan | 5 | 75 | 6 | 192 | 25 | | | |
| Bytyç | 3 | 35 | 10 | 260 | 28 | 2 | 101 | 10 |
| Fierze | 1 | 15 | 5 | 297 | 30 | 1 | 86 | 6 |
| Lekbibaj | 1 | 15 | 8 | 202 | 42 | | | |
| Llugaj | 2 | 32 | 3 | 255 | 25 | 1 | 70 | 5 |
| Margegaj | 3 | 51 | 4 | 259 | 29 | | | |
| Tropojë | 6 | 95 | 12 | 589 | 165 | 1 | 124 | 10 |
| Gjithsej TROPOJE | 25 | 614 | 51 | 3120 | 416 | 6 | 1005 | 66 |

Burimi: Zyra e Arsimit, Tropojë, 2014

Ndonëse e tërë zona është e mbuluar me ambulancë (pothuajse në çdo fshat relativisht të madh ka ambulancë) dhe qendër shëndetësore (ka në çdo komunë), numri i mjekëve dhe infermierëve është i kufizuar. Spitali i qytetit të Bajram Currit ka rreth 100 shtretër. Ai ka pavionet kryesore si patologji, pediatri, kirurgji, dhe obstetri-gjinekologji. Sidoqoftë, për ndërhyrje të specializuara të sëmurët ju drejtohen spitaleve të Kukësit dhe Tiranës. Tabela 3 përmbledh të dhënat për sektorin e shëndetësisë në ZFT.

Tabela 3: Sektori i shëndetësisë


| Institucioni shëndetësor | # i institucioneve | # i shtretërve | Mjekë | Infermierë |
|----------------------------|--------------------|----------------|-----------|------------|
| <i>Spital</i> | 1 | | 13 | 133 |
| Pathology | √ | 26 | | |
| Pediatri | √ | 30 | | |
| Kirurgji | √ | 20 | | |
| Obstetri-Gjinekologji | √ | 25 | | |
| <i>Qendra Shendetesore</i> | 8 | | | |
| <i>Ambulanca</i> | 33 | | | |

Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës (2012)


Të dhënat sociale dhe demografike për ZFT janë të varfëra. Sipas Raportit të Zonave Funktionale (UNDP, 2014), për të gjithë ZFT, ka vetëm një qendër kulturore, një qendër sociale dhe një qendër sportive në qytetin e Bajram Currit.

Megjithëse është një rreth me pasuri të shumta natyrore, mungesa e investimeve të mjaftueshme dhe e perspectiveës së zhvillimit ka detyruar një pjesë të konsiderueshme të banorëve të largohen drejt Tiranës dhe Durrësit ose jashtë vendit. Migrimi, si pjesë e zhvillimit demografik të rajoneve por edhe treguesi ndryshimeve sociale, është ndër faktorët negativë që ka ndikuar në zhvillimin e zonës së Tropojës. Një ndër arsytet është sepse nga Tropoja janë larguar njerëzit që kanë pasur arsimim dhe aftësinë. Grafikut 6 dhe 7 tregojnë lëvizjen e popullsisë nga Tropoja në dekadën e fundit dhe përqindjen sipas NJQV-ve. Vihet re se lëvizja më e madhe e popullsisë i përket komunës së Lekbibaj. Kjo shpjegohet edhe me kushtet natyrore dhe mungesat në shërbime për banorët e kësaj komune të largët malore.

Grafiku 6: Ndryshimet në numrin e popullsisë



Grafiku 7: Ndryshimet e popullsisë në % (2001-11)



Burimi: INSTAT, Tipologjia e Komunave dhe Bashkive 2014

1.4. Tiparet kryesore të Zonës Funktionale Tropojë

Nga pikëpamja e tipologjisë së zonave funksionale, Zona Funktionale Tropojë mund të konsiderohet zonë funksionale sipas modelit koncentrik. Zona funksionale përputhet me kufijtë e rrethit të Tropojës. Në qendër të zonës është Bashkia Bajram Curri që është tregu kryesor, qendra më e rëndësishme administrative dhe vendi ku ofrohen shumica e shërbimeve. Intensiteti i ndërveprimit është më i lartë midis qendrës—Bajram Currit—dhe NJQV-ve më afër saj. Dendësia e popullsisë në qendrën administrative—Bashkia Bajram Curri—është shumë më e lartë se sa në komuna. Dendësia e popullsisë jashtë qendrës ulet me rritjen e largësisë nga qendra.

Nga pikëpamje ekonomike, Tropoja është kryesisht një zonë bujqësore dhe blegtorale. Kohët e fundit ka marrë një zhvillim të konsiderueshëm turizmi malor. Minierat janë një sektor me potencial zhvillimi në të ardhmen.

Kulturat kryesore bujqësore që kultivohen janë drithërat e bukës—misri dhe gruri. Kulturat tjera janë perimet, vreshtat dhe drurët frutorë. Ndër drurët frutorë, më i përhapuri është kumbulla, veçanërisht “kumbulla e zezë” tropojane, molla “gjylalle” dhe sidomos gështenja që është një

ndër produktet më të rëndësishëm përsa i përket të ardhurave që mund të gjenerojnë. Një vend të rëndësishëm në të ardhurat lokale zenë edhe bimët medicinale, veçanërisht boronica. Në blegtori mbizotërojnë të leshtat. Delja “bardhoke” është e përmendur për prodhimtari të lartë të leshit, qumështit dhe mishit. Mbarështohen edhe dhitë, lopët, kuajt, pulat, dhe derri. Kullotat a pasura luajnë një rol të rëndësishëm në prodhimin dhe cilësinë e produkteve blektorale. Bleshkët e Gashit, Krasniqes dhe Bytyçit janë të pasura me kullota alpine. Bletaria, gjithashtu, është e përhapur në Tropojë. Është i njohur mjalti i Zogajve (Bytyçit) dhe i gështenjës (Krasniqe). Sidoqoftë, prodhimi bujqësor dhe blektoral është i destinuar kryesisht për plotësimin e nevojave të familjeve individuale në fshat dhe qytetin e Bajram Currit. Një pjesë e prodhimit bujqësor dhe blektoral shkon për të plotësuar nevojat e hoteleve dhe shtëpive pritëse që janë ndërtuar përgjatë Luginës së Valbonës dhe në qytetin e Bajram Currit. Vetëm një pjesë e vogël e këtij prodhimi është e destinuar për tregun kombëtar apo atë të Kosovës.

Turizmi malor është sektor kryesor. Ai është zhvilluar kryesisht në Luginën e Valbonës. Në këtë Luginë janë ndërtuar rreth 24 hotele dhe shtëpi pritëse. Turistët që vizitojnë Valbonën vijnë nga zonat e tjera të vendit por edhe nga jashtë, kryesisht Europa Qendrore. Ata vizitojnë Luginën e Valbonës, që është një ndër mrekullitë e natyrës shqiptare, por edhe ngjiten në male duke kaluar shpesh edhe nga Lugina e Valbonës në Theth. Hotelet dhe shtëpitë pritëse servirin kryesisht gatime tradicionale duke përdorur për këtë qëllim prodhime lokale bujqësore dhe blektorale. Në këtë kontekst sektorët e bujqësisë/blektorisë dhe turizmit malor janë të ndërlidhur ngushtë dhe mbështesin njeri-tjetrin. Ka një potencial të madh për zhvillimin e turizmit malor edhe në zona të tjera të Tropojës por edhe për zhvillimin e mëtejshëm të tij në Luginën e Valbonës. Përmirësimi i shërbimit për turistët qoftë në sasinë/shumëllojshmërinë e tyre ashtu edhe në cilësinë e tyre është një kusht për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dhe shndërrimin e tij në një burim thelbësor të ardhurash për popullsinë e Tropojës.

Minierat janë një tjetër sektor potencial i rëndësishëm. Sektori i industrisë është pak i zhvilluar. Vendin më të rëndësishëm e zë nxjerrja e mineralit të kromit në zonën minerare Rragam-Kam-Kepenek-Zogaj dhe nxjerrja e kuarcit në fshatin Kërnajë. Zona e Bytycit ka rezerva të mëdha të kromit. Por nxjerrja është e kufizuar. Ky sektor mund të jetë një sektor i rëndësishëm për ekonominë lokale. Zhvillimi i sektorit të minierave nuk do të ndikonte negativisht në zhvillimin e turizmit sepse ato janë të përqëndruara në rajone të ndryshme të zonës funksionale.

Vetëm 17 km larg qytetit Bajram Curri, aty ku bashkohet Valbona me Drinin, është ndërtuar Hidrocentrali i Fierzës (1978) që është një nga veprat më të mëdha energjetike në vend. Nga ndërtimi i tij është formuar liqeni artificial i Fierzës me një vëllim rreth 2.5 miliard metër kub ujë dhe një pellg ujëmbledhës prej rreth 11.829 km².

Megjithë pasuritë e shumta natyrore, Tropoja është një ndër zonat më të varfëra të vendit. Papunësia është në nivele të larta dhe një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave për familjet lokale vijnë nga emigracioni dhe asistenca ekonomike. Sidoqoftë, Zona Funktionale Tropojë është një zonë kryesisht bujqësore dhe blektorale me një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit malor si dhe industrisë minerare.

2. EKONOMIA E ZONËS FUNKSIONALE TROPOJË

2.1 Të dhëna të përgjithshme të zhvillimit ekonomik të ZF Tropojë

Niveli i zhvillimit ekonomik ne ZFT është i ulët. Qarku i Kukësit (Kukës, Tropojë, Has) ka nivelin më të ulët të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) në nivel vendi—2.1%. Grafiku 8 paraqet peshën specifike në % të PBB sipas qarqeve. Trovoja është një ndër rrethet më të prapambetura në Shqipëri. Ndërsa tabela 4 dhe Grafiku 9 paraqet prirjet e vlerës së shtuar për periudhën 2009-2012 sipas sektorëve të ekonomisë (turizëm, bujqësi, industria nxjerrëse, tregti dhe shërbime) për qarkun Kukës.

Grafiku 8: Peshë ndaj PBB-së sipas rajoneve statistikore, viti 2012





Tabela 4: Peshë specifike e vlerës së shtuar sipas sektorëve

| Qarku Kukës | Peshë e vlerës së shtuar sipas sektorëve | | | |
|--|--|-------|-------|-------|
| | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
| Bujqësia | 28.9 | 31.48 | 40.17 | 36.92 |
| Industria | 14.45 | 13.92 | 6.57 | 7.93 |
| Ndërtimi | 19.49 | 17.46 | 16.24 | 15.36 |
| Tregtia, hoteleria, transporti, telekomunikacioni | 13.15 | 13.01 | 11.44 | 11.08 |
| Aktivitetet financiare, pasuritë e patundshme dhe qiradhënia | 5.63 | 5.89 | 7.49 | 8.56 |
| Shërbimet e tjera | 18.37 | 18.24 | 18.1 | 20.15 |

Grafiku 9: Vlera e shtuar për periudhën 2009-2012 sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: INSTAT-Llogaritë rajonale, Shqipëri, 2012

Siç vërehet në tabelën 4 dhe grafikun 9, bujqësia është një nga sektorët kryesorë në kontributin e vlerës së shtuar. Për vitin 2012 vlera e shtuar për bujqësinë është përkatësisht 36,92 %, e pasuar nga ndërtimi 15,36% dhe tregti, hoteleri, transport, telekomunikacion prej 11,8%. Për periudhën 2009-2012 vërehet një prirje relativisht e qëndrueshme e rritjes së peshës së vlerës së shtuar në sektorin e bujqësisë dhe tregëtisë, hotelerisë, transportit, telekomunikacionit dhe një prirje në rënie për industrinë dhe ndërtimin. Rentabiliteti i ulët në rastin e industrisë minerare dhe kërkesa e ulët në rastin e ndërtimit janë shkaqet kryesore të kësaj tendence.

Në nivel të zonës funksionale, numri më i madh i bizneseve aktive është kryesisht në bashkinë e Bajram Currit. Gjatë periudhës 2007-2014 vërehet një numër i konsiderueshëm i regjistrimeve të bizneseve të reja kryesisht në Bajram Curri, Tropojë fshat dhe Llugaj. Vihet re një numër i ulët i bizneseve aktive në Komunën e Margegajt ku njëkohësisht është përqëndruar turizmi malor (Lugina e Valbonës). Shkalla e lartë e informalitetit në sektorin e turizmit malor në këtë zonë shpjegon këtë dukuri. Tabela 5 dhe 6 paraqesin përkatësisht numrin e bizneseve aktive sipas NJQV-ve dhe sektorëve të aktivitetit. Grafiku 10 paraqet bizneset sipas sektorëve. Nga Tabela 6 shihet se numri më i madh i bizneseve aktive janë në tregëti, riparimi i automobilave dhe

artikujve shtëpiakë (247 ose 52 % e numrit të përgjithshëm të bizneseve të regjistruara), hoteleri dhe restorante (91 ose 19 %) dhe më pak në bujqësi (5). Gjatë periudhës 2011-2014, ka patur një rënie të bizneseve të regjistruara me 50, nga të cilat 22 në sektorin e tregëtisë, riparimit të automobilave dhe artikujve shëtpiakë dhe 8 në hoteleri dhe restorante.

Tabela 5: Numri i bizneseve aktive sipas NJQV-ve

| NJQV | # bizneseve aktive 2014 | # bizneseve të regjistruara 2007-2014 |
|---------------|-------------------------|---------------------------------------|
| Bajram Curri | 420 | 187 |
| Margegaj | 11 | 11 |
| Tropojë fshat | 39 | 29 |
| Fierzë | 7 | 10 |
| Bytyç | 12 | 12 |
| Bujan | 8 | 9 |
| Lekbibaj | 4 | 3 |
| Lugaj | 2 | 13 |
| TOTALI | 503 | 274 |

Burimi: QKR

Tabela 6: Numri i bizneseve aktive sipas sektorëve të aktivitetit


| Lloji i bizneseve | Biznese aktive 2014 | Biznese të regjistruara 2007-2014 | Biznese të çregjistruara 2011-2014 |
|---|---------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| Administrim Publik | 5 | 1 | |
| Aktivite financiare | 2 | 3 | 1 |
| Arsimi | 3 | 3 | 1 |
| Bujqësia, gjuetia, silvikultura | 5 | 7 | |
| Hoteleri, restorante | 91 | 49 | 8 |
| Industria nxjerrëse | 21 | 17 | |
| Industria përpunuese | 11 | 11 | |
| Ndërtimi | 12 | 19 | |
| Pasuri të patundshme, qera, shërbime për ndërmarrjet | 20 | 16 | 2 |
| Prodhimi shpërndarja e energjisë elektrike, gazit, ujit | 3 | 2 | |
| Shëndeti dhe veprimtaritë sociale | 6 | 5 | 2 |
| Shërbime kolektive, sociale, personale | 24 | 13 | 3 |
| Transporti, telekomunikacioni | 21 | 6 | 1 |
| Tregëtia, riparimi (automobile, artikuj shtëpiakë) | 247 | 122 | 22 |
| TOTALI | 471 | 274 | 40 |

Burimi: QKR

Në Zonën Funksionale Tropojë ndërmarrjet e biznesit janë në përgjithësi të vogla. Vetëm rreth 30 biznese (ose rreth 6% e numrit të përgjithshëm të bizneseve) janë regjistruar si të mëdha të cilat

fokusohen kryesisht në miniera (7) dhe në ndërtim (3). Nuk ka të dhëna për biznese të mëdha në turizëm dhe hoteleri. Në Tropojë, punëdhënësit më të mëdhej janë vendosur në Bajram Curri, ndërsa në Bujan and Bytyç ka ndërmarrje me 10-20 punonjës. Përsa i përket bizneseve të reja, në 2014 janë hapur 48 të tilla, kryesisht në sektorin e tregëtisë dhe shërbimeve (bar-restorante). Shumica e ndërmarrjeve kanë më pak se 7 punëtorë dhe shumica janë biznese familjare. Vetëm pak ndërmarrje (8) kanë midis 20-100 punëtorë.

Grafiku 10: Bizneset sipas sektorëve



Burimi: QKR

Zona e Tropjës nuk ka qenë në qendër të vëmendjes së investimeve të brendshme dhe të huaja. Sidoqoftë, vitet e fundit vihet re një interesim i shtuar qoftë lidhur me investimet e brendshme ashtu edhe me ato të huaja. Lidhur me investimet e brendshme, ato janë realizuar kryesisht nga Ministria e Financave (Komiteti i Fondit të Zhvillimit Rajoneve/Drejtorja e Menaxhimit të Investimeve Publike), Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike, dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Përsa i përket investitorëve të jashtëm, ato përfshijnë KFW, Kooperacionin Zviceran të Zhvillimit, UNDP, Agjensinë Austriake të Zhvillimit, Bankën Islamike, Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës, Bashkimin Evropian, etj. Investimet janë përqëndruar në fushat e infrastrukturës rrugore, ujësjellës-kanalizime, arsim dhe shëndetësi, sociale, etj. Tabela 7 paraqet një listë të investimeve në Tropojë në pesë vitet e fundit.

Tabela 7: Investimet në Tropojë në pesë vitet e fundit


| EmerProjekti | viti | Investitori | LlojProjekti |
|---|------|--|-------------------------------|
| Rikonstruksioni I rruges Kocanaj | 2009 | Banka per Zhvillim e Keshillit te Evropes | Infrastrukture Rugore |
| KUZ Dushaj Zona B | 2009 | Ministria e Transportit dhe Infrastruktures | Ujesjelles - Kanalizime |
| Sistemim asfaltim rruga Dushaj - Tpla, Faza I | 2009 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Infrastrukture Rugore |
| Rritja e Ndërgjegjësimit mbi të Drejtat e Fëmijëve e me Nevoja të | 2009 | Swiss Development Corporation | Sociale |
| Ndërtim Shkolle Cikel i Ulet , fshati Shumice | 2009 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | Arsim |
| Rikonstruksion rruge B.Curri - Kolmakaj | 2009 | Ministria Puneve te Brendshme | Infrastrukture Rugore |
| Rikonstruksion Rruge Auto Asfalt - Gri | 2009 | Ministria Puneve te Brendshme | Infrastrukture Rugore |
| Rikonstruksion rruge Q.Komune - Kolmakaj | 2009 | Ministria Puneve te Brendshme | Infrastrukture Rugore |
| Rikonstruksion rruge Q.Komune - Shkolla | 2009 | Ministria Puneve te Brendshme | Infrastrukture Rugore |
| Ndërtimi qendres turistike Valbone | 2010 | Banka per Zhvillim e Keshillit te Evropes | Turizem dhe Kulture |
| Shkolla 9-vjeçare Tpla | 2010 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | Arsim |
| Fuqizimi i Grupeve të Vetëmbështetjes për Prindërit dhe Familjet në | 2010 | Agjencia Austriake për Zhvillim | Sociale |
| Rikonstruksion i zyrave te komunes Margegaj | 2010 | Ministria Puneve te Brendshme | Infrastrukture Administrative |
| Rikonstruksioni I rruges Sheshi I Trageteve - Lekbibaj | 2011 | Banka Islamike | Infrastrukture Rugore |
| Ndërtimi I Ujesjellesit te fshatrave Paqe, Flumi, Shoshan, | 2011 | KFW -RWS | Ujesjelles - Kanalizime |
| Rikonstruksioni I rruges Ura Dushaj - Sheshi i Trageteve | 2011 | Banka Islamike | Infrastrukture Rugore |
| Ndërtimi I ujesjellesit te fshatit Markaj | 2011 | KFW -RWS | Ujesjelles - Kanalizime |
| Ndërtimi I ujesjellesit te fshatit Prush | 2011 | KFW -RWS | Ujesjelles - Kanalizime |
| Ndriçim rrugor Dushaj | 2011 | UNDP , | Infrastrukture Administrative |
| Sistemim asfaltim rruga Dushaj - Tpla, Faza II | 2011 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Infrastrukture Rugore |
| Pyllëzim me geshtenja Dushaj | 2011 | Ministria per Inovacionin dhe Administraten | Infrastrukture Pyjore |
| Shkolla e mesme Fierze | 2011 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | Arsim |
| Ambulanca Zona B | 2011 | Ministria e Shendetesise. | Shendetesi |
| Ndihmë për Familjet e Izoluara në Rrethin e Tropojës | 2011 | Ministria Federale për Bashkëpunim | Sociale |
| Shërbimet për Fëmijët dhe Familjet në Bashkinë Bajram Curri dhe | 2011 | Bashkimi European | Sociale |
| Ndërtim Ura Mejdan | 2011 | Ministria e Transportit dhe Infrastruktures | Infrastrukture Rugore |
| Rikonstruksion Rruge Tropoje - Fshati Shumic | 2011 | Ministria Puneve te Brendshme | Infrastrukture Rugore |
| Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare , Kernaje | 2011 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | Arsim |
| Rikonstruksion Shkolla e Mesme dhe Palestra | 2011 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | Arsim |
| Ndërtim Ura Beli Dragobi | 2011 | Komuna Margegaj | Infrastrukture Rugore |
| Ndërtim shtëpie malore Valbone | 2011 | UNDP , | Infrastrukture Administrative |
| Ndërtim Ambulance A1, ne fshatin Lekurtaj, Komuna Bujan | 2012 | Ministria e Shendetesise. Komiteti i Fondit te | Shendetesi |
| Rikonstruksion i rruges Qender Komune- Bllate - Rosuje | 2012 | Ministria e Financave. Komiteti i Fondit te | Infrastrukture Rugore |
| Zyrat e Komunes Bujan | 2012 | Ministria e Financave. Komiteti i Fondit te | Infrastrukture Administrative |
| Rikonstruksioni I rruges Sopot Kernaje | 2012 | IDB- ISTISNA'A | Infrastrukture Rugore |
| Rikonstruksioni I rruges Tropoje - Bucaj | 2012 | Banka Islamike | Infrastrukture Rugore |
| Pyllëzim Lajthi Breg-Lume | 2012 | Ministria per Inovacionin dhe Administraten | Infrastrukture Pyjore |
| Ujesjellesi Kokez - Dushaj | 2012 | Ministria e Transportit dhe Infrastruktures | Ujesjelles - Kanalizime |
| Sistemim asfaltim rruga Kodra Xanit - Ball Fushe | 2012 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Infrastrukture Rugore |
| Sistemim asfaltim rruga auto Smajlaj | 2012 | Ministria e Transportit dhe Infrastruktures | Infrastrukture Rugore |

Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës

2.2 Tregu i punës dhe struktura e punësimit/papunësisë

Shumica e të punësuarve në Tropojë janë në sektorin publik dhe sektorët kryesore ekonomike si tregëti dhe shërbime, ndërtim dhe miniera. Nga të punësuarit, pjesa më e madhe i përket sektorit publik ku janë 72 % e të punësuarve. Kjo dëshmon për rëndësinë e sektorit publik përsa i përket punësimit dhe nivelit tëulët të zhvillimit ekonomik që nuk ka gjeneruar punësim për banorët e Tropojës. Grafiku 11 paraqet raportin midis të punësuarve në sektorin publik dhe privat.


Grafiku 11: Raporti i të punësuarve



Burimi: Zyra e Statistikës Tropojë

Në kuadrin e sektorit publik, shumica e të punësuarve i përkasin kategorisë së sektorit publik buxhetor (80%). Në kuadrin e sektorit privat, shumica dërmuese e të punësuarve janë tek subjektet juridike (79%). Këto subjekte private juridike janë kryesisht firma vendase. Nuk ka të dhëna në Zyrën Lokale të Taksave apo të Punës për firma të përbashkëta apo të huaja. Punëdhënësit më të mëdhenj janë të përqëndruar në Bajram Curri, Bujani, Bytyçi dhe Tropoja kanë ndërmarrje me 10-20 të punësuar. Bizneset përqëndrohen në ruajtjen fizike, ndërtim dhe miniera. Grafiku 11, 12 dhe 13 japin raportet e punësimit midis sektorit publik dhe privat dhe brenda secilit sektor. Tabela 8 përmbledh të dhënat e punësimit sipas sektorëve publik dhe privat.

Grafiku 12: Punësimi në sektorin buxhetor dhe jo-buxhetor



Grafiku 13: Punësimi në subjektet juridike dhe fizike




Tabela 8: Të punësuarit në sektorin shtetëror dhe privat (2014)


| No. | Sektori | Sipas tatimeve | | Sipas deklarimeve të zyrës së punës (ZP) | | Kontratat kolektive të punës depozituar në ZP | |
|-------|-----------------------------------|----------------|------|--|------|---|-----|
| | | | | | | | |
| 1 | Sektori shtetëror | 34 | 1374 | 34 | 1164 | 4 | 816 |
| 1.1 | Shtetëror buxhetor | 22 | 1104 | 22 | 1083 | 3 | 673 |
| 1.2 | Shtetëror jo buxhetor | 12 | 270 | 12 | 81 | 1 | 143 |
| 2 | Sektori privat | 140 | 527 | 40 | 333 | 1 | 108 |
| 2.1 | Të regjistruar si persona fizik | 94 | 112 | 15 | 36 | | |
| 2.2 | Të regjistruar si persona juridik | 46 | 415 | 15 | 297 | 3 | 121 |
| 2.2.1 | Firma vendase | 46 | 276 | 10 | 297 | 1 | 108 |
| 2.2.2 | Ndërmarrje të përbashkëta | | | | | | |
| 2.2.3 | Firma të huaja | | | | | | |
| | Gjithsej 1+2 | 174 | 1650 | 44 | 1481 | | 924 |

Burimi: Zyra e Statistikës Tropojë


Lidhur me lëvizjet e banorëve të Tropojës për punë, banorët e Bujanit, Fierzës, Llugajt, dhe Tropojës kanë një ndërveprim më intensiv me Bajram Currin lidhur me punësimin. Banorët e Bajram Currit dhe komunave përreth kanë një ndërveprim të kufizuar me Gjakovën përse i përket punësimit. Harta 3 dhe 4 tregojnë për vendndodhjen e punëdhënësve të mëdhej në Tropojë dhe lëvizjen për punë dhe intensitetin e saj.

Harta 3: Vendndodhja e punëdhënësve të mëdhenj

Harta 4: Lëvizja për punë



Rethi i madh--punëdhënësit e mëdhenj
Rrethi i vogël--punëdhënës mesatare




Shigjeta e trashë--ndërveprim intensiv
Shigjeta e hollë--ndërveprim i vogël

Burimi: Zyra e taksave; Intervistat individuale dhe fokus

Numri i të papunëve është relativisht i lartë në Tropojë. Në total, rreth 2,500 të papunë kërkojnë punësim në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe në sektorin publik shtetror (përfshirë këtu fermerët e vetpunësuar në bujqësi). Vërehet se punëkërkuessit që marrin ndihmë ekonomike zënë një përqindje shumë të lartë (68%). Gjithashtu, të rinjtë me moshë 20-29 vjeç zënë një përqindje të konsiderueshme të punëkërkuessve--722 ose 30% e punëkërkuessve gjithsej. (Shih Grafiku 14)


Grafiku 14: Punëkërkuessit në Tropojë



Burimi: Zyra e Statistikës Tropojë

Përsa i përket arsimit, numrin më të madh të punëkërkuessve e zënë ata me shkollë 9-vjeçare dhe të mesme. Midis punëkërkuessve, ka një numër të konsiderueshëm njerëzish që kanë arsim profesional. Grafiku 15 dhe 16 dhe Tabela 9 japin të dhëna lidhur me punëkërkuessit e papunë sipas grupmoshave dhe arsimit. Nga intervistat dhe fokus grupet rezulton se punëkërkuessit i drejtohen më shumë sektorit publik dhe më pak atij privat.

Grafiku 15: Punëkërkuessit e papunë sipas grupmoshave



Burimi: Zyra e Statistikës Tropojë

Grafiku 16: Punëkërkuessit e papunë sipas arsimit




Tabela 9: Të dhëna për punëkërkesit papunë (nëntor 2014)

| | Punëkërkesit | Sipas grupmoshave | | | | | | | Mbi 50 |
|---|--------------------------------------|-----------------------|--------|-----------|-----------------|--------------|-------------|-------|--------|
| | | 15-19 | 20-24 | 25-29 | 30-34 | 35-39 | 40-44 | 45-50 | |
| 1 | Punëkërkes te papune (PuPa) gjithsej | 61 | 386 | 336 | 304 | 346 | 404 | 298 | 300 |
| 2 | PuPa përfitues pagese papunësie | 1 | 11 | 15 | 13 | 16 | 10 | 38 | 30 |
| 3 | PuPa përfitues nga skema ekonomike | 28 | 272 | 238 | 216 | 258 | 290 | 149 | 196 |
| 4 | PuPa të tjerë | 32 | 103 | 83 | 75 | 72 | 104 | 111 | 74 |
| 1 | Punëkërkesit | Sipas nivelit arsimor | | | | | | | |
| | | Më pak se fillor | fillor | 9- vjeçar | Emesme e pergj. | Emesme prof. | Universitar | | |
| 1 | Punëkërkes te papune (PuPa) gjithsej | 0 | 63 | 925 | 1143 | 213 | 91 | | |
| 2 | PuPa përfitues pagese papunësie | 0 | 1 | 4 | 64 | 30 | 35 | | |
| 3 | PuPa përfitues nga skema ekonomike | 0 | 61 | 693 | 724 | 160 | 9 | | |
| 4 | PuPa të tjerë | 0 | 1 | 228 | 355 | 23 | 47 | | |

Burimi: Zyra e Statistikës Tropojë

2.3 Ndërveprimet ekonomike të zonës funksionale

Bashkia Bajram Curri dhe shtatë komunat e Rrethit Tropojë krijojnë një Zonë Funksionale të vetme si një hapësirë territoriale ku ka një ndërveprim të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime punësimi, tregu, marrje shërbimesh, etj. Kjo për arsye se institucionet kryesore administrative që ofrojnë kryesisht punësim të banorëve, janë të stacionuara pikërisht në qendrën e rrethit Tropojë që njëkohësisht shërben dhe si qendra funksionale e zonës.

Përsa i përket intensitetit të lëvizjes drejt tregjeve, banorët prej komunave Bujan, Fierzë, Llugaj, Bytyç, dhe Tropojë është i lartë me Bajram Currin. Komunat Margegaj, Lekbibaj kanë ndërveprim të ulët ekonomik me Bajram Currin. Ndërmjet këtyre dy komunave ka një ndërveprim, por është ende i dobët. Distancat e rrugëve dhe kushtet e papërshtatshme të rrugëve bëjnë që Bajram Curri të frekuentohet nga Lekbibaj dhe Margegaj, veçanrisht në periudhën e dimrit. Kështu, të gjitha njësitë vendore kanë ndërveprim intensiv me Gjakovën (Kosovë). Lidhjet tradicionale me Gjakovën janë riaktivizuar pas rehabilitimit të rrugës (më pak se 30 min nga Bajram Curri dhe më pak për Llugaj dhe Tropojë fshat) dhe Gjakova është përdorur gjërësisht si vend tregtimi dhe mundësi punësimi.

Nga sa më sipër del qartë tendenca e një modeli të përqendruar të zonës funksionale, në të cilin ka vetëm një qendër të rëndësishme që është qyteti ose qendra administrative e rrethit. Kjo vjen për shkak të strukturës ekonomike të zonës dhe qyteti shikohet si i vetmi vend i rëndësishëm i tregut në të cilin janë vendosur shërbimet kryesore. Rrethi i Tropojës, edhe pse i ndodhur në skajin më të largët në verilindje të Shqipërisë, me terren malor dhe të copëzuar, ka një vazhdimësi territoriale.


Ku blejnë njerëzit? Bajram Curri është njëkohësisht tregu kryesor për banorët e zonës. Banorët nga komunat shesin në Bajram Curri prodhimet e tyre bujqësore dhe blektorale dhe blejnë mallrat e konsumit. Pas pavarësimit të Kosovës, banorët e Tropojës ju drejtuan edhe Gjakovës për plotësimin e nevojave të tyre të tregut. Rehabilitimi i rrugës që lidh Bajram Currin me Gjakovën (37 km e gjatë) ka lehtësuar këtë ndërveprim. Banorët e Bujanit, Fierzës, Llugajt, Bytyçit dhe Tropojës kanë një ndërveprim më të madh me qytetin e Bajram Currit. Komunat e Margegajt por edhe fshtrat e thellë malorë të komunave të përmendura më sipër kanë një ndërveprim më të vogël me qytetin. Banorët e Bajram Currit, Llugajt, Margegajt, Tropojës dhe Bytyçit kanë një ndërveprim më të madh me Gjakovën. Harta 5 dhe 6 paraqet ndërveprimin lidhur me tregjet.

Harta 5: Tregjet ku njerëzit blejnë



Rrethi i madh—tregu kryesor
Rrethi i vogël—treg i vogël lokal

Harta 6: Ndërveprimi lidhur me tregjet



Shigjetë e trashë—ndërveprim intensive
Shigjetë e hollë—ndërveprim i kufizuar

3. ANALIZA E THELLUAR E EKONOMISË SË ZONËS FUNKSIONALE TROPOJË

Sektorët prioritarë të zonës funksionale Tropojë përfshijnë turizmin rural e malor dhe bujqësinë dhe prodhimin bujqësor dhe përpunimin e produkteve bujqësore. Kjo e fundit është shumë e lidhur me zhvillimin e sektorit të turizmit. Tropoja ka kushte të përshtatshme natyrore, klimaterike dhe gjeografike për zhvillimin e turizmit malor/rural. Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë është një mundësi e mirë për plotësimin e nevojave të turistëve potencial. Nje sektor tjetër potencial është ai i minierave.

3.1. Bujqësia dhe blegtoria

3.1.1. Bujqësia

Toka bujqësore


Bujqësia është një nga sektorët e rëndësishëm ekonomik të rrethit Tropojë. Në shkallë rrethi, janë rreth 4800 ferma që ushtrojnë aktivitet bujqësor dhe blegtoral. Madhësia e fermës shkon nga 1-2.2 ha tokë bujqësore të punueshme. Në shkallë rrethi, sipërfaqja mesatare është 0.9 ha/familje, por në familje të veçanta sipërfaqja varion nga 0.3-1.4 ha. Në shkallë rrethi, sipërfaqja për frymë është 0.25 ha. Tokat bujqësore përfshijnë të kafenjta (77%), të murrme (22%) dhe livadhore malore (0.6%). Tabela 10 dhe Harta 7 paraqesin sipërfaqen e tokës së punueshme.

Tabela 10: Sipërfaqja e tokës së punueshme sipas kulturave

| Struktura e tokës bujqësore | Sipërfaqe/ha (2014) |
|-------------------------------------|---------------------|
| Tokë bujqësore e punueshme | 7387 |
| Bimë të arave | 3870 |
| Pemtaria (pa gështenjën) | 480 |
| Pemëtore të rregullta | 160 |
| Vreshtë | 15.6 |
| Tokë e papërdorur (e dobët, djerrë) | 3021.33 |

Burimi: Zyra e bujqësisë Tropojë

Harta 7: Sipërfaqja e tokës së punueshme sipas NJQV



Sipërfaqen më të madhe të sipërfaqes së tokës së punueshme e zënë bimët e arave (rreth 50%). Krahasuar me vitin 2014, kjo sipërfaqe është ulur, ndërsa rendimentet për ha, në përgjithësi, janë rritur. Në Tabelën 11 jepen të dhëna të detajuara për kulturat bujqësore dhe rendimentet e tyre, për vitet 2000 dhe 2014.

Tabela 11: Sipërfaqia dhe rendimenti sipas kulturave në vitet 2000 dhe 2014

| Kulturat bujqësore | 2000 | | 2014 | | 2014/2000 (%) | |
|---------------------------------------|------|------------|------|-------|---------------|---------|
| | sip | rend kv/ha | sip | rend | sip | rend |
| Grurë | 254 | 25.1 | 80 | 40 | 31.50% | 159.36% |
| Miser | 1406 | 41 | 700 | 60 | 49.79% | 146.34% |
| Perime | 188 | 198 | 165 | 232 | 87.77% | 117.17% |
| Patate | 90 | 243 | 45 | 230 | 50.00% | 94.65% |
| Fasule direkte | 18 | 8.3 | 10 | 15 | 55.56% | 180.72% |
| Kultura industrial (duhan, sherebelë) | 4 | | 4.15 | | 103.75% | |
| Foragjere të para | 2085 | 159 | 2866 | 135.3 | 137.46% | 85.09% |
| Sip. e zënë më bimë arash | 4045 | | 3870 | | 95.67% | |

Burimi: Zyra e Bujqësisë Tropojë


Sipas të dhënave nga Zyra e Kadastrës të Rrethit Tropojë, rreth 57 % e sipërfaqes së tokës është ndarë, por pajisja me dokumentacionin përkatës ligjor është bërë për një sipërfaqe më të vogël kryesisht për arsye të moszbatimit të akteve ligjore dhe nën ligjore nga strukturat e pushtetit lokal dhe pengesave të tjera ligjore lidhur me dokumentimit e tokës.

Drithërat dhe perimet

Përsa i përket sipërfaqes së mbjellë me drithëra dhe perime, peshën specifike më të madhe (rreth 75% mesatarisht) e zënë drithërat. Harta 8 paraqet sipërfaqen e mbjellë me drithëra dhe perime sipas NJQV-ve. Megjithatë, në 2014 krahasuar me 2000, vihet re se sipërfaqja e mbjellë me drithëra ka një rënie e konsiderueshme, afërsisht 68% dhe 50% përkatësisht për grurin dhe misrin, dhe një rritje të rendimentit të tyre, me përkatësisht rreth 60% dhe 46%. Lidhur me perimet, patatet dhe fasulet, përsëritet e njëjta tendencë lidhur me sipërfaqen e mbjellë dhe rendimentin e prodhimit.


Në përgjithësi, vihet re një ulje e sipërfaqes së zënë nga bimët e arave prej rreth 4% dhe një rritje e sipërfaqes së zënë nga foragjeret e para me rreth 37%. Tabela 11 dhe Grafiku 17 dhe 18 paraqesin të dhëna lidhur me sipërfaqen dhe rendimentin sipas kulturave në vitet 2000 dhe 2014.

Harta 8: Sipërfaqen e mbjellë me drithëra/perime sipas NJQV-ve




Burimi: Zyra i Bujqësisë Tropojë

Grafiku 17: Sipërfaqja dhe rendimenti i drithërave



Grafiku 18: Sipërfaqja dhe rendimenti i perimeve




Burimi: Zyra i Bujqësisë, Tropojë

Pothuaj për të gjitha kulturat bujqësore, përveç forgjereve, është ulur sipërfaqja e mbjellë. Kjo për arsye të ndryshme nga të cilat veçojmë largimin e familjeve nga fshati në qytet dhe në rrethe

të tjera, emigrimin/migrimin e të rinjve jashtë shtetit dhe drejt kryeqytetit, mungesa e mekanizimit, pamundësia për të përballuar rritjen e tarifave të larta që rrisin koston e prodhimit, si dhe ulja drastike e aftësisë ujitëse në shkallë rrethi. Ulja e sipërfaqes së mbjellë me kultura bujqësore një-vjeçare është shoqëruar me rritjen e kulturave livadhore polifite shumë-vjeçare, kjo edhe si nevojë e sigurimit të bazës ushqimore për blegtorinë.

Lidhur me prodhimin e drithërat e bukës dhe perimeve, vendin kryesor në Tropojë e zënë Komuna e Tropojës, Margegajt, Bujanit dhe Llugajt të cilat kanë një afërsi gjeografike dhe ndërveprim më intensiv me Bajram Currin si qendër e rrethit. Njëkohësisht ata kanë lidhje edhe me Luginën e Valbonës ku janë të përqëndruara shtëpitë pritëse dhe hotelet për turistët. Në këtë mënyrë ata kanë një treg potencial për prodhimet bujqësore. Grafiku 19 paraqet prodhimin e drithërave dhe perimeve sipas NJQV-ve.

Grafiku 19: Prodhimi i drithërave dhe perimeve



Në përgjithësi, prodhimi bujqësor përdoret për plotësimin e nevojave individuale të familjeve fermere dhe të Bajram Currit. Një pjesë e tyre përdoret për të plotësuar nevojat e turizmit në Luginën e Valbonës. Sidoqoftë, furnizimi në Luginën e Valbonës bëhet kryesisht nga fermerët e Komunës së Margegajt. Ky nivel prodhimi është relativisht i ulët krahasuar me nevojat në rritje të zhvillimit të turizmit në të ardhmen.

Industria perpunuese e lidhur me drithërat nuk është e zhvilluar. Edhe për bluarje, një pjesë e madhe e fermerëve shkojnë në Kosovë, ku kryesisht paguajnë me sasi prodhimi.

Mekanika bujqësore

Përsa i përket mekanikës bujqësore, inventari i tyre është shumë i varfër, rreth 150 makina të ndryshme bujqësore në nivel rrethi (Tabela 12). Kjo shpjegohet kryesisht me pamundësinë e fermerëve për të blerë mekanikë bujqësore kryesisht për shkak të përmasave të vogla të fermës bujqësore dhe mungesës së kooperimit midis fermerëve të vegjël. Në këtë inventar, traktorët me rrota zënë vendin kryesor, e lidhur kjo edhe me terrenin kodrinor-malor dhe madhësinë e ngastrave bujqësore.

Aftësia ujitëse

Përsa i përket aftësisë ujitëse, sistemi ekzistues i ujitjes në bujqësi nuk mbulon nevojat e fermerëve për vaditjen e tokave bujqësore. Për vitin 2014 është mundësuar ujitja e 27% e sipërfaqes së mbjellë ose 42 % e sipërfaqes potenciale. Sipërfaqja potenciale që duhet të ujitet është jo më pak se 70% e totalit të fondit tokës. Tabela 13 dhe Harta 9 paraqesin sipërfaqen e tokës bujqësore të ujitur sipas NJQV-ve. Vihet re se përqindja është e ulët përveç Lekbibajt që shpjegohet me sipërfaqen e vogël të tokës bujqësore, në përgjithësi, e kombinuar më përqindjen e lartë të saj për tokat nën ujë.

Tabela 12: Gjendja e mekanikës bujqësore në 2014


| Lloji i mekanikës | Rrethi | NJQV | | | | | | | | |
|---------------------|--------|-------|-------|-------|----------|--------|----------|---------|--------------|--|
| | | Bujan | Bytyç | Fierz | Lekbibaj | Llugaj | Margegaj | Tropoje | Bajram Curri | |
| Traktorë me rrota | 55 | 10 | 7 | 4 | 0 | 13 | 6 | 14 | 1 | |
| Minitraktorë | 25 | 2 | 5 | 2 | 0 | 6 | 4 | 5 | 1 | |
| Makina mbjellëse | 35 | 8 | 4 | 4 | 0 | 6 | 6 | 7 | 0 | |
| Motokorrëse | 21 | 3 | 4 | 3 | 0 | 5 | 2 | 4 | 0 | |
| Autokombanja | 3 | 1 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | |
| Traktorë me zinxhir | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| Freza | 15 | 2 | 0 | 2 | 0 | 3 | 2 | 5 | 1 | |

Burimi: Zyra e Bujqësisë

Tabela 13: Sipërfaqja e ujitur sipas NJQV

| NQV | Sipërfaqja e tokës gjithsej | Sipërfaqja faktike e ujitur ha | Sipërfaqja faktike e ujitur në % |
|---------------|-----------------------------|--------------------------------|----------------------------------|
| Bajram Curri | 138.5 | 20 | 14.44% |
| Bujan | 1091.6 | 320 | 29.31% |
| Bytyç | 979 | 225 | 22.98% |
| Fierzë | 722.5 | 135 | 18.69% |
| Lekbibaj | 636 | 260 | 40.88% |
| Llugaj | 1231 | 310 | 25.18% |
| Margegaj | 690.4 | 230 | 33.31% |
| Tropojë (Kom) | 1898 | 520 | 27.40% |
| Gjithsej | 7387 | 2020 | 27.35% |

Harta 9: Sipërfaqja e ujitur sipas NJQV




Burimi: Zyra e Bujqësisë Tropojë


Pemëtaria

Përsa i përket pemtarisë, Tropoja është e njohur për mollën gjyle, kumbullën tropojane dhe gështenjen. Përsa i përket prodhimit të mollës, dallohen komunat e Tropojës, Llugajt dhe Bujanit. Për prodhimin e kumbullës dallohen komunat e Bujanit, Tropojës, Llugajt dhe bashkia e Bajram Currit. Masivet e geshtenjës shtrihen thuajse në të gjithë rrethin, në toka relativisht jo-produktive. Për prodhimin e saj dallohen komunat e Bujanit, Lekbibajt, Tropojës dhe Margegajt. Zona Funktionale Tropojë ka masivin më të madh të geshtenjave në Shqipëri por edhe në Ballkan. Ky masiv shtrihet në 2000 hektarë dhe numëron më shumë se 190,000 rrënjë. Grafiku 20 dhe 21 japin të dhëna për prodhimin dhe numrin e rrënjëve të mollës, kumbullës dhe geshtenjës sipas NJQV-ve.

Grafiku 20: Prodhimi në pemëtari sipas NJQV



Grafiku 21: Pemë frutore (rrënjët) sipas NJQV



Burimi: Zyra e Bujqësisë Tropojë

Mbledhja dhe tregëtimi i gështenjës është një nga burimet kryesore të të ardhurave për ekonominë lokale. Sipas të dhënave nga intervistat individuale dhe fokus, vetëm gjatë vitit 2014 janë gjeneruar më shumë se 3 milion Euro të ardhura nga shitja e gështenjave. Duhet theksuar se tregëtimi i gështenjës bëhet kryesisht si frut i sapombledhur/papërpunuar dhe shumë pak i përpunuar. Ai eksportohet jashtë vendit, kryesisht në Gjermani, Austri dhe Turqi. Tropoja nuk ka kapacitetet për përpunimin e gështenjës. Sot ka vetëm një fabrikë të vogël e cila bën standartizimin dhe ambllazhimin e frutit të gështenjës. Për mungesë financimi, kjo fabrikë nuk ka mundësi të përmirësojë teknologjinë për të bërë përpunimin industrial agro-ushqimor të frutit të gështenjës.

Lidhur me përpunimin e frutave të tjerë, rrethi i Tropojës ka pasur fabrika për përpunimin e tyre në të kaluarën si furrat për tharjen e kumbullave dhe fabrika për konservat e frutave, të cilat nuk janë më në punë.

Gjatë viteve nëntëdhjetë ka patur dëmtime të sipërfaqeve të mbjella me kumbull për shkak të mungesës së shërbimeve dhe të problemeve të pronësisë. Vitet e fundit, vihet re një tendencë e rritjes së sipërfaqeve të mbjella me dru frutorë. Në vitin 2011 dhe 2012, Ministria për Inovacion dhe Administratën Publike financoi përkatësisht një projekt për pyllëzimin me gështenja në Dushaj dhe një projekt për pyllëzim me lajthi në Breg-Lum.

Tregëtimi i farërave dhe fidaneve

Përdorimi aktualisht i farërave dhe i fidanave është i bazuar në tregun lokal. Tregëtarët e pikave të shitjes kanë bërë përpjekje për të sjellë në treg prodhime të garantuara. Çmimet e shitjes për disa fermerë janë të pa arritshme për t'i përballuar. Mungesa e institucioneve financiare që mund të japin kredi të favorshme për fermerët ka ndikuar në zhvillimin e produkteve bujqësore.

Transporti i prodhimeve bujqësore

Kryesisht për shkak të largësisë dhe terrenit, transporti i produkteve bujqësore drejt qendrës së zonës është i kushtueshëm për një pjesë të madhe të fermerëve nga fshatrat e largët.

Bimët medicinale

Pyjet dhe bjeshkët e Tropojës janë të pasura në bimë medicinale. Këtu gjenden rreth 186 lloje bimesh mjeksore prej të cilave më e rëndësishmja është Boronica (Ēacininum mirtillus). Bimë të tjera janë: dellinja e zezë, molla e egër, trëndafili i egër, agulicja, lulet e blirit, qingela, lule shtogu, salepi, sanza, lule basani, sherebela, rrenjet e hithres, kokrrat e shtogut, trumza, rigoni, bar pezma njëmijë gjeteshe, kamomili, thundërmushka, kulumbria, mëllaga, zhumbicat, shpatorja, ushejza pa kërcell, etj.


Boronica rritet në kullotat alpine në rreth 1800-2000 metër lartësi. Çdo vit mblidhen afërsisht 70 ton boronicë e thatë me çmim nga 1,500-2,000 lekë/kg². Ndër bimët e tjera medicinale që mblidhen dhe tregëtohen janë dëllinja e zezë (rreth 40 ton/vit), trendafili i egër (rreth 20 ton/vit) dhe molla e egër (rreth 30 ton/vit)³. Këtë vit, në rrethin Tropojë është mbjellë sherebela në sipërfaqen prej 4.15 ha dhe pritet që në vitin që vjen sipërfaqja e mbjelle të rritet. Kjo kulturë subvencionohet nga Ministria e Bujqësisë.

Aktualisht bimët medicinale mblidhen kryesisht nga banorët e fshatrave në territoret e të cilëve ato rriten. Ato grumbullohen nga tregëtarë lokal dhe të tjerë. Shpesh grumbullimi i tyre bëhet nga tregëtarë të pa licensuar. Tropoja nuk ka kapacitet për përpunimin e bimëve medicinale. Kryesisht ato shiten në gjendje të njomë dhe me çmime shumë të ulëta (për shembull këtë vit boronica është shitur, kryesisht tek tregëtarë nga Kosova, e njomë me rreth 1 Euro/kg, ndërkohë që çmimi i saj i thatë është të paktën 10 herë më i lartë. Arsyeja kryesore është sepse në Tropojë nuk ka kapacitet për tharjen e saj. Sidoqoftë, bimët medicinale janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për buxhetin familjar për shumë familje në Tropojë dhe mund të jenë një sektor i rëndësishëm në të ardhmen duke shtuar sasine dhe nivelin e përpunimit.

3.1.2. Blegtoria

Tropoja ka një blegtori të shmëllojshme dhe cilësore për shkak të kullotave të shumta dhe natyrore. Prodhimet blegtorale përdoren për konsum familjar dhe një pjesë shiten në tregun brendshëm. Vendin kryesor e zënë gjedhi, te leshtat dhe te dhirtat. Grafiku 22 paraqet strukturën e blegtorisë në vitin 2014 (numrin e krerëve).

Grafiku 22: Struktura e blegtorisë sipas llojit dhe NJQV, 2014



Burimi: Zyra e Bujqësisë Tropojë


² Burimi: Zyra e Bujqësisë Tropojë

³ Burimi: Drejtoria e Bujqësisë Kukës

Hartat 10, 11, 12 tregojnë shpërndarjen në numër krerësh të gjedhit, të leshtave dhe të dhirtave sipas Njësisive të Qeversijes Vendore.


Komuna e Tropjës zë vendin e parë në numrin e krerëve për gjedhin (rreth 22% e numrit total të krerëve). Numri mesatar i lopeve për fermë bujqësore është rreth 2.2 krerë/fermë. Komuna Bytyç ka rreth 18% të krerëve por një mesatare për fermë relativisht të lartë (5 gjedhë/fermë). Komunat Margegaj dhe Fierze kanë 16% secila. Mesatarja e tyre për fermë bujqësore është respektivisht rreth 3.3 dhe 5. Kjo tregon potencialin e komunave Tropoje dhe Margegaj për shtimin e gjedhit.

Harta 10: Shpërndara e gjedhit sipas NJQV



Burimi: Zyra e Bujqësisë Tropojë

Harta 11: Shpërndarja e të leshtave sipas NJQV




Burimi: Zyra e Bujqësisë Tropojë

Numri i krerëve të të leshtave është relativisht i lartë në nivel të rrethit. Më i lartë është ky numër në komunën Tropojë që përbën më shumë se 42% të numrit të përgjithshëm në nivel zone funksionale. Kullotat e shumta natyrore në këtë komunë favorizojnë mbareshtimin e deles. Edhe komunat Bytyç, Margegaj, Fierze dhe Llugaj kanë një numër të konsiderueshëm krerësh (secila rreth 10% të numrit të përgjithshëm të krerëve).

Gjithashtu vihet re tendenca e rritjes së madhësisë së fermave bujqësore që mbarështojnë te leshtat. Edhe përsa i përket të dhirtave, numri më i madh i krerëve është në komunën e Tropojës (rreth 30% e numrit të përgjithshëm të krerëve në nivel rrethi). Vlen për tu theksuar përqindja e lartë e të dhirtave në komunën e Lekbibaj (17%) sidomos duke pasur parasysh numrin e vogël të popullsisë së saj. Lekbibaj favorizohet në mbareshtimin e të dhirtave nga terreni i përshtatshëm për kullotjen e tyre.

Harta 12: Shpërndarja e të dhirtave sipas NJQV



Burimi: Zyra e Bujqësisë Tropojë

Në nivel rrethi, të leshtat janë tre herë më shumë se të dhirtat. Megjithatë, nga takimet me Zyrën e Bujqësisë Tropojë, theksohet se ka një interes nga familjet bujqësore për shtimin e të dhirtave pasi kullotat natyrore janë të përshtatshme dhe kanë kapacitet mbajtës trefish më shumë se sa aktual.


Në Hartën 13 dhe 14 është paraqitur shpërndarja sipas komunave e prodhimit të qumështit dhe të mishit. Nga hartat duket se prodhimi i mishit dhe qumështit bazohet kryesisht në gjedhin. Kjo lidhet edhe me numrin relativisht të lartë të gjedhit për fermë bujqësore (2-5). Një ndër arsytet është nevoja për të plotësuar nevojat e familjes me mish, qumësht dhe nën produkte të tyre. Gjithashtu duket që prodhuesit kryesorë të qumështit dhe të mishit janë së komuna e Tropojës, Margegajt dhe Fierzës.

Në Grafikon 23 dhe 24, janë paraqitur përkatësisht të dhëna lidhur me prodhimin e qumështit sipas njësive vendore, sipas numrit të krerëve dhe prodhimit të mishit në ton. Nga grafikët del se komuna Tropojë zë vendin kryesor për prodhimin e qumështit dhe të mishit përkatësisht me 26 % dhe 30 % të prodhimit në shkallë rrethi.


Përsa i përket qumështit, prodhues kryesorë janë edhe komunat Margegaj, Bytyç dhe Bujan me përkatësisht 17 %, 14 % dhe 12 % të prodhimit të përgjithshëm në shkallë rrethi.

Përsa i përket prodhimit të mishit, prodhues të tjerë kryesorë janë komunat Margegaj, Bytyç dhe Fierzë me përkatësisht 17 %, 14 % dhe 12 % të prodhimit. Duke pasur parasysh madhësinë e Njësive Vendore Lekbibaj, ajo dallon për peshën specifike relativisht të lartë në prodhimin e mishit dhe qumështit të të dhirtave.

Harta 13: Prodhimi i qumështit sipas llojit dhe NJQV




Harta 14: Prodhimi i mishit sipas llojit dhe NJQV




Burimi: Zyra e Bujqësisë, Tropojë

Grafiku 23: Prodhimi i qumështit sipas llojit dhe NJQV



Grafiku 24: Prodhimi i mishit sipas llojit dhe NJQV



Burimi: Zyra e Bujqësisë, Tropojë

Përpunimi i produkteve të mishit dhe të qumështit është pothuaj inekzistent. Në të gjithë rrethin nuk ka asnjë baxho qumështi. Mishi dhe qumështi ose shiten drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë primitive ose përpunohen në masë të vogël në kushtet e shtëpisë, kryesisht për plotësimin e nevojave familjare dhe më pak për treg.

Mishi i të leshtave dhe të dhirtave është shumë i kërkuar nga hotelet, e kryesisht ato në vende turistike si Valbonë, etj.

Gjithashtu, Tropoja si rreth është e njohur edhe për bletarinë. Është i njohur në mbarë vendin mjalti i Zogajve (Bytyçit) dhe i gështenjës (Krasniqe). Komuna e Tropojës dhe Bytyçit janë Njësitë Vendore me numrin më të madh të zgjojve të bletës (26 dhe 24 % e numrit të përgjithshëm në rreth) dhe të prodhimit të mjaltit (nga 27 % të prodhimit të përgjithshëm të rrethit seicila). Grafiku 25 dhe 26 dhe tabela 14 tregojnë numrin e zgjojve dhe prodhimin në % sipas NJQV-ve.

Grafiku 25: Zgjojtë e bletës sipas NJQV





Tabela 14: Bletaria sipas NJQV

| NJQV | zgjua | kg/zgjua | ton |
|--------------|-------|----------|------|
| Bujan | 878 | 8.6 | 7.6 |
| Bytyç | 1658 | 10 | 16.7 |
| Fierze | 640 | 7.5 | 4.8 |
| Lekbibaj | 493 | 6 | 2.9 |
| Llugaj | 483 | 8.1 | 3.9 |
| Margegaj | 616 | 9.4 | 5.8 |
| Tropoje | 1741 | 9.5 | 16.5 |
| Bajram Curri | 283 | 9.9 | 2.8 |
| ZF Tropojë | 6792 | 8.6 | 61 |

Grafiku 26: Prodhimi i mjaltit sipas NJQV



Burimi: Zyra e Bujqësisë, Tropojë

Mjalti është cilësor por rendimenti i tij është relativisht i ulët, rreth 9 kg/zgjua.

Për zhvillimin e bletarisë, ka pasur edhe interes dhe subvencione nga shteti. Meqenëse mjalti është i një cilësie të mire, veçanërisht mjalti i gështenjës, kërkohet shumë dhe shitet menjëherë

në tregun lokal por edhe jashtë Tropojës. Por sasia e prodhuar është e kufizuar në krahasim me nevojat e tregut.

Prodhimet e tjera blegtorale përfshijnë leshin dhe vezët, por prodhimi i tyre është i kufizuar dhe kryesisht i destinuar për plotësimin e nevojave të fermerëve.

3.1.3. Disa konkluzione dhe rekomandime për zhvillimin e sektorit të bujqësisë

- Zona e Tropojës ka potenciale të pashfrytëzuara si përsa i përket tokës bujqësore të papunuar. Gjithashtu edhe rendimenti në bujqësi dhe blegtori është relativisht i ulët. Potenciali prodhues i Tropojës është të paktën dyfishi i prodhimit të tanishëm. Në ardhmen, vëmendja duhet të përqëndrohet si në rritjen e sipërfaqës së punueshme ashtu dhe ndërmarrjen e masave për rritjen e rendimentit. Duhet të mbahet parasysh që përpjekjet për rritjen e rendimentit nuk duhet të çenojnë cilësinë e produkteve.
- Duke pasur parasysh rëndësinë në rritje të turizmit malor, është e nevojshme që struktura e sipërfaqes së tokës bujqësore të orientohet drejt plotësimit të nevojave të turizmit malor. Kjo njëkohësisht do të sillte të ardhura më të larta për familjet fermere dhe do të sigurote furnizimin e sektorit të turizmit me produkte bujqësore dhe blegtorale natyrore dhe cilësore. Në këtë kontekst, mund të rritet pesha specifike e tokës së mbjellë me perime dhe kultura për ushqimin e blegtorisë. Vëmendja mund të përqëndrohet në ndërmarrjen e masave për orientimin e fermerëve.
- Në përgjithësi, prodhimi bujqësor dhe blegtoral përdoret për plotësimin e nevojave individuale të familjeve fermere dhe të Bajram Currit. Një pjesë e tyre përdoret për të plotësuar nevojat e banorëve të qytetit të Bajram Currit dhe turizmit në Luginën e Valbonës. Një pjesë e vogël tregëtohet jashtë rrethit (Shqipëri apo Kosovë). Është e rëndësishme që të mbështeten fermerët për të dalë në treg. Gjithashtu, duhet të mbështeten përpjekjet për grumbullimin, përpunimin e marketimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Zhvillimi i brand-it të Tropojës do të ishte një hap i rëndësishëm. Kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në sigurimin e standarteve të sigurisë dhe cilësisë dhe rritjen e të ardhurave nga shitja e produkteve.
- Mbledhja dhe tregëtimi i gështenjës është një nga burimet kryesore të të ardhurave për ekonomine lokale. Formalizimi i pronësisë mbi masivet e gështenjës do të ndikonte pozitivisht në menaxhimin e tyre dhe rritjen e prodhimit. Është e rëndësishme që të kryhen shërbime në kulturën e gështenjës për të luftuar sëmundjet.
- Bimët medicinale janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për buxhetin familjar për shumë familje në Tropojë dhe mund të jenë një sektor i rëndësishëm në të ardhmen duke shtuar sasinë dhe nivelin e përpunimit.

- Tropoja ka një inventar të kufizuar të mekanikës bujqësore që shpjegohet kryesisht me pamundësinë financiare të fermerëve dhe përmasave të vogla të fermës bujqësore e kombinuar me mungesën e kooperimit midis fermerëve. Gjithashtu edhe sistemi ekzisues i ujitjes nuk i përballon nevojat e fermerëve. Kjo ka ndikuar edhe në rendimentin e prodhimit si dhe lënien djerrë të tokave. Mbështetja e fermerëve (nëpërmjet kreditimit me kushte lehtësuese për shembull) për të rritur përdorimin e mekanikës bujqësore do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e prodhimit dhe të ardhurave të fermerëve. Gjithashtu e rëndësishme është nxitja e kooperimit midis fermerëve.
- Interesi i familjeve bujqësore për shtimin e të dhirtave duhet të mbështetet pasi kullotat natyrore janë të përshtatshme dhe kanë kapacitet mbajtës trefish më shumë se sa aktuali. Produktet blegtorale të të dhirtave janë shumë të kërkuara nga sektori i turizmit.
- Tropoja si rreth është e njohur edhe për bletarinë. Megjithatë rendimenti është relativisht i ulët. Futja dhe adoptimi nga bletarët i metodave bashkëkohore do të sigurojë rritjen e rendimentit. Përdorimi efektiv i subvencioneve nga shteti është gjithashtu i rëndësishëm.
- Tropoja ka kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Por, zona e Tropojës po përballë me mungesën e burimeve njerëzore në bujqësi dhe blegtori kryesisht për shkak të largimit të rinjve nga fshati. Gjithashtu, në Tropojë ka burime njerëzore të pamjaftueshme dhe të pakualifikuara për bujqësi dhe blegtori. Zhvillimi i tyre është shumë i rëndësishëm. Duhet të rritet niveli kulturor dhe profesional i specialistëve dhe fermerëve në rrethin Tropojës.
- Është e nevojshme të inkurajohet organizimi i fermerët në shoqata.
- Aplikimi me efektivitet i skemave të mbështetjes financiare për fermerët është e rëndësishme për rritjen e prodhimit bujqësor.

3.2. Turizmi

Bukuritë dhe pasuritë natyrore e bëjnë Tropojën një destinacion të rëndësishëm të turizmit malor. Një ndër atraksionet kryesore të Tropojës, por edhe të Shqipërisë, është Lugina e Valbonës që gjithashtu është shpallur Park Natyror Kombëtar. Ajo është zona malore më e vizituar në Shqipëri pas Thethit. Por Tropoja ka shumë atraksione të tjera turistike të pashfrytëzuara. Alpet në zonën e Tropojës përbëhen nga male të larta dhe të thepisur dhe shumë tërheqës si pasojë e veprimit të akullnajave dhe erozionit, me kontraste të lartësive me lugina të thella që përshkohen nga lumenj të vegjël piktoreskë. Tabela 15 tregon një listë të Monumenteve të Natyrës në Tropojë. Përveç Luginës së Valbonës, destinacione të tjera potenciale të turizmit malor janë kanioni i Shoshanit (3 km larg Bajram Currit) dhe luginat e lumenjve të Currajt, Gashit dhe Tropojës.

Tabela 15: Monumentet natyrore

| Monumenti i natyrës | Vendndodhja |
|--|------------------------------------|
| Rrasa e Pesmarrës | Margegaj |
| Shpella e Haxhisë | Maja e Thatë/Margegaj |
| Shkëmbi i Forcës | Curraj i Epërm |
| Burimi karstik i Qirecit | Lekbibaj |
| Rasa e Currajt | Curraj e Poshtëm |
| Liqenet akullnajore të Doberdolit | Çerem |
| Liqenet akullnajore të Sylbicës | Malesia e Gashit |
| Depozitimet fluvio-glaciale të Shoshajt | Shoshan |
| Depozitimet fluvio-glaciale të Shëmtirës | Rragam |
| Breshishta e Ragamit | Rragam |
| Shelgu i Rrjetëzuar | Margegaj |
| Burimi i Qukut të Dunishtës | Valbonë |
| Burimi i Shoshanit | Shoshan |
| Burimet e Valbonës | Valbonë |
| Shpella e Akullit | Valbonë |
| Lugina e varur akullnajore e Kukajt | Ragam |
| Lugina akullnajore e Motinës | Dragobi |
| Kanioni i Shoshanit | Shoshan |
| Blijte në Markaj | Markaj |
| Dushkajat e Qafë-Luzhës | Bytyç |
| Liqeni i Ponarve | Maja e Hekurave/Margegaj |
| Mështekna e Lugut të Zi | Lugu i Zi |
| Ahishtja Gurra e Hasan Gashit | Mali Mërtur |
| Rrobulli në liqenin e Ponarit | Margegaj |
| Arra e Dragobisë | Dragobi |
| Shpella e Dragobisë | Dragobi |
| Ahishta e Vranicës | Mali i Vranicës |
| Lugina e Lumit të Gashit | Pellgu ujëmbledhës i lumit Gashit. |
| Lugina e Valbonës | Valbonë |

3.2.1. Atraksionet turistike

Një ndër atraksionet kryesore të Tropojës, por edhe të Shqipërisë, është Lugina e Valbonës që është Park Natyror Kombëtar. Parku Natyror Kombëtar i Valbonës ndodhet 23 km nga qyteti i Bajram Currit. Parku zë një sipërfaqe prej 8000 hektarësh. Ajo është zona malore më e vizituar në Shqipëri, pas Thethit. Ajo vizitohet masivisht nga turistë të huaj dhe vendas. Ngjitja në ujëvarën dhe përgjatë lumit të Valbonës është një ndër eskursionet më popullore.

Lugina e Valbonës e ka marrë emrin nga lumi i Valbonës që është rreth 50 km i gjatë dhe nis nga Qafa e Valbonës dhe përfundon në luginën e Drinit, pranë digës së hidrocentralit të Fierzës. Prurjet mesatare në Dragobi dhe Gri janë përkatësisht 12.2 m³/sekondë dhe 33.3 m³/sekondë. Lumi ka ujë të ftohtë dhe të kulluar, më të pastrin në Shqipëri, ujëvara—vecanërisht ujëvara e

Rragamit është një mrekulli e natyrës—dhe ka krijuar kanione piktoreske. Lumi i Valbonës është i pasur me “troftën pikaloshë”.

3.2.2 Kapacitetet akomoduese dhe niveli i shërbimit

Shumica e kapacitetit akomodues të turistëve është në Luginën e Valbonës (komuna Margegaj) dhe në qytetin e Bajram Currit (Bashkia Bajram Curri). Bujtinat kanë një kapacitet të vogël dhomash krahasuar me hotelet , megjithëse kanë një

Tabela 16: Kapacitetet akomoduese në Tropojë

| NJQV | # hoteleve | # bujtinave | # dhomave | # shtretërve |
|-----------------|------------|-------------|------------|--------------|
| Bajram Curri | 4 | 0 | 65 | 146 |
| Margegaj | 4 | | 60 | 152 |
| | | 20 | 76 | 280 |
| Gjithsej | 8 | 20 | 201 | 578 |

Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës

numër relativisht të madh shtretërisht. (Tabela 16 pasqyron kapacitetet akomoduese në Tropojë). Kjo shpjegohet me synimin për të akomoduar më shumë vizitorë si dhe me qasjen lidhur me tipologjinë e zonës turistike. Në përgjithësi, turistët që vizitojnë Valbonën janë të organizuar në grupe dhe kërkojnë kushte të thjeshta dhe tradicionale akomodimi dhe ushqim. Përveç hoteleve dhe bujtinave, në Luginën e Valbonës janë edhe 2 kampingje të cilat sistemojnë rreth 45 turistë/ditë. Këta plotësojnë nevojat e vizitorëve që preferojnë të akomodohen në çadrat e tyre.

Vitet e fundit, ka patur një numër të konsiderueshëm të turistëve vendas dhe të huaj, të cilët të tërhequr nga bukuritë natyrore si lugina, liqene, bjeshkë, male si florë dhe faunë e pasur, kanë vizituar Tropojën. Pasuritë natyrore e bëjnë Tropojën shumë të përshtatshme për ecje, alpinizëm, por edhe për peshkim. Në pjesën e brendshme të Parkut Natyror të Valbonës ka mjaft shpella interesante për tu vizituar, nga të cilat dallohet Shpella e Dragobisë. Kalimi nga Lugina e Valbonës në Theth e rrit më shumë tërheqjen e turistëve në zonën e Tropojës. Gjatë viti 2014, sipas të dhënave të mbledhura nga hotelet dhe shtëpitë pritëse, vetëm komuna Margegaj raporton më shumë se 57,000 turistë.

Valbona vizitohet kryesisht gjatë periudhës së verës—maj-shtator. Gjatë muajve të verës, ajo vizitohet mesatarisht nga 700 turistë në ditë. Kohëqëndrimi i vizitorëve është relativisht i shkurtër, 1-7 ditë. Turistët kanë filluar ta vizitojnë Valbonën edhe gjatë pjesës tjetër të vitit. Turistet e huaj vijnë kryesisht nga Evropa Perendimore dhe Qendrore si dhe Amerika e Veriut. Një numër i konsiderueshëm i vizitorëve, sidomos ata një-ditorë, vijnë nga Kosova.

Megjithë zhvillimin e infrastrukturës turistike në Luginën e Valbonës vitet e fundit, tendenca në rritje e numrit të turistëve po nxjerr në pah se kjo infrastrukturë është e pamjaftueshme për të përballuar nevojat. Kjo lidhet si me kapacitetin akomodues, ashtu edhe me ushqimin, guidat turistike, sinjalistikën turistike, etj. Gjithashtu ka dalë nevoja e përmirësimit të shërbimit për t’iu përgjigjur nevojave të vizitorëve me cilësi dhe sipas standarteve të turizmit. Gjithashtu, është e nevojshme që të përmirësohet furnizimi i hoteleve, bujtinave, dhe restoranteve me produkte cilesore bujqesore dhe blegtorale. Megjithë përpjekjet e bizneseve vendase për të ruajtur shërbimin tradicional lidhur me akomodimin dhe ushqimin e vizitorëve, rritja e numrit të

turistëve ka nxjerrë në pah pamundësinë e përballimit me produktë cilësore lokale bujqësore dhe blegtorale. Mungesa e standarteve në përpunim, magazinim dhe paketim ka ndikuar edhe në besimin e vizitorëve ndaj produkteve lokale.

Në përgjithësi hotelet, bujtinat dhe objektete e tjera të shërbimit për turistët janë biznese familjare që nuk i bën shumë të hapur kundrejt trajnimeve profesionale në turizëm. Kjo ka ndikuar në aftësitë menaxhuese të tyre dhe shërbimin sipas standarteve që ju ofrohet turistëve.

Menaxhimi primitiv dhe sporadik i mbetjeve në Luginën e Valbonës dhe më gjërë në Bajram Curr dhe Tropojë ka ndikuar në cilësinë e mjedisit. Pavarësisht natyrës së bukur, ajrit dhe ujit të pastër, prania e mbetjeve urbane ndikon në cilësinë e mjedisit. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në zonë kërkon njëkohësisht kombinimin e mikpritjes tradicionale me zhvillimin e aftësive menaxhuese.

Turistët që vizitojnë Tropojën, udhëtojnë kryesisht nëpërmjet rrugës tokësore Tiranë-Kukës-Morinë-Gjakovë-Qafë Morinë-Bajram Curri/Margegaj ose Prishtinë-Gjakovë-Bajram Curri/Margegaj. Pika kufitare e Qafë Morinës (Kosovë-Shqipëri) përdoret gjerësisht për hyrjen e vizitorëve. Një kategori turistësh udhëtojnë nëpërmjet rrugës tradicionale që lidh Tiranën me Bajram Currin duke synuar të vizitojnë edhe luginën e Drinit dhe destinacionet e tjera përgjatë rrugës. Një pjesë e turistëve kalon në Valbonë nga Thethi. Kryesisht, turistët përdorin transportin privat individual ose të organizuar nga agjensitë.

Një numër guidash lokale shoqërojnë turistët e huaj dhe vendas përgjatë rrugës nga Valbona në Theth.

Në Luginën e Valbonës, hotelet dhe shtëpitë pritëse gatuhnë dhe shërbejnë gatime tradicionale si maza, flija, mishi i pjekur i kecit dhe qingjit (ferlig), patërma, leqeniku, kacamaku, trofta, etj.

3.2.3 Zhvillimi i turizmit në rajon

Turizmi është i pazhvilluar por ka potencial për t'u zhvilluar nëpërmjet sigurimit të një produkti turistik specifik. Bazuar në burimet e pasura natyrore dhe kulturore, ekzistojnë mundësi të rëndësishme për zhvillimin e turizmit në rajon. Rajoni mund të zhvillohet falë një natyrë të pastër dhe të virgjër, trashëgimisë kulturore dhe mikpritjes tradicionale dhe kështu projektin imazhin e mbrojtjes së mjedisit, promovimit të kulturës vendase, eksplorimit të aventurës, dhe mikpritjes dhe guzhinës tradicionale, bazuar në produkte natyrore. Vizitorët e rajonit mund të kategorizohen si më poshtë.

- Shumica e vizitorëve janë shqiptarë nga rajonet e tjera të vendit dhe Kosova;
- Koha mesatare e ndenjes varion nga 2-3 ditë;
- Ka vizitorë të huaj, kryesisht nga Evropa Perëndimore dhe Lindore, të cilët qendrojnë disa ditë dhe janë të interesuar për turizmin malor.
- Megjithatë traditat natyrore dhe kulturore janë një pikë e fortë në rajon, ato ende nuk janë një motiv i mjaftueshëm për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve të huaj.

Të gjithë vizitorët qëndrojnë në hotelet e Luginës së Valbonës dhe të Bajram Currit. Hotelet janë të vogla dhe pronë e bizneseve private. Ato kanë një nivel me 2-3 yje. Çmimi i një dhome varion nga 2000-3000 lekë/nata.

Përderisa atraksionet natyrore, kulturore dhe gastronomike janë një faktor i rëndësishëm për tërheqjen e tregjeve të vegjël turistike, është e nevojshme të bëhet marketingu i duhur dhe të zhvillohet një produkt turistik i përshtatshëm.

Lugina e Valbonës, por edhe Tropoja në përgjithësi, si destinacion turistik përfshijnë 5 komponentë kryesorë:

- Atraksionet: elementët e destinacionit që ofrojnë atraksion dhe motivim për vizitorët;
- Shërbimet: akomodimi dhe ushqimi;
- Transportin: deri në destinacion dhe brenda tij;
- Shërbimet e tjera: dyqanet, shëndetsia, informacioni turistik, etj.;
- Infrastruktura publike: rrugët turistike, shenjat turistike, etj.

Atraksionet e zonës mund të kategorizohen në:

- Atraksione natyrore;
- Atraksione kulturore;
- Atraksione nga dora e njeriut.

Rezultatet e vlerësimit të tyre paraqiten si më poshtë (5=shkelqyeshëm, 1=shumë e varfër):

| Atraksioni | Vlerësimi | | Komente |
|--------------------------------|---|---|---|
| Atraksionet natyrore | Bukuritë natyrore | 5 | Atraksion kryesor, tërheqës dhe unik |
| | Malet dhe kodrat | 5 | Pamje e këndshme, akomodim i kufizuar |
| | Fauna dhe flora | 5 | Potencial për turizëm me interesa specifike |
| Atraksionet kulturore | Arkeologji | 2 | Potencial i papërdorur |
| | Histori | 3 | Potencial i papërdorur |
| | Muzik | 3 | Potencial i papërdorur |
| | Produkte dhe zejtarë nga dora e njeriut | 2 | Potencial i papërdorur |
| Atraksionet nga dora e njeriut | Zonat urbane | 2 | Nevoja për zhvillim të mëtejshëm |
| | Argëtim/çlodhje | 2 | Të pamjaftueshme për tregun e huaj dhe vendas |
| | Agro-turizëm | 3 | I kufizuar dhe i pa zhvilluar |

Segmentet e tregut turistik dhe sfidat

Në rajon, tregu aktual turistik është kryesisht treg i brendshëm—një numër gjithnjë e në rritje i vizitorëve nga Shqipëria dhe Kosova--dhe treg i huaj—një numër gjithashtu në rritje vizitorësh që kanë interesa specifike siç janë adhuruesit e natyrës dhe alpinistët, interesimi i të cilëve është në rritje për eksplorimin e rajonit. Këto segmente kanë një tendencë në rritje. Rritja e numrit të vizitorëve ka çuar në rritje të njësive akomoduese—hotele dhe shtëpi pritëse për mysafirët. Nisur nga tendenca në rritje e vizitave, më shumë se një ditë, është rritur konkurenca midis hoteleve/shtëpive pritëse që ka çuar në përmirësimin e kushteve akomoduese dhe të gatimit. Segmentet kryesore të tregut paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Segmentimi i tregut | Situata aktuale | Potenciali |
|--------------------------------------|-----------------|------------|
| Pushime në mal/natyrë (mesatar) | Mesatar | Në rritje |
| Aktivitete tradicionale (i shkurtër) | I kufizuar | Në rritje |
| Aktivitete me interesa specifike | I kufizuar | Në rritje |

Një perspektivë të mirë kanë pushimet në mal dhe turizmi për interesa speciale, duke përfshirë eksplorimin e natyrës, trashëgiminë kulturore dhe eventet tradicionale specifike.

Analiza e vlerave dhe problemeve turistike

Në tabelën 17 është përmbledhur analiza e vlerave dhe problemeve turistike sipas: Produktit turistik (tërheqjes turistike); Shërbimeve turistike (dhe mikpritjes tradicionale); Infrastrukturës turistike; Promovimit turistik; dhe Qeverisjes lokale.

Tabela 17: Analiza e vlerave turistike në ZFT

| | VLERAT | PROBLEMET |
|-----------------------------|--|---|
| 1. PRODUKTI TURISTIK | <ul style="list-style-type: none"> • Pasuritë natyrore • Monumete natyrore • Relievi i përshtatshëm | <ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura rrugore dytësore e papërshtatshme • Fonde të pamjaftueshme nga pushteti vendor • Experiencë e pamjaftueshme për zhvillimin e turizmit • Lobimi i pamjaftueshëm ndaj institucioneve/organizatave përkatëse • Menaxhim i papërshtatshëm i mbetjeve urbane • Menaxhim i munguar i vlerave turistike, përfshirë mirëmbajtjen, udhëzuesit, etj. • Promovimi dhe mbrojtja e pasurive jo në nivelin e duhur |

| | | |
|--|---|--|
| 2. SHERBIMET TURISTIKE & IKPRITJA | <ul style="list-style-type: none"> • Tradita në shërbimet ndaj mikut; • Festat tradicionale; • Tradita e kulinarisë (gatimet tradicionale); • Gatimet me produkte natyrore | <ul style="list-style-type: none"> • Standartizimi në shërbimet e hoteleve; • Kapacitete të pamjaftueshme njerëzore • Infrastrukturë jo e përshtatshme për përdorimin e potencialeve turistike; • Shtigjet turistike pa infrastrukturën e nevojshme, mungesa e sinjalistikës turistike; • Informacion turistik jo i plotë për shërbimet; • Burime të pamjaftueshme financiare; • Promocioni jo i duhur për produktet natyrore ushqimore; • Largim nga tradita lidhur me kuzhinën dhe produktet artizanale. |
| 3. INFRASTRUKTURA TURISTIKE | <ul style="list-style-type: none"> • Shtëpi tradicionale të mundëshme për shtëpi pritëse për turistë; • Muzeu i qytetit; • Zyra e Informacionit Turistik në Margegaj; • Operatorë turistik funksionalë (paketat e para); • Ekzistenca e librave, dokumentave të botuara mbi historikun dhe traditën. | <ul style="list-style-type: none"> • Kultura e pamjaftueshme e të bërit biznes me anë të shërbimeve turistike; • Muzeu i pasistemuar dhe pastrukturuar si dhe i paplotësuar; • Shoqëruesit e turistëve janë kryesisht amatorë; |
| 4. PROMOVIMI TURISTIK | <ul style="list-style-type: none"> • Zyra e Informacionit Turistik në Margegaj; • Fletëpalosje; • Harta turistike (<i>website</i>); • Panaiet turistike; | <ul style="list-style-type: none"> • Informacioni turistik është i pamjaftueshëm; • Bashkëpunim jo i duhur mes NJQVve për zhvillimin e turizmit. |
| 5. QEVERISJA LOKALE | <ul style="list-style-type: none"> • Vëmendja e qeverisë lokale dhe qendrore • Gadishmëri lokale për bashkëpunim dhe partneritete • Disponueshmëria e fondeve (ka marrëveshje bashkëpunimi që duhem shfrytëzuar) • Binjakëzime ndërkuftare | <ul style="list-style-type: none"> • Plane zhvillimi të papërditësuara • Fonde të pamjaftueshme dhe të destinuara për turizmin • Politika jo të qarta dhe të zbatueshme, të cilat bëhen pengesë për zhvillimin e turizmit lokal • Struktura të pamjaftueshme dhe burime njerëzore me kualifikim të përshtatshëm • Besimi midis qeverisjes lokale me atë qendrore është i pamjaftueshëm dhe anasjelltas |

Analiza e mjedisit për zhvillimin e turizmit

Tabela 18 paraqet analizën e mjedisit—të brendshëm dhe të jashtëm--për zhvillimin e turizmit në ZFT.

Tabela 18: Analiza e mjedisit për zhvillimin e turizmit në ZFT

| | PIKAT E FORTA | PIKAT E DOBETA |
|----------------------------|---|--|
| MJEDISI I BRENDSHEM | <ul style="list-style-type: none"> • Pasuri natyrore (male, kodra, burime ujore, pyje, kullota, etj.) • Klima favorizuese • Historia e pasur • Aktivitete kulturore • Etnografia (veshjet tradicionale) • Produkte natyrore (fruta, perime, etj.) • Mikpritja • Gatime tradicionale • Interesa në rritje për të jetuar në këtë zonë • Operatorë turistikë (hotele, agjenci turistike) | <ul style="list-style-type: none"> • Shërbimet publike jo-cilësore (shëndëtsia, rendi publik, ambjenti) • Shërbimet turistike (kulturë e pamjaftueshme e shërbimit turistik, kapacitete të pamjaftueshme njerëzore për turizmin, vlerat tradicionale të gatimit në rënie, festat kulturore tradicionale në rënie dhe të paevidentuara e të dokumentuara) • Qeverija vendore ende e pa orientuar për të konsideruar shumë nga pasuritë si burime të zhvillimit të turizmit; mungesë bashkëpunimi midis aktorëve lokalë për zhvillimin e rajonit. • Promovimi (evidentimi i kufizuar i vlerave--natyrore, historike dhe kulturore, të gatimit tradicional--si dhe i kapaciteteve njerëzore). • Largësia e fshatrave nga qyteti i Bajram Currit. |
| | MUNDËSITË | PENGESAT |
| MJEDISI I JASHEM | <ul style="list-style-type: none"> • Lobim pranë institucioneve shtetërore për shërbimet publike • Ka një strategji qarku ku turizmi është një komponent i rëndësishëm • Ka NJQV që punojnë në fushën e turizmit • Mundësi për projekte ndërkuftare | <ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i pamjaftueshëm i strategjive kombëtare, rajonale dhe lokale • Fonde të pamjaftueshme për turizmin • Decentralizim i pjesshëm i kompetencave në nivel lokal |

Promovimi

Kohët e fundit është përmirësuar ndjeshëm promovimi i Tropojës si destinacion turistik, kryesisht Luginës së Valbonës. Kapacitetet e vogla akomoduese të shumicës së bujtinave dhe shtëpive pritëse nuk i motivojnë pronarët e tyre të promovojnë biznesin. Në përgjithësi promovimi behët nga agjensitë turistike që organizojnë grupet e turistëve.

3.2.4 Konkluzione dhe rekomandime

- Bukuritë dhe pasuritë natyrore e bëjnë Tropojën një destinacion të rëndësishëm të turizmit malor. Një ndër atraksionet kryesore të Tropojës, por edhe të Shqipërisë, është Lugina e Valbonës. Por Tropoja ka shumë atraksione të tjera turistike të pashfrytëzuara që duhet të jenë në vëmendjen e vendim-marrësve lokalë dhe qëndrorë si Ceremi, Curraj Epërm, Liqeni i Ponarëve, Vargmali i Bjeshkëve, etj. Është e rëndësishme që këto destinacione të promovohen dhe të zhvillohet infrastruktura (rrugore, turistike, etj.) për në këto destinacione.
- Kalimi nga Lugina e Valbonës në Theth e rrit më shumë tërheqjen e turistëve në zonën e Tropojës. Promovimi i paketave turistike që kombinojnë këto dy destinacione turistike do të ndikonte drejtpërsëdrejti në zhvillimin e turizmit malor në zonë.
- Valbona vizitohet kryesisht gjatë periudhës së verës. Por, turistët kanë filluar ta vizitojnë Valbonën edhe gjatë pjesës tjetër të vitit. Është e nevojshme që të mendohet për masat e nevojshme që gradualisht Valbona (dhe Tropoja) të kthehet në destinacion turistik përgjatë gjithë vitit.
- Valbona vizitohet nga turiste të huaj por edhe vendas. Vitet e fundit, pesha specifike e turistëve vendas dhe nga Kosova është rritur. Është e nevojshme që t'i kushtohet vëmendja e duhur kësaj kategorie pasi mund të përbëjë një burim të rëndësishëm dhe të vazhdueshëm të ardhurash për turizmin.
- Megjithë zhvillimin në vitet e fundit të infrastrukturës turistike në Luginën e Valbonës, tendenca në rritje e numrit të turistëve po nxjerr në pah se kjo infrastrukturë është e pamjaftueshme për të përballuar nevojat. Kjo lidhet si me kapacitetin akomodues, ashtu edhe me ushqimin, guidat turistike, sinjalistikën turistike, etj. Është e nevojshme që infrastruktura turistike të përmirësohet më tej në të ardhmen.
- Menaxhimi i hoteleve, bujtinave dhe restoranteve të destinuar për turistët kombinojnë mikpritjen tradicionale me elemente të menaxhimit efektiv. Fakti që bizneset janë kryesisht familjare duket sikur nuk i ka bërë ato shumë të hapur ndaj trajnimeve profesionale në turizëm. Është e nevojshme të zhvillohen kapacitetet menaxhuese dhe për marrdhëniet me klientet në mënyrë që të përmirësohet në vazhdimësi shërbimi.
- Një numër guidash lokale shoqërojnë turistët e huaj dhe vendas përgjatë rrugës nga Valbona në Theth. Shtimi i guidave dhe trajnimit të tyre është një element i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në zonë.
- Gjithashtu, është e nevojshme që të përmirësohet furnizimi i hoteleve, bujtinave, dhe restoranteve me produkte cilësore bujqësore dhe blegtorale. Megjithë përpjekjet e bizneseve vendase për të ruajtur shërbimin tradicional lidhur me akomodimin dhe ushqimin e vizitorëve, rritja e numrit të turistëve ka nxjerrë në pah pamundësinë e përballimit me

produktë cilësore lokale bujqësore dhe blegtorale. Mungesa e standarteve në përpunim, magazinim dhe paketim ka ndikuar edhe në besimin e vizitorëve ndaj këtyre produkteve.

- Kohët e fundit është rritur ndjeshëm promovimi i Tropojës si destinacion turistik, kryesisht Luginës së Valbonës. Në përgjithësi promovimi bëhet nga agjensitë turistike që organizojnë grupet e turistëve. Edhe operatorët turistikë duhet të promovojnë më mirë bizneset e tyre.
- Në Tropojë është zhvilluar kryesisht turizmi malor—ecje, alpinizëm, etj. Është e nevojshme të zhvillohen edhe turizmi kulturor, kurativ dhe lumor. Duhet të bëhet zhvillimi i produktit turistik për vizitorët e huaj dhe vendas të interesuar në turizmin malor dhe të aventurës. Themelore për suksesin e tij mbetet zbatimi i një sërë konceptesh specifike të lidhura me: Përvojat turistike (“gjëra për të parë dhe për t’u bërë nga turisti”); Motivet për të vizituar rajonin (të cilat duhet të jenë joshëse sidomos për tregjet jashtë tij); Interpretimi dhe prezantimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit; dhe Ofrimi i një serie njësisish akomoduese të pranueshme nga tregu.
- Sfida me të cilën përballen zona qëndron në mënyrën se si do të sigurojë në vazhdimësi një varg atraksionesh të përshtatshme për të joshur turistët e së ardhmes nga tregjet kryesore të synuara. Zona ka arsye të forta për t’u vizituar, të cilat duhet t’i përforcojë dhe promovojë. Këto arsye duhet t’u komunikohen qartë si turistëve të huaj, ashtu edhe atyre vendas. Duhet të transmetohet me efektivitet mesazhin se rajoni ofron një numër të atraksionesh të dukshme. Kështu bëhet e mundur që autoritetet dhe bizneset lokale të përmirësojnë pozicionin konkurrues në kushtet e një tregu potencial gjithnjë në rritje, por njëkohësisht edhe selektiv.
- Zona prezanton në mënyrë të varfër trashëgiminë e saj natyrore dhe kulturore, ndërkohë që tregu e vlerëson shumë këtë element si motiv i rëndësishëm për të vizituar zonën. Në zhvillimin e atraksioneve të reja, mund të përmenden: Atraksionet e “forta,” turizmi malor dhe qëndrimi i turistëve në shtëpitë pritëse në fshatra; Atraksionet e “buta” që përdorin burimet ekzistuese që ndonëse kanë nevojë për pak investim, nuk kërkojnë shumë kapital përfshirë objektet historike, evenimentet tematike, kulturore dhe tradicionale, panairët e produkteve tipike të zonës, dhe kuzhina tradicionale për vizitorët e servirur në mënyrë tradicionale. Është e rëndësishme që rajoni të vazhdojë organizimin e evenimenteve kulturore tradicionale duke bërë investimet e nevojshme në infrastrukturë dhe menaxhim. Përveç tyre, duhet inkurajuar inskenimi i eventeve në fshatrat e zonës pasi ato ofrojnë një fokusim të qartë në kulturën dhe traditat e rajonit, të cilat paraqesin interes për vizitorin dhe pasurojnë imazhin e destinacionit. Kalendari i eventeve të reja duhet të: Ofrojë tema kulturore, sportive dhe sociale që pasurojnë imazhin pozitiv të destinacionit; Zhvillohet në mënyrë që eventit të jetë unik për zonën dhe të paraqesë rëndësi kombëtare; Jetë atraktiv për sponsorët potencialë; Gjenerojë më shumë netë qëndrimi të vizitorëve vendas dhe të huaj.
- Duhet të ndërmerren masa për shfrytëzimin me efektivitet të interesit për të investuar në turizëm si dhe të interesit të emigrantëve për tu kthyer në vendin e tyre.

- Duhet të ruhet tendenca për ndërtime dhe arredim sipas traditës që përben një avantazh të turizmit malor në zonën e Tropojës duke mënjanuar betonizimin.
- Gatimet tradicionale nuk po trashëgohen tek brezat e tjerë e shoqëruar kjo me tendencën për gatime të huazuara nga kuzhina të tjera.
- Në Tropojë ka një zyrë turistike në Valbonë. Të shihet mundësia e ngritjes së këtyre zyrave edhe në vende të tjera dhe të përmirësohe informacioni turistik. Zhvillimi i metejshëm i sinjalistikës turistike është i nevojshëm.
- Sigurimi i kreditimit të sektorit në kushte favorizuese është i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.
- Menaxhimi primitiv dhe sporadik i mbetjeve në Luginën e Valbonës dhe më gjërë në Bajram Curri dhe në Tropojë po ndikon në cilësinë e mjedisit. Duhet të ndërmerren masa për të ruajtur cilësinë e mjedisit.
- Turizmi nuk është i orientuar, por kryesisht i zhvilluar në baza të inisiativës dhe mendimit individual. Është e nevojshme që zhvillimi i tij të orientohet. Në këtë kontekst, është i rëndësishëm Zhvillimi i Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit për të gjithë zonën funksionale Tropojë.

3.3 Ndërveprimet ekonomike të zonës funksionale

Bazuar në analizën ekonomike, del në pah një potencial i rëndësishëm lidhur me ndërveprimin ekonomik në Zonën Funktionale Tropojë midis bujqësisë dhe turizmit malor/rural. Disa aspekte të rëndësishme janë:

- Nga njëra anë, zhvillimi i turizmit malor dhe rural në zonën e Tropojës mund të ndikojë drejtpërsëdrejti në rritjen e kërkesës për produkte cilësore natyrore bujqësore dhe blektorale. Kjo do të ishte një shtysë e rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë dhe blektorisë.
- Nga ana tjetër, zhvillimi i bujqësisë dhe blektorisë do të rriste ofertën e sektorit për sektorët e tjerë të ekonomisë dhe për pasojë do të krijonte kushtet për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në Tropojë.
- Një zhvillim i ndërthurur midis sektorëve të bujqësisë dhe blektorisë dhe turizmit do të ndikonte drejtpërsëdrejti në rritjen e punësimit dhe të ardhurave për familjet e përfshira në këto sektorë. Kjo do të ndikonte edhe në zhvillimin e sektorëve të tjerë dhe rritjen e mirëqenies në përgjithësi në Zonën Funktionale Tropojë.

Rekomandime të përgjithshme

- Turizmi malor dhe bujqësia janë sektorët prioritarë të Zonës Funksionale Tropojë dhe zhvillimi i tyre në mbështetje të njëri tjetrit mund të jetë kyçi për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të zonës dhe rritjen e të ardhurave lokale.
- Niveli i prodhimit bujqësor është relativisht i ulët krahasuar me nevojat në rritje të zhvillimit të turizmit në të ardhmen. Duhet të ndërmerren masa për rritjen e tij në sasi dhe cilësi për të plotësuar nevojat e tregut.
- Prodhimi dhe procesimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale është një mundësi e rëndësishme. Tropoja ka prodhime cilësore. Por është e rëndësishme të kalohet nga prodhimet lëndë të para që shiten me çmim të ulët në prodhime të përpunuara që janë cilësore, shiten shtrenjtë dhe gjenerojnë të ardhura të larta.
- Qeverisja vendore duhet të ndërmarrë masa për inkurajimin e zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë dhe turizmit sipas zonave që të plotësojnë nevojat e njera-tjetrës sipas avantazheve të tyre konkurruese. (Për shembull bujqësia dhe blegtoria në komunën e Tropojës dhe turizmi malor në Margegaj).
- Qeverisja vendore duhet të zhvillojë një strategji/plan të integruar të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës funksionale.
- Mbrojtja e mjedisit po bëhet gjithnjë e më tepër një çështje, sidomos me rritjen e fluksit të vizitorëve.
- Vëmendja në rritje e qeverisë qendrore dhe agjensive të zhvillimit dhe donatorëve ndaj zonave malore duhet shfrytëzuar me efektivitetet.
- Bashkëpunimi ndërkufitar dhe rajonal do të ishte një ndihmë e rëndësishme për financimin e projekteve të ndryshme dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.

4. SHERBIMET PUBLIKE NE ZONEN FUNKSIONALE TROPOJË


Ndër shërbimet kryesore që Njësitë e Qeverisjes Vendore ofrojnë për qytetarët në Tropojë janë furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve dhe transporti publik.

4.1 Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet

4.1.1 Të dhëna të përgjithshme për mbulimin me shërbim

Tropoja ka burime ujore të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të popullsisë me ujë. Megjithatë, furnizimit me ujë të pijshëm i banesave nuk është në nivelin e kënaqshëm. Vetëm qyteti i Bajram Currit e ka të mbuluar në një masë të kënaqshme furnizimin me ujë në banesë të banorëve (91%). Komuna e Margegaj ka një përqindje relativisht të lartë të furnizimit me ujë në banesë (72 %). Përqindjen më të ulët të furnizimit me ujë në banesë e ka Lekbibaj me 33 %.

Harta 15: Harta mbi përqindjen e furnizimit me ujë në banesë sipas NJQV



Burimi: Censusi 2011

Harta 15 tregon mbulimin me këtë shërbim nga NJQV-të. Cilësia e shërbimit është e pakënaqshme. Edhe në qytet, orët e furnizimit me ujë janë të pakta. Sistemi i furnizimit me ujë nuk funksionon për të gjithë lagjet.

Furnizimi me ujë në Tropojë realizohet nëpërmjet një ndërthurje të shpërndarjes së ujësjellësve Sh.A. me ata komunalë.


- Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve SH.A. furnizon me ujë rreth 70 % të popullsisë së Tropojës përfshirë qytetin e Bajram Currit si dhe fshatrat e komunave në afërsi të ujësjellësit si Margegaj, Shoshan, Kocane, Fushë Lume, Cernice dhe Sopot dhe po shtrihet edhe në Dojan dhe Bujan. Banorët e qytetit furnizohen me ujë 3 herë në ditë me nga 4 orë/ditë secila ndërsa banorët e fshatrave furnizohen 3 herë në ditë me nga 1 orë

secilën herë. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë është e reduktuar duke bërë që cilësia e shërbimit për banorët të ulet.

- Zonat e tjera që nuk lidhen me ujësjellësin e Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve SH.A. furnizohen nëpërmjet ujësjellësve individual të ndërtuar në komuna. Në fshatrat e largët, furnizimi i banesave me ujë realizohet nëpërmjet puseve ose burimeve natyrore.

Harta 16 tregon mënyrën e furnizimit me ujë sipas Njërive të Qeversijes Vendore. Ndërsa Tabela 19 jep të dhëna për sistemin e furnizimit me ujë sipas NJQV.

Harta 15: Mënyra e furnizimit me ujë sipas NJQV



Burimi: Censusi 2011

Përsa i përket kanalizimeve, ato janë prezent vetëm në Bashkinë e Bajram Currit dhe pjesërisht në Komunën e Margegajt dhe Fierzës. Në komunën e Margegajt është ndërtuar kolektori kryesor i shkarkimit të ujrave të zeza për fshatin Margegaj. Nuk ka kanalizime të ujrave të zeza për fshatrat e tjerë. Në komuna, mungojnë kanalet e ujrave të zeza dhe gropat septike. Ujrat e zeza derdhen në lumenj. Kolektori i qytetit për ujrat nga rreshjet nuk është përfunduar. Projektet në fushën e kanalizimeve kanë qenë të pakta. Mund të përmendim KUZ Dushaj dhe Bajram Curri të financuara nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Tabela 19: Furnizimi me ujë sipas NJQV

| NJQV | Sistemi i furnizimit me ujë | | | | | |
|--------------|-----------------------------|-----------------------------------|--|-------------------------------------|------------------------|-----------------------|
| | Gjithsej | Rrjet ujës-jellësi brenda banesës | Rrjet ujës-jellësi jashtë banesës, por në ndërtesë | Rrjet ujës-jellësi jashtë ndërtesës | Sistem i llojit tjetër | Pa asnjë lloj sistemi |
| BAJRAM CURRI | 1,369 | 1,239 | 106 | 8 | 12 | 4 |
| BUJAN | 577 | 308 | 117 | 122 | 15 | 15 |
| BYTYÇ | 309 | 144 | 12 | 47 | 65 | 41 |
| FIERZË | 345 | 183 | 11 | 37 | 63 | 51 |
| LEKBIBAJ | 206 | 69 | 13 | 111 | 1 | 12 |
| LLUGAJ | 386 | 243 | 31 | 72 | 23 | 17 |
| MARGEGAJ | 515 | 370 | 37 | 77 | 14 | 17 |
| TROPOJË | 781 | 401 | 95 | 126 | 112 | 47 |

Burimi: Census 2011

4.1.2 Problematika kryesore e këtij shërbimi përfshin:

- Mungesë e shërbimit të furnizimit me ujë i të gjithë territorit të zonës funksionale Tropojë. Uji i pijshëm është problem pasi ky shërbim nuk mbulon një pjesë të konsiderueshme të popullsisë (rreth 30%). Më problematike janë komunat e Lekbibajt dhe Bytycit dhe fshtrat e largët të komunave të tjera të Tropojës. Ndërsa shërbimi i kanalizimeve i ofrohet vetëm rreth 70% të popullsisë.
- Cilësia e shërbimit të furnizimit me ujë të konsumatorëve është e dobët. Konsumatorët nuk furnizohen në mënyrë të vazhdueshme (banorët e qytetit furnizohen me ujë 3 herë në ditë me nga 4 orë/ditë secila ndërsa banorët e fshatrave furnizohen 3 herë në ditë me nga 1 orë secilën herë; kohëzgjatja e furnizimit me ujë është e reduktuar në vend që të rritet), nuk sigurohet presioni i nevojshëm i ujit, ka vonesa në riparimin e difekteve, etj.
- Performancë e dobët në administrimin dhe menaxhimin e ujit të pijshëm për shkak të mungesës së planeve për menaxhimin e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, nivelit të ulët të arkëtimit (kryesisht për shkak të mungesës së matësve dhe një sistemi modern dhe të besueshëm faturimi dhe arkëtimi), koston e lartë të shërbimit (kryesisht për shkak të efikasitetit të ulët, amortizimit të lartë, shpenzimeve të larta administrative, borxheve që i kanë ndërmarrjes së ujës-jellësit klientët), mungesa e investimeve, etj.

4.1.3 Infrastruktura e shërbimit të furnizimit me ujë dhe trajtimi i ujrave të ndotura (kanalizimet)

Tropoja ka burime ujore të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të popullsisë me ujë. Cilësia e burimeve ujore është shumë e mirë. Për furnizimin me ujë përdoren ujrave të burimeve sipërfaqesore. Nuk bëhet ndonjë trajtim i veçantë sepse cilësia e ujit është sipas kërkesave higjieno-sanitare dhe fiziko-kimike të përcaktuara nga standartet e cilësisë së ujit të pijshëm.

Burimi kryesor i ujit që përdoret për ujësjellësin e administruar nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve SH.A. është në Qukun e Dunishës që ndodhet 21.5 km larg qytetit të Bajram Currit. Furnizimi bëhet me vetërrjedhje.

Në përgjithësi, furnizimi bëhet me rrjedhje të lirë. Në Fierzë furnizimi bëhet me ngritje mekanike që krijojnë probleme lidhur me koston duke qenë se përdoret energjia elektrike për ngritjen mekanike).

Sistemi i ujësjellësit që menaxhohet nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve SH.A. ka 4 depo furnizimi me ujë me nga 400 m³ ujë.

Investimet në sistemin e furnizimit me ujë kanë qenë të pamjaftueshme për të siguruar furnizimin cilësor të banorëve. Ndër investimet kryesore gjatë viteve të fundit mund të përmendim Ndertimi i Ujësjellësit të fshatrave Paqe, Flumi, Shoshan, Margegaj, Kocanaj, (2011), Ndertimi i ujësjellësit të fshatit Markaj (2011), Ndertimi i ujësjellësit të fshatit Prush (2011) të financuara nga KfË. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka financuar ndertimin dhe/ose rikonstrukcionin e disa ujësjellësve gjatë viteve 2006-2012 si në Dushaj, Tropojë, dhe Valbonë. Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka financuar rrjetin e brendshëm të ujësjellësit në Cërnicë.

4.1.4 Struktura menaxhuese

Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujrave të ndotura (kanalizimet) janë detyrë funksionale e Njësi të Qeverisjes Vendore. Te gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore e mbulojnë këtë shërbim nëpërmjet operatorit të ujësjellës-kanalizimeve të vendosur në zyrën e shërbimeve në komuna dhe nga Ndërmarrja e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve SH.A. e Bajram Currit. Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve SH.A. administrohet nga Këshilli Mbykqyrës që përbëhet nga përfaqësuesit të bashkisë Bajram Curri dhe komunave të tjera të Tropojës (përveç Lekbibajt)--Bujan, Margegaj, Llugaj, Tropojë, Bytyç dhe Fierzë. Komuna e Fierzës është pjesë e SH.A. por nuk përdor ujësjellësin e administruar nga SH.A. për furnizimin me ujë.

Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve SH.A. ka një personel prej që përbëhet nga stafi teknik, stafi i faturimit/shitjeve, dhe menaxhimi. Asetet e kompanisë përfshijnë 21.5 km linjë e tubacionit kryesor, zyrat, makineri dhe pajisje.

Tarifat e përcaktuara për ujin janë përkatësisht 19, 60 dhe 80 lekë/m³ për konsumatorët familjarë, buxhetorë dhe privat. Përsa i përket konsumatorëve familjarë, është përcaktuar një tarifë për shërbimin për çdo abonent prej 160 lekë/muaj për person (sipas çertifikatës së gjendjes familjare). Arsyeja është sepse matësit e ujit nuk funksionojnë dhe/ose ekzistojnë. Kjo tarifë mbledhet në rreth 35% dhe nuk mbulon koston.

4.1.5 Përmbledhja e gjetjeve kryesore

- Tropoja ka burime ujore të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të popullsisë me ujë. Megjithatë, furnizimit me ujë të pijshëm i banesave nuk është në nivelin e kënaqshëm.
- Shërbimit i furnizimit me ujë nuk mbulon një pjesë të konsiderueshme të popullsisë (rreth 30%). Më problematike janë komunat e Lekbibajt dhe Bytycit dhe fshatrat e largët të komunave të tjera të Tropojës.
- Konsumatorët nuk furnizohen në mënyrë të vazhdueshme por periodike dhe kohëzgjatja e furnizimit ka ardhur duke u ulur.
- Performanca në administrimin dhe menaxhimin e ujit të pijshëm është e dobët për shkak të mungesës së planeve për menaxhimin e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, nivelit të ulët të arkëtimeve, kostos së lartë të shërbimit, dhe mungesës së investimeve.
- Niveli i arkëtimeve është i ulët (rreth 35%) dhe lidhet edhe me mungesën ose mos-funksionimin e matësve të ujit.
- Shpenzimet mbulohen në një përqindje të vogël nga të ardhurat (rreth 35-40%).
- Në përgjithësi furnizimi bëhet me rrjedhje të lirë. Në Fierzë furnizimi bëhet me ngritje mekanike që krijon probleme lidhur me koston duke qenë se përdoret energjia elektrike për ngritjen mekanike).
- Shërbimi i kanalizimeve ekziston vetëm në Bashkinë e Bajram Currit dhe pjesërisht në Komunën e Margegajt dhe Fierzës.

4.1.6 Rekomandime për organizimin/integrimin e shërbimit në njësinë e re

- Përmirësimi i menaxhimit të furnizimit me ujë duhet të jetë prioritet i qeverisjes vendore. Kjo duhet të synojë në: Rritjen e mbulimit me furnizim dhe rritjen e oreve të furnizimit me ujë të banoreve; Furnizimin me ujë të fshatrave të pambuluara; dhe Zhvillimin e burimeve njerëzore për menaxhimin e ujesjellesit (specialistët, inxhinierët hidro, etj.).
- Për shkak të mungësës së matësve, në Bajram Curri tarifa për furnizimin me ujë është për çdo person. Nga ana tjetër, edhe në këtë formë kjo tarife mbledhet vetëm rreth 35% dhe nuk mbulon kostot e shërbimit. Është e nevojshme të vendosen matësat dhe përcaktohet tarifa e ujit dhe plani për mbledhjen e saj.
- Kanalizimet duhet të vihen në qendër të vëmendjes sepse kanë të bëjnë drejtpërdrejt me cilësisë e jetësës së qytetarëve si dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Kryerja e një studimi fizibiliteti për sistemin e ujit të pijshëm dhe KUZ për gjithë territorin e Tropojës dhe zhvillimi i një plani për menaxhimin e ujit dhe kanalizimeve është domosdoshmëri.

4.2 Menaxhimi i mbetjeve

4.2.1 Përshkrimi i situatës aktuale të ofrimit të shërbimit

Mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve është një nga funksionet e njësive vendore. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane realizohet në kuptimin e mirëfilltë vetëm në Bashkinë Bajram Curri. Komunitet Bujan, Margegaj, Tropojë, Llugaj dhe Fierzë e ofrojnë atë ose në mënyrë sporadike ose në mënyrë shumë të kufizuar. Në komunat Lekbibaj dhe Bytyc nuk ofrohet ky shërbim në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Në bashkinë Bajram Curri aktualisht shërbimi ofrohet nga vetë bashkia ndërsa 5 komunat e përmendura më sipër--Bujan, Margegaj, Tropojë, Llugaj dhe Fierzë--ofrojnë shërbimin e pastrimit vetë dhe në bashkëpunim me bashkinë Bajram Curri. Ka një bashkëpunim mbi baza informale midis bashkisë Bajram Curri dhe pesë komunave përreth saj në menaxhimin e mbetjeve që konsiston në përdorimin nga këto komuna të vend-depozitimit të mbetjeve të bashkisë Bajram Curri. Sipas njësive vendore, mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve është i ndryshëm. Numri i popullsisë, numri i familjeve dhe numri i familjeve që marrin shërbimin paraqitet në tablën 20.

Tabela 20: Numri i popullsisë, numri i familjeve që u ofrohet shërbimi, 2011-2013

| NJQV ⁴ | 2011 | | | | 2012 | | | | 2013 | | | |
|-------------------|---------------------|-----------------|--------------------------------------|-----|---------------------|-----------------|--------------------------------------|-----|---------------------|-----------------|--------------------------------------|-----|
| | Nr i popu - Illsisë | Nr Fami - ljeve | Nr i familjeve që i ofrohet shërbimi | | Nr i popu - Illsisë | Nr fami - ljeve | Nr i familjeve që i ofrohet shërbimi | | Nr i popu - Illsisë | Nr fami - ljeve | Nr i familjeve që i ofrohet shërbimi | |
| | | | # | % | | | # | % | | | # | % |
| B. Curri | 8357 | 2510 | 2510 | 100 | 8300 | 2500 | 2500 | 100 | 8219 | 2485 | 2485 | 100 |
| Bujan | 3407 | 900 | 390 | 43 | 3300 | 880 | 360 | 41 | 3209 | 852 | 325 | 38 |
| Fierzë | 2500 | 570 | 299 | 52 | 2530 | 597 | 289 | 48 | 2610 | 646 | 300 | 46 |
| Margegaj | 3149 | 998 | 627 | 62 | 3153 | 1005 | 634 | 63 | 3089 | 993 | 635 | 64 |
| Tropojë | 5584 | 1925 | - | - | 5362 | 1828 | - | - | 5150 | 1658 | 650 | 40 |

Burimi: Të dhëna nga NJQV-të

Të dhënat e mësipërme tregojnë se gjatë viteve 2011-2013 shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet në masën 100% për popullsinë dhe familjet e bashkisë Bajram Curri, ndërsa në 4 komunat e tjera kjo përqindje varion nga 38%-64%. Komuna Margegaj ka mbulimin më të madh krahasuar me tre komunat e tjera. Në komunën Margegaj ky mbulim është rritur nga viti në vit

⁴ Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në zonën funksionale Tropojë është analizuar për 5 NJQV përfshirë bashkinë Bajram Curri dhe komunat Bujan, Fierzë, Margegaj dhe Tropojë për të cilat është bërë e mundur grumbullimi i të dhënave.

për gjatë periudhës 2011-2013. Kjo shpjegohet edhe me rritjen e kërkesave lidhur me zhvillimin e turizmit malor në Luginën e Valbonës. Ndërsa në komunat Bujan dhe Fierzë, përqindja e familjeve të cilave ju ofrohet shërbimi i mbetjeve është ulur nga viti në vit. Popullsia e njësive vendore dhe numri i familjeve ka rënie relative në të gjitha njësitë vendore, me përjashtim të komunës Fierzë që mund të ndikojë në uljen relative të sasisë së mbetjeve të prodhuara. Shërbimi i pastrimit përsa i përket mbulimit të territorit dhe frekuencës së shërbimit paraqitet në tablën 21.

Tabela 18: Shërbimi i pastrimit sipas % e sipërfaqes së mbuluar, frekuencës së pastrimit në NJQV-të

| NJQV | Mbulimi i territorit të NJQV | Frekuenca e ofrimit të shërbimit në dy javë | Frekuenca e ofrimit të shërbimit sipas llojit të mbetjeve | | | |
|-----------------|------------------------------|---|---|----------------|------------------|--------------------|
| | | | Mbetje urbane | Mbetje inerte | Mbetje spitalore | Mbetje industriale |
| B. Curri | 70-90% | 14 | Çdo ditë | 3 herë/dy javë | 3 herë/dy javë | 3 herë/dy javë |
| Bujan | 30-50% | 3 | Jo i rregullt | Jo i rregullt | Jo i rregullt | Jo i rregullt |
| Fierzë | 0-30% | 3 | Çdo ditë | - | - | - |
| Margegaj | 70-90% | 3 | 2 herë/javë | - | - | - |
| Tropojë | 30-50% | 1 | 1 herë/2 javë | - | - | - |

Burimi: Të dhëna nga NJQV-të

Bajram Curri dhe Margegaj mbulojnë 70-90% të territorit me shërbim të pastrimit. Komuna Fierzë mbulon një territor shumë të vogël (më pak se 30% të territorit) dhe kryesisht qendrën e NJQV-së.

Llojet dhe sasia e mbetjeve

Llojet e mbetjeve të prodhuara janë urbane, inerte, spitalore dhe industriale. Në bashkinë Bajram Curri, 54% e mbetjeve janë organike, 16.1% janë letër, 1.3% metale, 16.8% plastikë, 6.8% qelq, etj. Bashkia Bajram Curri, e cila ka përqëndrimin më të madh të popullsisë, bizneseve dhe institucioneve publike, ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportimit në vend-depozitim të të gjithë llojeve të mbetjeve. Komunat raportojnë vetëm për mbetje urbane. Shërbimi i pastrimit për mbetjet urbane është më i shpeshtë dhe konkretisht çdo ditë për bashkinë Bajram Curri dhe komunën Fierzë, 2 herë në javë për komunën Margegaj dhe 1 herë në dy javë për komunën Tropojë. Përsa i përket mbetjeve të tjera (inerte, spitalore, industriale), Bajram Curri realizon pastrimin e tyre 3 herë në 2 javë. Transporti bëhet me makina të zakonshme. Bashkia ka dy

makina teknologjike të cilat nuk përdoren për arsye teknike. Tabela 22 paraqet sasinë e mbetjeve në ton sipas llojeve në NJQV-ve.

Tabela 22: Sasinë e mbetjeve në ton sipas llojeve në NJQV-ve

| NJQV | 2011 | | | 2012 | | | 2013 | | |
|----------|---------------|---------------|------------------|---------------|---------------|------------------|---------------|---------------|------------------|
| | Mbetje urbane | Mbetje inerte | Mbetje spitalore | Mbetje urbane | Mbetje inerte | Mbetje spitalore | Mbetje urbane | Mbetje inerte | Mbetje spitalore |
| B.Curri | 2400 | 1200 | 0.3 | 2700 | 1400 | 0.3 | 2700 | 1400 | 0.3 |
| Bujan | 280 | 900 | - | 270 | 1300 | - | 260 | 1900 | - |
| Fierzë | 3.5 | - | - | 3.7 | - | - | 4 | - | - |
| Margegaj | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Tropojë | 12 | 48 | - | 10 | 18 | - | 9 | 35 | - |

Burimi: Për Bashkinë Bajram Curri, Këshilli i Qarkut Kukës; Për komunitat, NJQV-të

Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve

Aktualisht, menaxhimi i mbetjeve kryhet nga NJQV-të. Për një periudhë kohe (2009-2012), bashkia Bajram Curri kishte kontraktuar një kompani private për të realizuar këtë shërbim.

Në përgjithësi infrastruktura për menaxhimin e mbetjeve është më e mirë në Bashkinë e Bajram Currit dhe e kufizuar në komunitat përrëth. Bashkia Bajram Curri ka 180 konteniere me kapacitet 1.1 m³ (të vendosura në 2012) dhe 10 pika të hapura betoni (të ndërtaura në 2005), 2 kamionë 5 ton dhe 1 kamioncinë 1 ton, 1 fadrome, 1 autobot uji dhe 1 borëpastruese (të gjithë mjetet janë të vitit 2013). Bashkia ka 26 punonjës që merren me menaxhimin e mbetjeve përfshirë grumbullim/transport (9 persona), fshirje (13 persona), depozitim (2 persona) dhe administratë (2 persona). Përsa i përket Njërive të tjera të Qeverisjes Vendore, komuna Margegaj ka 25 konteniere me kapacitet 1.1 m³ (të vendosura që nga viti 2010) dhe një kamioncinë. Komuna Tropojë ka 3 konteniere 1.1 m³ (të vendosura që nga viti 2009). Në komuna, kazanët janë vendosur vetëm në qendrat e komunës. Ndërsa fshatrat e tjerë në përgjithësi nuk kanë kazanë dhe i hedhin mbeturinat nëpër përrenj, duke ndotur mjedisin dhe ujrat.


Në bashkinë Bajram Curri, grumbullimi i mbetjeve bëhet me krahë dhe transporti i tyre me makina të thjeshta sepse kamionët teknologjikë janë jashtë funksionit për arsye teknike. Gjithashtu, edhe komunitat që përdorin vend-depozitim të mbetjeve të bashkisë Bajram Curri bëjnë grumbullimin/ngarkimin e tyre me krahë dhe transportin me makina të thjeshta (kamioncina).

Pastrimi i rrugëve/fshirja realizohet në mënyrë mekanike (me fshese). Sipërfaqja e rrugëve që pastrohen/fshihen në bashkinë Bajram Curri është rreth 60,000 m² (ndërsa sipërfaqja e rrugëve të shtruara është rreth 26,000 m²).

Vend-depozitimi i mbetjeve

Bashkia Bajram Curri ka një vend-depozitim të autorizuar për mbetjet urbane dhe inerte në Kojë që është një gropë natyrale me sipërfaqe 7500 m² dhe kapacitet 50,000 m³ që ndodhet rreth 3.5 km larg qytetit të Bajram Currit. Ky vend depozitim administrohet nga bashkia, ndërsa komunat Bujan, Margegaj, Llugaj dhe Fierzë janë të lejuara të transportojnë mbetjet atjenë bazë të një marrveshje jo-formale. Harta 17 paraqet pozicionimin e vend-depozitimit në Kojë dhe Komunat e tjera nuk i transportojnë dhe hedhin mbeturinat në vend depozitim, pasi transporti është i kushtueshëm për arsye të largësisë dhe gjendjes së rrugëve. Komuna Tropojë ka një vend depozitim të autorizuar për mbetjet urbane prej 150 m². Komuna Fierzë përdor një vend depozitim ilegal për mbetjet urbane.

Harta 17: Pozicionimi i vend-depozitimit në Kojë



Burimi: Projekti SELEA

Nuk ka një landfill për Zonën Funktionale Tropojë. Është bërë një përpjekje për të pasur një të tillë së bashku me Hasin, por nuk është mundur një gjë e tillë.

Përpunimi i mbetjeve

Nuk ka riciklim të mbetjeve apo grumbullim të diferencuar të mbeturinave. Mbetjet e rrezikshme spitalore nuk trajtohen. Bashkia Bajram Curri komposton rreth 853 ton mbetje të ngurta

shtëpiake, ose rreth 35% të atyre të prodhuara. Në fshatra bëhet kompostim individual, por nuk ka të dhëna lidhur me sasinë e mbetjeve të kompostuara.

Kosto e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe financimi i shërbimit

Bashkia Bajram Curri ka një buxhet vjetor prej rreth 8 milion lekësh për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Ky buxhet në vitin 2013 përbën rreth 13% të buxhetit vjetor të bashkisë (7,997,722 krahasuar me 58,032,000 lekë). Ka një tendencë në rritje në terma absolute (nga 5,120 mijë mijë lekë që ishte deri në vitin 2013) në krahasim me buxhetin për pastrimin që ishte kontraktuar me kompaninë private.

Për komunat, në përgjithësi të dhënat lidhur me buxhetin e NJQV-ve për menaxhimin e mbetjeve dhe raportin e tyre me buxhetin e Njesisë Vendore nuk janë të plota ose mungojnë. Në vitin 2013, në komunën Fierzë përqindja e buxhetit për pastrimin krahasuar me buxhetin e komunës është rreth 6% (750 mijë krahasuar me 11,700 mijë lekë). Në komunën Margegaj, në vitin 2013 kjo shifër është rreth 2% (500 mijë krahasuar me 23,000 mijë lekë).

Bashkia Bajram Curri aplikon një tarifë shërbimi për qytetarët, bizneset dhe institucionet të miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë sipas dispozitave ligjore të përcaktuara. Tabela 23 paraqet tarifat për bashkinë Bajram Curri në tre vitet e fundit.

Tabela 23: Tarifat e pastrimit në bashkinë Bajram Curri

| Bajram Curri | | | |
|-----------------|--------|--------|--------|
| | 2011 | 2012 | 2013 |
| Familjet | 700 | 700 | 700 |
| Biznesi i vogel | 10,000 | 15,000 | 15,000 |
| Biznesi i madh | 20,000 | 25,000 | 25,000 |
| Institucionet | 25,000 | 30,000 | 30,000 |

Burimi: Të dhëna nga bashkia Bajram Curri

Ndërsa tarifa për familjarët ka ngelur e pandryshuar, tarifat për biznesin dhe institucionet janë rritur në vitin 2012 përkatësisht me 50 %, 25 % dhe 20 % përkatësisht për bizneset e vogla, të mëdha dhe institucionet. Të ardhurat e gjeneruara nga mbledhja e tarifës së pastrimit janë të ulëta për të mbuluar koston e shërbimit. Kështu, në Bashkinë Bajram Curri, të ardhurat përbëjnë rreth 38% të koston. Arsyet lidhen me tarifën e ulët të pastrimit (700 lekë/familje në vit, 1500 lekë/biznes, 2500 lekë/biznes të madh dhe 3000 lekë /institucion në vitin 2013) dhe shkallën e ulët të realizimit të pagesave (19% për familjarët, 53% për bizneset e vogla dhe 68% për bizneset e mëdha). Shih tabelat 22 dhe 23 për të ardhurat e gjeneruara nga tarifat dhe raportin midis koston operative dhe të ardhurat e gjeneruara nga tarifat.

Sic u përmend më lart, në vitin 2013 shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ka kaluar nga një kompani private e kontraktuar nga bashkia në menaxhimin e vetë Bashkisë. Këtë vit, kosto operative e menaxhimit të mbetjeve është rritur me rreth 60%. Ndërkohë të ardhurat e gjeneruara

janë pothuaj të njëjta. Kjo ka bërë që përqindja e mbulimit të kostos operative nga të ardhurat e gjeneruara të ulet nga 63 % në 38 %. Kostot dhe të ardhurat nga shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Bajram Curri në (000 lekë) paraqiten në tabelën 24. Ndërsa Tabela 25 paraqet raportin midis kostos operative dhe të ardhurave të gjeneruara nga tarifatat në bashkinë Bajram Curri.

Tabela 24: Të ardhurat e gjeneruara nga tarifatat në bashkinë Bajram Curri

| Lloji | 2011 | | 2012 | | 2013 | |
|-----------------|-------------------|-----------------|-------------------|-----------------|-------------------|-----------------|
| | Faturuar (000lek) | Paguar (000lek) | Faturuar (000lek) | Paguar (000lek) | Faturuar (000lek) | Paguar (000lek) |
| Familjet | 260 | 191 | 280 | 321 | 290 | 340 |
| Biznesi i vogël | 1878 | 1853 | 1900 | 1850 | 2100 | 1834 |
| Biznesi i madh | 500 | 440 | 560 | 460 | 620 | 510 |
| Institucionet | 465 | 465 | 585 | 585 | 585 | 585 |

Burimi: Të dhëna nga bashkia Bajram Curri

Tabela 25: Raporti midis kostos operative dhe të ardhurave të gjeneruara nga tarifatat në bashkinë Bajram Curri

| Vitet | Kosto operative | Te ardhurat e gjeneruara nga tarifatat | Te ardhurat e gjeneruara nga tarifatat % |
|-------|-----------------|--|--|
| 2009 | 5,120 | 2,929 | 57 |
| 2010 | 5,120 | 2,817 | 55 |
| 2011 | 5,120 | 2,949 | 58 |
| 2012 | 5,120 | 3,216 | 63 |
| 2013 | 8,544 | 3,269 | 38 |

Burimi: Të dhëna nga bashkia Bajram Curri

Nuk ka sanksione për mospagesë të tarifës. Komunitat pothuaj nuk kanë asnjë të ardhur nga menaxhimi i mbetjeve. Tarifa e aplikuar prej tyre është e ulët. Në komunën Fierzë në vitin 2013 është aplikuar një tarifë prej 500, 10,000 dhe 5,000 lekë në vit përkatësisht për familjarët, biznesin e vogël dhe institucionet. Komuna Bujan, në vitin 2013 ka aplikuar një tarifë prej përkatësisht 200, 800 dhe 400 lekë në vit. Përveçse tarifica është e ulët, edhe baza e tarifës mbi të cilën ajo aplikohet është shumë e vogël për arsye edhe të informalitetit të lartë në ekonomi.

4.2.2 Problematika kryesore e Zonës Funktionale Tropojë lidhur me menaxhimin e mbetjeve

- Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane realizohet në kuptimin e mirëfilltë vetëm në Bashkinë Bajram Curri. Komunitet Bujan, Margegaj, Tropojë, Llugaj dhe Fierzë e ofrojnë atë ose në mënyrë sporadike ose në mënyrë shumë të kufizuar. Në komunitet Lekbibaj dhe Bytyc nuk ofrohet ky shërbim në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.
- Shërbimi i menaxhimit nuk ofrohet në masën e duhur. Ky shërbim ofrohet për popullsinë dhe familjet e bashkisë Bajram Curri, ndërsa në 4 komunitet e tjera kjo përqindje varion nga 38%-64%. Në disa komunitet si Bujan dhe Fierzë përqindja e familjeve të cilave ju ofrohet shërbimi i mbetjeve është ulur.
- Megjithë përpjekjet e kohëve të fundit, rritja e kështesave për menaxhimin e mbetjeve nga zhvillimi i turizmit malor, sidomos në komunitet Margegaj, nuk ka gjetur përgjigjen e duhur. Në komunitet Margegaj nuk ka një sistem të grumbullimit të mbetjeve të ngurta. Mbetjet trajtohen në mënyra tradicionale. Në shumë raste mbetjet plastike dhe të tjera janë presente në mjedis. Nuk ka përpjekje për ndërgjegjësimin e popullsisë lidhur me ruajtjen e mjedisit.
- Megjithë investimet në infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve, ajo ngelet problematike. Në bashkinë Bajram Curri, grumbullimi i mbetjeve bëhet me krahë dhe transporti i tyre me makina të thjeshta sepse kamionët teknologjikë janë jashtë funksionit për arsye teknike. Njësitë e tjera të Qeverisjes Vendore kanë infrastrukturë të dobët—numër të vogël kontenerësh dhe mungesë kamionësh teknologjike. Në komunitet, ka kontenerë vetëm në qendrat e komunitet. Fshatrat e tjerë në përgjithësi nuk kanë kazanë dhe i hedhin mbeturinat nëpër përrenj, duke ndotur mjedisin dhe ujrat.
- Pastrimi i rrugëve/fshirja realizohet në mënyrë mekanike (me fshese).
- Nuk ka një *landfill* për Zonën Funktionale Tropojë. Komunitet Bujan, Margegaj, Llugaj dhe Fierzë që transportojnë mbetjet në vend-depozitim të bashkisë Bajram Curri nuk kanë një marrëveshje formale që të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet reciproke.
- Komunitet e tjera nuk i transportojnë dhe hedhin mbeturinat në vend depozitim, pasi transporti është i kushtueshëm për arsye të largësisë dhe gjendjes së rrugëve. Ka edhe vend depozitime ilegale që ndikojnë negativisht në cilësinë e ambientit.
- Nuk ka riciklim të mbetjeve apo grumbullim të diferencuar të mbeturinave.
- Mbetjet e rrezikshme spitalore nuk trajtohen.
- Sasat e mbetjeve të ngurta shtëpiake që kompostohen është e ulët. Nuk ka të dhëna lidhur me sasinë e mbetjeve të kompostuara në fshatra.
- Të ardhurat e gjeneruara nga mbledhja e tarifës së pastrimit janë të ulëta për të mbuluar koston e shërbimit. Kështu, në Bashkinë Bajram Curri, të ardhurat përbëjnë rreth 38% të koston. Arsyet lidhen me tarifën e ulët të pastrimit dhe shkallën e ulët të realizimit të pagesave. Nuk ka sanksione për mospagese të tarifës. Komunitet pothuajse nuk kanë të ardhura nga menaxhimi i mbetjeve. Tarifa e aplikuar prej tyre është e ulët, për një bazë të vogël subjektsh dhe që mbledhet në masë të ulët.
- Nuk ka një plan të menaxhimit të mbetjeve. Nuk ka politika dhe rregullore të brendshme për menaxhimin e mbetjeve. Nuk është bërë ndonjëherë matja e kënaqësisë së qytetarëve lidhur me cilësinë e shërbimit të ofruar.

4.2.3 Hapat për integrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve midis NJQV-ve pjesë e Zonës Funktionale Tropojë

Skemat e mundshme të bashkëpunimit

Duke pasur parasysh situatën e menaxhimit të mbetjeve dhe nje përlllogaritje të përafërt të kostos së menaxhimit të mbetjeve, një skemë e mundshme e ofrimit të shërbimit konsiston në dy qasje:


1. Bashkia Bajram Curri dhe fshatrat e mëdhenj të komunave përreth saj të realizojnë një menaxhim të përbashkët të mbetjeve që konsiston: për bashkinë Bajram Curri, mbledhja ditore e mbetjeve dhe transportimi i tyre në vend-depozitimin e Kojës; për komunat Bujan, Margegaj, Tropojë dhe Llugaj, mbledhjen e tyre dy herë në javë dhe transportimin po në vend-depozitimin e Kojës; për komunat Fierzë, Bytyc dhe Lekbibaj, mbledhjen e tyre një herë në javë dhe transportimin po në vend-depozitimin e Kojës. Një skemë e tillë potenciale bazohet në koston totale vjetore të shërbimit sipas NJQV-ve dhe koston vjetore të shërbimit për banorsipas NJQV-ve. Në këtë mënyrë, krijohet mundësia që të eliminohen vend-depozitimet ilegale të cilat ndosin ambjentin dhe minojnë zhvillimin e turizmit. Kosto e përafërt e përbashkët për shërbimin paraqitet në tabelën 26.

Tabela 26: Kosto e përafërt për shërbimin e pastrimit sipas NJQV-ve

| NJQV | Kamionë (5 ton) | Kazanë (1.1 m ³) | Punonjës | Kosto operacionale (mirëmbajtje, grumbullim, transport, per depozitim, amortizim) lekë/v | Investime kapitale (kamionw, kazan) | Kosto për banor lekë/v |
|--------------|-----------------|------------------------------|----------|--|-------------------------------------|------------------------|
| Bajram Curri | 2 | 95 | 3 | 4,648,901 | 9,286,894 | 1,338 |
| Bujan | 1 | 55 | 3 | 3,899,448 | 5,518,778 | 1,924 |
| Bytyc | 1 | 36 | 3 | 3,741,640 | 4,846,253 | 2,833 |
| Fierzë | 1 | 27 | 3 | 3,453,168 | 4,530,786 | 3,490 |
| Lekbibaj | 1 | 27 | 3 | 3,875,299 | 4,545,345 | 3,857 |
| Llugaj | 1 | 41 | 3 | 3,536,534 | 5,036,944 | 2,326 |
| Margegaj | 1 | 49 | 3 | 3,918,786 | 5,286,883 | 2,198 |
| Tropojë | 1 | 90 | 3 | 4,420,031 | 6,724,002 | 1,342 |

Në këtë përlllogaritje të përafërt të kostos, nuk janë përlllogaritur kostot e vend-depozitimit. Në rastin e bashkisë Bajram Curri, investimet kapitale do të ishin më të ulëta pot ë kemi parasysh se ajo ka infrastrukturën e nevojshme (koshat dhe makinat) por që nuk janë compatible. Makina teknologjike dhe punonjësit mund të përdoren për të gjithë komunave në bazë të një grafiku të studiuar. Ndërsa Grafiku 25 paraqet koston/banor/vit sipas NJQV-ve.

Grafiku 25: Kosto për banorë në vit sipas NJQV-ve



Nga grafiku del qartë se kosto totale vjetore për banor e shërbimit është shumë më e lartë në rastin e komunave Lekbibaj, Fierze dhe Bytyc. Arsyet lidhen me largësinë dhe numrin e ulët të banorëve në këto komuna. Duke pasur parasysh sa me sipër, në këto komuna frekuenca e transportimit të mbetjeve do të ishte më e rrallë (një herë në javë ose më rrallë) duke ulur në këtë mënyrë koston e shërbimit.

- Menxhim individual të mbetjeve për fshatrat e largët (që njëkohësisht janë me dendësi të ulët të popullsisë) të komunave duke mundësuar kompostimin e mbetjeve sipas standarteve të përcaktuara. Sigurimi i menaxhimit të mbetjeve edhe për ato fshatra të cilat nuk e kanë konsideruar këtë më parë.

Skemat për mbulimin e kostos

Mbulimi i koston mund të arrihet duke:

- Ritur tarifën e pastrimit për banorët si dhe për bizneset dhe institucionet. Tarifa e tanishme, sidomos ajo për familjet, është shumë e ulët dhe nuk mundëson mbulimin e koston.

- Rritur bazën e subjekteve që përfshihen në skemë. Nga analiza e mësipërme del se mbledhja e taksës nga qytetarët është në nivele të ulëta. Përsa i përket bizneseve, numri i tyre është i vogël, kryesisht për shkak të informalitetit. Rritja e numrit të bizneseve që paguajnë tarifën e pastrimit është e rëndësishme sepse ata janë njëkohësisht ndër ndotësit më të mëdhenj.
- Përdorur me efikasitet grantin.

Interesi për skemën e përbashkët

Duke pasur parasysh se shërbimi i menaxhimit të mbetjeve realizohet nga bashkia Bajram Curri dhe shumë pak nga komunat, interesi për skemën e përbashkët është më shumë zhvillimor se sa ekonomik. Aplikimi i një skeme të përbashkët do të ishte shumë e rëndësishme për ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit. Duhet theksuar se për shumë Njësi të Qeverisjes Vendore në zonën funksionale Tropojë, ky shërbim publik nuk është konsideruar prioritet. Nga pikëpamja ekonomike, për shkak të buxhetit të kufizuar për menaxhimin e mbetjeve, Njësitë e vecanta të Qeverisjes Vendore nuk e kanë realizuar atë sic duhet. Mundësimi i një skeme sinergjike do të mundësonte realizimin e këtij shërbimi publik.

Mënyra e ofrimit të shërbimit

Megjithë konsiderata që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimit, shëmbulli i bashklisë Bajram Curri tregon se kosto e shërbimit është rritur me kalimin e shërbimit nga kompania private përsëri nën menaxhimin e bashklisë. Në këtë kontekst duket më efikase kontraktimi i këtij shërbimi tek kompani të specializuara bazuar në një proces kompetitiv dhe duke përcaktuar njëkohësisht standarte të qarta të pasqyruara në kontrata që mundësojnë monitorimin me rigorizitet të menaxhimit të mbetjeve nga njësi vendore.

4.2.4 Gjetjet kryesore lidhur me menaxhimin e mbetjeve

- Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane realizohet në kuptimin e mirëfilltë vetëm në Bashkinë Bajram Curri. Komunat Bujan, Margegaj, Tropojë, Llugaj dhe Fierzë e ofrojnë atë ose në mënyrë sporadike ose në mënyrë shumë të kufizuar. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet në masën 100% për popullsinë dhe familjet e bashklisë Bajram Curri, ndërsa në 4 komunat e tjera kjo përqindje varion nga 38%-64%. Komuna Margegaj ka mbulimin më të madh krahasuar me tre komunat e tjera. Në komunën Margegaj ky mbulim është rritur nga viti në vit për gjatë periudhës 2011-2013. Kjo shpjegohet edhe me rritjen e kërkesave lidhur me zhvillimin e turizmit malor në Luginën e Valbonës. Në komunat Lekbibaj dhe Bytyc nuk ofrohet ky shërbim në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.
- Megjithë përpjekjet e kohëve të fundit, rritja e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve nga zhvillimi i turizmit malor, sidomos në komunën Margegaj, nuk ka gjetur përgjigjen e duhur.
- Ka një bashkëpunim mbi baza informale midis bashklisë Bajram Curri dhe pesë komunave përreth saj-- Bujan, Margegaj, Tropojë, Llugaj dhe Fierzë--në menaxhimin e

mbetjeve që konsiston në përdorimin nga këto komuna të vend-depozitimit të mbetjeve të bashkisë Bajram Curri.

- Bashkia Bajram Curri ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportimit në vend-depozitim të të gjithë llojeve të mbetjeve--urbane, inerte, spitalore dhe industriale. Komunitet raportojnë vetëm për mbetje urbane. Shërbimi i pastrimit është ditë në bashkinë Bajram Curri dhe javor në komuna. Transporti bëhet me makina të zakonshme.
- Menaxhimi i mbetjeve kryhet nga NJQV-të.
- Megjithë investimet në infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve, ajo ngelet problematike. Në bashkinë Bajram Curri, grumbullimi i mbetjeve bëhet me krahë dhe transporti i tyre me makina të thjeshta sepse kamionët teknologjikë janë jashtë funksionit për arsye teknike. Njësitë e tjera të Qeverisjes Vendore kanë infrastrukturë të dobët—numër të vogël kontenerësh dhe mungesë kamionësh teknologjike. Në komuna, ka kontenerë vetëm në qendrat e komunës. Fshatrat e tjerë në përgjithësi nuk kanë kazanë dhe i hedhin mbeturinat nëpër përrënj, duke ndotur mjedisin dhe ujrat.
- Pastrimi i rrugeve/fshirja realizohet në mënyrë mekanike (me fshese).
- Bashkia Bajram Curri ka një vend-depozitim të autorizuar për mbetjet urbane dhe inerte në Kojë që është një gropë natyrale me sipërfaqe 1.5 ha dhe ndodhet 3.5 km larg qytetit të Bajram Currit. Ky vend-depozitim përdoret edhe nga komunitet Bujan, Margegaj, Llugaj dhe Fierzë. Me ndërhyrjet e nevojshme, ky vend depozitim mund të plotësojë nevojat e menaxhimit të mbetjeve sipas standardeve të pranuar. Komunitet e tjera përdorin vend-depozitime ilegale.
- Nuk ka një landfill për Zonën Funktionale Tropojë.
- Nuk ka riciklim të mbetjeve apo grumbullim të diferencuar të tyre. Mbjetet e rrezikshme spitalore nuk trajtohen. Bashkia Bajram Curri komposton rreth rreth 35% të mbetjeve të ngurta shtëpiake të prodhuara. Në fshatra bëhet kompostim individual, por nuk ka të dhëna lidhur me sasinë e mbetjeve të kompostuara.
- Të ardhurat e gjeneruara nga mbledhja e tarifës së pastrimit janë të ulëta për të mbuluar koston e shërbimit. Në Bashkinë Bajram Curri, të ardhurat përbëjnë rreth 38% të koston. Arsyet lidhen me tarifën e ulët të pastrimit (700 lekë/familje në vit, 1500 lekë/biznes, 2500 lekë/biznes të madh dhe 3000 lekë /institucion në vitin 2013) dhe shkallën e ulët të realizimit të pagesave (19% për familjarët, 53% për bizneset e vogla dhe 68% për bizneset e mëdha). Komunitet pothuaj nuk kanë asnjë të ardhur nga menaxhimi i mbetjeve. Përvetse tarifa është e ulët, edhe baza e tarifës mbi të cilën ajo aplikohet është shumë e vogël për arsye edhe të informalitetit të lartë në ekonomi.
- Nuk ka një plan të menaxhimit të mbetjeve për Njësitë individuale të Qeverisjes Vendore dhe as për zonën funksionale. Nuk ka politika dhe rregullore të brendshme për menaxhimin e mbetjeve.
- Nuk është bërë ndonjëherë matja e kënaqësisë së qytetarëve lidhur me cilësinë e shërbimit të ofruar.


4.2.5 Rekomandime lidhur me menaxhimin e mbetjeve

- Qeverisja vendore duhet të përqëndrohet në menxhimin e mbetjeve. Menaxhimi efektiv i mbetjeve është i rëndësishëm për jetesën e qytetarëve si dhe për zhvillimin e turizmit. Zhvillimi i një Plani të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për të gjithë zonën funksionale është shumë i rëndësishëm.
- Sigurimi i standarteve lidhur me menaxhimin e mbetjeve është i rëndësishëm.
- Të shihet mundësia e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.
- Është e rëndësishme që të krijohet infrastruktura e nevojshme për menaxhimin e mbetjeve (vendosja e kazanëve të plehrave dhe grumbullimi i mbetjeve me efektivitet dhe efikasitet, vendosja e koshave të vegjël në brendësi të lagjeve të qytetit, sigurimi i kamioneve teknologjike, rishikimi i tarifës së mbetjeve dhe mbledhja e saj për të siguruar mbulimin e kostos, përfshirë edhe fshatrat, përpunimi i mbetjeve, etj.). Autoritetet vendore duhet të llojnë për zgjidhjen e çështjes së vend-depozitimit të mbetjeve dhe përmirësimit të vend-depozitimit sipas standarteve të pranuar.
- Të rriten përpjekjet për ndërgjegjësimin e komunitetit për të kontribuar në mbrojtjen e ambientit.
- Duke pasur parasysh situatën e menaxhimit të mbetjeve dhe një përlllogaritje të përafërt të kostos së menaxhimit të mbetjeve, një skemë e mundshme e ofrimit të shërbimit konsiston në dy qasje: (1) Bashkia Bajram Curri dhe fshatrat e mëdhenj të komunave përreth saj të realizojnë një menaxhim të përbashkët të mbetjeve që konsiston: për bashkinë Bajram Curri, mbledhja ditore e mbetjeve dhe transportimi i tyre në vend-depozitimin e Kojës; për komunat Bujan, Margegaj, Tropojë dhe Llugaj, mbledhjen e tyre dy herë në javë dhe transportimin po në vend-depozitimin e Kojës; për komunat Fierzë, Bytyc dhe Lekbibaj, mbledhjen e tyre një herë në javë dhe transportimin po në vend-depozitimin e Kojës. Në këtë mënyrë, krijohet mundësia që të eliminohen vend-depozitimet ilegale të cilat ndosin ambientin dhe minojnë zhvillimin e turizmit. (2) Menaxhimin individual të mbetjeve për fshatrat e largët (që njëkohësisht janë me dendësi të ulët të popullsisë) të komunave duke mundësuar kompostimin e mbetjeve sipas standarteve të përcaktuara.
- Mbulimi i kostos mund të arrihet duke: Rritur tarifën e pastrimit për banorët si dhe për bizneset dhe institucionet. Tarifa e tanishme, sidomos ajo për familjet, është shumë e ulët dhe nuk mundëson mbulimin e kostos; Rritur bazën e subjekteve që përfshihen në skemë. Nga analiza e mësipërme del se mbledhja e taksës nga qytetarët është në nivele të ulëta. Përsa i përket bizneseve, numri i tyre është i vogël, kryesisht për shkak të informalitetit. Rritja e numrit të bizneseve që paguajnë tarifën e pastrimit është e rëndësishme sepse ata janë njëkohësisht ndër ndotësit më të mëdhenj.
- Duket më efikase kontraktimi i shërbimit të pastrimit tek kompani të specializuara private bazuar në një proces kompetitiv dhe duke përcaktuar njëkohësisht standarte të qarta të pasqyruara në kontrata që mundësojnë monitorimin me rigorizitet të menaxhimit të mbetjeve nga njësi vendore.

4.3. Rrugët dhe transporti publik

Infrastruktura rrugore në rrethin Tropojë përgjithësisht është e mirë. Qyteti i Bajram Currit është i lidhur me rrugë automobilistike me qendrat e komunave si dhe shume nga fshtrat e rrethit të Tropojës si Markaj, Gegëhysen, Lekbibaj, Shipshan, Pac, Zogaj, Valbone, Berishë, Kepenek. Bajram Curri është gjithashtu i lidhur me rrugë automobilistike me Krumën (Has). Harta 18 dhe Tabelat 27 dhe 28 japin një përmbledhje të fondit rrugor në Tropojë sipas llojit të rrugëve.

Harta 18: Harta e rrugëve në Tropojë



Legjenda: Kuqe-Rrugë nacionale; Kafe-Rrugë në administrim të qarkut
Blu-Rrugë që hiqen. Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës

Tabela 27: Fondi rrugor për rrugët nacionale dhe rajonale

| Rruga | km | Lloji rrugës |
|---------------------------------|------------|-----------------|
| Kam – Qafë Prushi | 19 | Rruge Rajonale |
| Sopot - Llugaj - Ura Bujan | 8 | Rruge Rajonale |
| Dushaj - Lekbibaj | 15 | Rruge Rajonale |
| Bajram Curri - Bujan | 6 | Rruge Rajonale |
| Tropojë Fshat - Rrugë Nacionale | 4 | Rruge Rajonale |
| Bajram Curri - Fierze | 17 | Rruge Nacionale |
| Bajram Curri - Valbone | 27 | Rruge Nacionale |
| Ura Bujanit - Qafe Morinë | 20 | Rruge Nacionale |
| Gjithsej | 116 | |

Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës

Tabela 28: Fondi i rrugëve komunale

| NJQV | Emertimi | Gjat_Km | Gjithsej km |
|--------|---|---------|-------------|
| Bujan | Qender Komune - Mani i kuq Selimaj | 9.5 | |
| | Asfalt Sh12 - Breg Geghy seni | 4 | |
| | Ura e tankeve - Kodra e Tplanit | 3.5 | |
| | Rudesh - Rosuje | 2 | |
| | Qender Komune - Markaj | 7 | |
| | Markaj - Qafe kolçi | 10.4 | |
| | Blini Markaj - Qyteze Ilire Rosuje | 3 | |
| | Shkolla Markaj - Lagje Milushaj | 0.9 | |
| | Shpia Shpend Zeqirit - Varreza Sheqerukaj | 1 | |
| | Blini Markaj - Koder Markaj | 1.2 | |
| | Shpia Isa Males - Shpia e Shkelzen Secit | 0.8 | |
| | Kodra e Dellinjes - Lagje Gjure | 1 | |
| | Imenaj - Berçan | 1.1 | |
| | Ulica Bunarit - Mulliri I Hasan Kamberit | 0.5 | |
| | Lekurtaj shkolla - Lagje Ismailgecaj | 0.8 | |
| | Ura e tankeve - Molle e kuqe | 1.1 | |
| | Ura e Bujanit - Lagje Vatoc | 1.9 | |
| | Sh12 Sekullai - Vidriç | 1.6 | |
| | Shpia Mic Sokolit - Mulosmanaj | 1.1 | |
| | Shkolla Bujan - Lagje BASHAJ | 1 | |
| | Sh12 Asfalt - Lagje Ranxa | 0.5 | |
| | Sh12 Asfalt - Lagje Rakiq | 2 | |
| | Shkolla e Grise - Lagje Shpati | 1.4 | |
| | Shkolla e Grise - Lagje Vine | 1.8 | |
| | Ura e Grise - Molle e kuqe | 0.9 | |
| | Lekurtaj shkolla - Lagje Shulla | 2 | |
| | Lekurtaj shkolla - Lagje Nikocaj | 1.8 | |
| | Lekurtaj Proi I madh - Lagje Kulla | 0.8 | |
| | Xhamia Selimaj - Lagje Lemenice | 3.3 | |
| | Mani I Kuq Selimaj - Lagje Kallbaj | 1 | |
| | Prroi I Halilajve - Lagje Gjonaj | 2.6 | |
| | Sh12 Asfalt - Lagje Halilaj | 1.2 | 72.7 |
| Bytyc | RN23 - Leniqi | 1.2 | |
| | RN23 - Zherke | 3 | |
| | RN23 Pac - Berishe | 16 | 20.2 |
| Fierze | Q.Fierze - Lagjja Pepkolej,Raje | 4 | |
| | Q.Fierze - Dushaj I Eper | 3 | |
| | Dushaj - Arvej-Xan | 3 | |
| | Kodra e Xanit - Dege | 14 | |
| | Ura Dizdare - Shk.9-Vjeçare Tpla | 6.2 | |
| | Shk.9-Vjeçare Tpla - Ballfushe | 2.2 | |
| | Moken - Cuke | 3 | |
| | Dushaj - Varreza Publike | 1 | |
| | Ura e Valbones - Ish Nyja e Betonit | 1 | |
| | Dege - Rushte | 3 | 40.4 |

| NJQV | Emertimi | Gjat Km | Gjithsej km |
|------------------|--------------------------------|-------------------|-------------|
| Lekbibaj | Qender Komune - Lugu Ndermajse | 15 | |
| | Koder-Markaj - Liqeni | 0.6 | |
| | Ura-Tetaj - Hec Lekbibaj | 2.5 | |
| | Hec Lekbibaj - Qafe Kollçit | 14 | |
| | Bushat - Gjonpepaj | 4 | |
| | Mserri - Salce | 8 | |
| | Kodra Zades - Vark | 2.6 | |
| | Seishta - Betoshe | 4.5 | |
| | Ulur - Tetaj | 2.3 | |
| | Kthesa Jahos - Shengjergj | 2.4 | |
| | Hec Lekbibaj - Curraj | 3 | |
| | Puseta - Shofra | 1 | 59.9 |
| | Llugaj | Bukov - Luzhe | 5 |
| Llugaj - Luzhe | | 3 | |
| Llugaj - Cernice | | 3 | |
| Cernice - Qender | | 1.5 | |
| Bukov - Tyrbja | | 1.2 | |
| Gjuric - Cernice | | 1 | |
| Llugaj - Sopot | | 4 | 18.7 |
| Margegaj | | B. Curri - Rragam | 45 |
| | Dragobi - Q. Strugi | 55 | |
| | Valbone - Kukaj | 4.5 | |
| | Qender - Pulanaj-Gelaj | 7 | |
| | B. Curri - Elezaj | 3 | |
| | Cernice - Byberaj | 3.5 | |
| | Rruga Valbones - Gra-Rudesh | 8 | |
| | Rruga Valbones - Motine | 2.8 | |
| | Ura Valbones - Ish Posta | 1 | |
| | Qender - Hetaj-Gjongecaj | 4 | 133.8 |
| Tropojë | Tropoje - Buçaj | 5.1 | |
| | Buçaj - Kuçane | 2.2 | |
| | Buçaj - Papaj | 1.6 | |
| | Papaj - Padesh | 7 | |
| | Boshnjak - Tafaj-Gegaj | 7.8 | |
| | Gegaj - Qaf-Morine | 7 | |
| | Tafaj - Trezhnjev | 2 | |
| | Kojel - Kuçane | 4 | |
| | Tropoje - Myhejan | 4 | |
| | Myhejan - Kovac | 1.8 | |
| | Kovac - Gosturan | 2.1 | |
| | Sopot - Begaj | 3.1 | |
| | Begaj - Fshat | 1.6 | |
| | Begaj - Babine | 1.9 | |
| | Sopot - Kermaj | 6.9 | |
| | Kermaj - Shkelzen | 3.8 | |
| | Ish rep ushatrak - Kuarc | 1.9 | |
| | Brenda Fshati - Kermaj | 2.1 | |
| | Kermaj - Kovac | 2.5 | |
| | Kamen - Kasaj | 1.6 | |
| | QafeMorine - Koldet | 3 | |
| | Fshati - Mejdani | 2.5 | 75.5 |
| | | | 421.2 |

4.3.1 Aksesit për në zonën funksionale Tropojë

Zona funksionale Tropojë lidhet me sistemin kombëtar të rrugëve nëpërmjet rrugëve kombëtare Bajram Curri – Qafë Morinë, Bajram Curri - Fierzë dhe Bajram Curri - Krumë.

- Rruga nacionale Bajram Curri – Qafë Morinë (rruga nacionale 22) lidh Tropojën me autostradën “Ibrahim Rugova” (Kosovë) dhe “Rrugën e Kombit” (Shqipëri). Nëpërmjet kësaj rruge, distanca nga bajram Curri në Tiranë është rreth 258 km. Komunikimi nëpërmjet kësaj rruge është më i lehtë nga pikëpamja e cilësisë së udhëtimit. Por, kalimi nëpër dy pika kufitare—Qafë Morinë (Tropoje) dhe Morinë (Kukes) rrit kohën e udhëtimit dhe, në rastin e transportit të mallrave, paraqet vështirësi lidhur me procedurat doganore.
- Rruga nacionale Bajram Curri – Fierzë (rruga nacionale 22) është pjesë përbërëse e rrugës nacionale Bajram Curri – Tiranë. Deri para pavarësisht të Kosovës, dhe sidomos pas ndërtimit të “Rrugës së Kombit” dhe autostradës “Ibrahim Rugova”, rruga nacionale Bajram Curri-Tiranë nëpërmjet Fierzës ka qenë rruga kryesore e komunikimit të Tropojës me Tiranën dhe aeroportin “Nënë Terreza” dhe portin e Durrësit. Fillimisht kjo rrugë kalonte nga Qafa e Malit për në Tiranë nëpërmjet Pukësë dhe Vaut të Dejës ku bashkohet me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë ose Rubikut, Fushë-Arrëzit, Rubikut dhe Milotit ku bashkohet me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë dhe është përkatësisht rreth 275 dhe 260 km e gjatë. Si rruga që kalon nga Puka edhe ajo që kalon nga Rubiku, në pjesën më të madhe (deri ku bashkohet me rrugën nacionale Tiranë – Shkodër) është rrugë malore, që lejon shpejtësi mesatare rreth 40 km/orë, me kosto relativisht të lartë për transportin e udhëtarëve, por sidomos të mallrave, dhe e vështirë në dimër kur ka borë. Pas ndërtimit të hidrocentralit të Fierzës, një alternativë e rrugës për Tiranë kombinonte transportin rrugor dhe ujor nëpërmjet Liqenit të Fierzës duke ndjekur itinerarin Fierze-Koman-Vau Dejës ku bashkohet me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë. Për arsye të koston së lartë të transportit, kjo rrugë sot përdoret në masë të vogël. Sidoqoftë, kjo rrugë është shumë panoramike dhe mund të jetë me shumë efektivitet në shërbim të zhvillimit të turizmit.
- Rruga nacionale Bajram Curri – Krumë (rruga nacionale 23) lidh Tropojën me Kukësin dhe nga aty me Tiranën. Gjatësia e kësaj rruge është rreth 75 km. Rruga është e shtruar me asfalt (vitin e kaluar ka përfunduar rikonstruksioni i rrugës Kukës – Krumë. Një alternativë për banorët e Bytyçit për tu lidhur me Kukësin dhe Kosovën është edhe nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Prushit. Kjo rrugë është malore që lejon shpejtësi të vogël (30-40 km/orë) dhe e vështirë në dimër kur ka borë. Kjo rrugë përdoret kryesisht nga banorët e komunës Bytyç që kufizohen me Hasin.

4.3.2 Transporti brenda Tropojës

Siç është përmendur në seksionin mbi tipologjinë e Zonës Funktionale Tropojë, ZFT mund të konsiderohet zonë funksionale sipas modelit koncentrik. Në qendër të zonës është Bashkia Bajram Curri që është tregu kryesor, qendra më e rëndësishme administrative dhe vendi ku

ofrohen shumica e shërbimeve. Të gjithë komunat konvergojnë në Bajram Curri. Intensiteti i ndërveprimit është më i lartë midis qendres—Bajram Currit—dhe fshatrave të NJQV-ve më afër saj që njëkohësisht janë edhe fshatrat më të mëdhenj. Tabela 29 paraqet lidhjen e fshatrave të ndryshëm me rrugën nacionale.

Tabela 29: Aksesi në rrugën nacionale

| NJQV | Rruga | | Length (km) | | |
|---------------|---------------|-------------|-------------|----------|-------------|
| | Fillimi | Mbarimi | rajonale | komunale | asfalt (km) |
| LEKBIBAJ | FIERZE | LEKBIBAJ | 29 | | |
| LEKBIBAJ | FIERZE | SALCA | | 5.5 | |
| FIERZE | RN22/FIERZA | DEGA | 5 | 12 | |
| FIERZE | RN22 | DUSHAJ | | 2 | |
| BUJAN | BUJAN | SELIMAJ | 4.5 | | |
| BUJAN | B.CURRI | MARKAJ | 4 | | |
| BUJAN | B.CURRI | BRECAN | 3 | | |
| BUJAN | RN22BUJAN | BLLATE | 4 | | |
| BUJAN | RN22 | GRI | 4 | | |
| BUJAN | BUJAN | Q.KOLCI | 4 | 24 | |
| LLUGAJ | RN22/U.BUJAN | JAH SALIH | 6 | | |
| LLUGAJ | RN22 LLUGAJ | TPLANI | 13 | | |
| LLUGAJ | RN22 | LUZHE | 4 | | |
| MARGEGAJ | B.CURRI | RrAGAM | 29 | 3 | |
| MARGEGAJ | RN22 | SHOSHANI | | 1.5 | |
| MARGEGAJ | RN22 | CEREMI | | 12 | |
| TROPOJE | RN12/SOPOT | KERNAJE | 12 | | |
| TROPOJE | RN22 | MYHEJANI | | 3.3 | |
| TROPOJE | RN22 | BEGAJ | | 2 | |
| TROPOJE | RN22/BABINA | SHUMICE | | 2 | |
| TROPOJE | RN22 | VICIDOLI | | 2 | |
| TROPOJE | RN22 | BUCAJ | 10 | | |
| TROPOJE | RN22/U.KAMENE | LUGU I ZI | | 4 | |
| TROPOJE | QAF MEJDAN | TROPOJE | | 3 | |
| BYTYC | RN23/KAMI | QAFE PRUSHI | 20 | | |
| BYTYC | RN23 | LENIQI | | 1.2 | |
| BYTYC | RN23 | ZHERKE | | 3 | |
| BYTYC | RN23 PAC | BERISHE | 13 | 3 | |
| Gjatësia (km) | | | 164.5 | 83.5 | |

- Aksesi në rrugët nacionale. Qendrat e komunave lidhen me rrugën nacionale Bajram Curri – Qafë Morinë.
- Aksesi në rrugët rajonale. Shumica e fshatrave kanë akses në rrugët rajonale dhe prej këtu në rrugët nacionale.
- Aksesi në rrugët komunale lokale. Në përgjithësi, fshatrat brenda territorit të NJQV-ve dhe lagjet brenda fshatrave janë të lidhura me njera tjetrën. Këto rrugë janë pjesërisht të asfaltuara dhe një pjesë e tyre të pa-asfaltuara.

Gjendja e rrugëve rajonale është në përgjithësi e mirë. Ato janë të shtruara me asfalt. Gjendja e rrugëve komunale është disi e mirë. Pjesa më e madhe janë të shtruara me zhavor, por të kalueshme. Të pa-aksesueshme ose të aksesueshme me vështirësi janë rrugët që lidhin fshatrat Tplan, Degë dhe Bredashnicë. Rrugëtimi paraqet vështirësi në dimës, sidomos në rrugët që lidhin fshatrat malorë, të largët nga qendra e zonës funksionale.

4.3.3 Investimet në sistemin e rrugëve

Në shumë NJQV janë bërë ndërhyrje për asfaltimin e rrugëve kryesisht nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Brendshme (ku pushteti vendor ka marrë pjesë) dhe donatorë të huaj. Në zonën e Tropojës janë gjithsej 538 km rrugë nga të cilat 164 km janë rrugë të asfaltuara. Problemi mbetet mirëmbajtja pasi NJQV-të që janë përgjegjëse për këtë shërbim kanë buxhete të kufizuara për këtë qëllim.

4.3.4 Transporti publik

Në Rrethin e Tropojës, transporti publik përdoret për lëvizjet brenda zonës funksionale dhe jashtë saj. Linjat kryesore nacionale përfshijnë: Tiranë, Durrës, Gjakovë, Krumë dhe Kukës. Ka transport të licensuar publik nga Bajram Curri për Tiranë si dhe për në qendrat e komunave (Fierzë, Tropojë, Llugaj, dhe Bujan) dhe Gjakovë. Njëkohësisht ka shërbim të licensuar transporti që lidh Bajram Curri me të gjithë qendrat e komunave si dhe me disa nga fshatrat kryesore.

Rruga nacionale Bajram Curri-Qafë Morinë, e cila nëpërmjet Kosovës kalon në Kukës, përgjithësisht lidh Tropojën me Tiranën por edhe me Prishtinën dhe qytetet e tjera në Kosovë.

Transporti publik për në Tiranë realizohet në përgjithësi me furgonë 17-20 vendësh nëpërmjet itinerarit Bajram Curri - Qafë Morinë – Gjakovë – Morinë – Kukës - Tiranë. Frekuenca ditore e furgonëve është rreth 30 (vajtje-ardhje). Ata nisen në intervalin 06.00-14.00. Njëkohësisht ka furgona që kanë destinacion Durrësin.

Transporti publik nga qendrat e komunave realizohet mesatarisht 6-8 herë në ditë. Përsa i përket qëndrës së komunës Lekbibaj, ky transport realizohet zakonisht 3 herë në ditë. Gjithashtu ka linja furgonësh edhe për fshatrat e mëdhenj të zonës funksionale për në Tropojë. Transporti publik nga qendrat e komunave për në Bajram Curri realizohet në përgjithësi me furgonë 8 vendësh.


Tani qyteti i Bajram Currit lidhet me qytetin e Gjakovës, 37 km largësi, nëpërmjet një rruge automobilistike të asfaltuar e cila kalon nga Bajram Curri–Tropoj e Vjetër–Qafë Morinë–Gjakovë. Nga Bajram Curri për në Gjakovë dhe anasjelltas udhëtojnë mesatarisht çdo ditë rreth 5-6 furgonë. Gjithashtu, rreth 15 furgonë udhëtojnë çdo ditë për transportimin e mallrave.

Deri para pavarësisë së Kosovës dhe sidomos ndërtimit të “Rrugës së Kombit” dhe autostradës “Ibrahim Rugova”, rruga nacionale Bajram Curri-Tiranë kalonte nëpërmjet Fierzës. Fillimisht kjo rrugë kalonte nga Qafa e Malit për në Tiranë dhe është rreth 260 km e gjatë. Pas ndërtimit të hidrocentralit të Fierzës, rruga për Tiranë kombinonte transportin rrugor dhe ujqor nëpërmjet Liqenit të Fierzës. Për arsye të kostos së lartë të transportit, kjo rrugë sot përdoret në masë të vogël dhe transporti i udhëtarëve realizhet kryesisht nëpërmjet Gjakovës dhe Kukësit.

Përdorimi i transportit publik nga qytetarët për të shkuar në punë arrin nivelin më të lartë në komunën e Fierzës me 25 % ndërkohë që në qendrën funksionale, Bajram Curri është 6.9 %. Infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkisë dhe komunave bën që aksesin ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Harta 19 paraqet intensitetin e përdorimit të rrugëve për transport publik.

Përdorimi i makinave për qëllime transporti është rritur me 37% krahasuar me 2006. Sipas censusit të 2011, ka 36 makina/1000 banorë. Në vitin 2013, numri i automjeteve private u rrit në 306 krahasuar me 256 që ishte një vit më parë.

Harta 19: Intensiteti i përdorimit të rrugëve për transport publik



Legjenda: E kuqe e trashë-trafik i madh; E kuqe e hollë-trafik i vogël
Burimi: Intervista individuale dhe focus

Gjendja e mirë e rrugëve ka ndikuar në shkurtime të kohës që ju duhet banorëve të fshatrave për ardhur në Bajram Curri. Për të përshkruar rrugën nga komunat deri në Bajram Curri si qendër administrative duhet mesatarisht rreth 30 minuta. Sidoqoftë, ka fshatra që janë larg qendrës dhe ju duhet një kohë relativisht e gjatë për të ardhur në qendër. Për shembull, banorëve të komunës Lekbibaj ju duhet më shumë se 65 minuta për të shkuar në Bajram Curri.

Karakteri malor i zonës e bën të vështirë transportin rrugor, sidomos për zonat e largëta nga qendra dhe në dimër. Megjithë përmirësimin në infrastrukurën rrugore, rrjeti rrugor nuk ndodhet në gjendje të kënaqshme.

4.3.5 Menaxhimi dhe financimi i rrugëve/transportit

Rrugët nacionale (64 km) dhe rajonale (52 km) janë në inventarin dhe në përgjegjësinë e Ndërmarrjes Rajonale të Rrugëve (Këshilli i Qarkut Kukës) e cila është përgjegjëse për investimet, mirëmbajtjen, pastrimin nga dherat dhe bora, etj. Për dy akset rrugore nacionale dhe akset rajonale në zonën e Tropojës është kontraktuar një kompani për mirëmbajtjen.

Mirëmbajtja e vazhdueshme siguron që rrugët janë të hapura dhe të kalueshme. Mirëmbajtja periodike konsiston në riveshje të shtresave, riparime në vepra arti, pastrim kanalesh, mbushje, etj.

Rrugët komunale janë në varësi të pushtetit lokal të cilat përgjigjen për mirëmbajtjen e tyre. Për këtë qëllim ato zakonisht përdorin një buxhet të caktuar për mirëmbajtjen dhe fondet për emergjencat (sidomos gjatë dimrit). Këto zëra janë në pjesën e investimeve në buxhetin e NJQV. Kosto mesatare e mirëmbajtjes së rrugëve është rreth 20,000 lekë/km.

4.3.6 Gjetjet kryesore lidhur me rrugët dhe transportin publik

- Zona e Tropojës ka një akses relativisht të vështirë në infrastrukurën rrugore të vendit. Aksesin nëpërmjet rrugëve tradicionale që kalojnë nga Fierza paraqet vështirësi që lidhen me terrenin malor (rruga nëpërmjet Qafë Malit), koston (rruga nëpërmjet Liqenit të Fierzës), dhe kalueshmërisë gjatë dimrit. Rruga që kalon nëpërmjet Gjakovës paraqet vështirësi kryesisht për transportin e mallrave që kalojnë dy herë kufirin. Rruga që kalon nëpërmjet Krumës është malore dhe problematike në dimër.
- Pjesa qëndrore e ZFT (Bajram Curri dhe fshatrat e komunave përreth) komunikon me një rrjet rrugor të asfaltuar dhe relativisht në gjendje të mirë. Ky rrjet i shërben edhe qëllimeve të zhvillimit ekonomik përfshirë prodhimin dhe tregëtimin e mallrave bujqësore dhe blektorale dhe zhvillimin e turizmit malor.
- Rrugët komunale nuk janë në nivelin e duhur, sidomos rrugët që lidhin Tplan, Degë dhe Bredashnicë. Rrugët që lidhin zonën e qendrës me zonat potenciale turistike si Ceremi, Curraj Epërm, Liqeni i Ponarëve, Vargmali i Bjeshkëve në përgjithësi janë në gjendje të keqe (ose mungojnë).

- Kapaciteti teknik dhe financiar për mirëmbajtje dhe investim në sistemin e rrugëve komunale është i dobët dhe i pa-përballueshëm nga buxhetet e Njësitë të Qeverisjes Vendore.
- Transporti publik në zonën e Tropojës bëhet vetëm me furgonë. Ky sistem është i rregulluar dhe licensuar nga NJQV-të (kryesisht bashkia Bajram Curri). Kushtet e transportit publik janë të pranueshme.

4.3.7 Rekomandime lidhur me rrugët dhe transportin publik

- Avokimi dhe lobimi për lehtësimin e levizjes së lire, sidomos të mallrave, në kufirin midis Shqipërisë dhe Kosovës do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e transportit dhe për pasojë zhvillimin ekonomik të Zonës Funksionale Tropojë.
- Është e nevojshme të përmirësohet infrastruktura rrugore që lidh fshtrat e largët me qendrën e ZFT. Kjo do të ndikonte si në lehtësimin e daljes në treg të këtyre fshtrave, zhvillimin ekonomik të tyre, rritjen e të ardhurave të fermerëve dhe mbajtjen e popullimit të këtyre zonave.
- Është e nevojshme të përmirësohet infrastruktura rrugore në zonat potenciale turistike si Ceremi, Curraj Epërm, Liqeni i Ponarëve, Vargmali i Bjeshkëve si kusht për zhvillimin e turizmit malor.
- Sigurimi i standarteve lidhur me transportin publik është i rëndësishëm.

Rekomandim i përgjithshëm

Burimi i të dhënave përfshin Këshillin e Qarkut Kukës dhe Njësitë Vendore. Në përgjithësi ka një mospërputhje midis të dhënave të siguruar nga burime të ndryshme. Sidoqoftë, trendi ruhet. Të dhënat lidhur me shërbimet publike ose janë të paplota ose mungojnë. Është e nevojshme që qeverisja lokale të sigurojë gjenerimin dhe konsolidimin/rakordimin e të dhënave.

5. ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE TË QEVERISJES LOKALE NË ZONËN FUNKSIONALE TROPOJË

5.1 Shërbimet kryesore që ofrohen nga NJQV-të dhe shpërndarja e tyre

Bazuar në ligjin 8652 “mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Vendor në Shqipëri”, NJQV kryejnë në zonën tyre funksionet që lidhen me: 1) Infrastrukturën dhe shërbimet publike; 2) shërbimet me karakter social, sportiv dhe kulturor; 3) zhvillimet me karakter ekonomik vendor; dhe 4) mbrotja e sigurisë civile.

Në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike, NJQV janë përgjegjëse për: a) furnizimi me ujë të pijshëm; b) funksionimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara; c) ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike; ç) ndriçimi i mjediseve publike; d) funksionimi i transportit publik urban; dh) administrimi i varrezave dhe garantimi i shërbimit të varrimit; e) shërbimi i dekorit; ë) administrimi i parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike; f) grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave; g) planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Tabela 30 paraqet funksionet e realizuara nga NJQV-të e ZFT.

Tabela 30: Funksionet e realizuara nga NJQV-të e ZFT

| | Bajram Curri | Bujan | Bylyc | Fierze | Lekbthaj | Llugaj | Mareggaj | Tropojë |
|-----------------------------|--------------|-------|-------|--------|----------|--------|----------|---------|
| Uji pijshëm | x | x | x | x | x | x | x | x |
| KUZ | x | | | x | | | x | |
| Rruge+Sheshe | x | x | x | x | x | x | x | x |
| Ndricimi rrugor | x | | | | x | | | |
| Transporti Publik | x | | | | | | | |
| Mirëmbajtja e varrezave | x | x | x | x | x | x | x | x |
| Dekori | x | | | | | | | |
| Park-lulishte | x | | | | | | | |
| Menaxhimi i mbetjeve | x | x | | x | | x | x | x |
| Planifikimi Urban, strehimi | x | | | | | | | |

Vetëm bashkia Bajram Curri i mbulon të gjithë shërbimet publike. NJQV-të në zonat rurale nuk e mbulojnë një pjesë të madhe të shërbimeve.

Në kuadrin e shërbimeve me karakter social, kulturor e sportiv, përfshihen: a) Ruajtja dhe zhvillimi i vlerave kulturore dhe historike vendore, organizimi i veprimtarive dhe administrimi i institucioneve përkatëse; b) organizimi i veprimtarive sportive, çlodhëse e argëtuese dhe

administrimi i institucioneve përkatëse; c) shërbimi social dhe administrimi i institucioneve si çerdhet, azilet, shtëpitë e fëmijëve, etj. Vetëm bashkia Bajram Curri ka institucione dhe personelin që ofron këto shërbime. Në Bajram Curri është Pallati i Kulturës dhe Muzeu “Bajram Curri” dhe Klubi i Sportit “Valbona” me ambientet sportive për futbollit dhe lojra me dorë.

Lidhur me shërbimet për zhvillimin ekonomik vendor, përfshihen: a) përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik vendor; b) ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë; c) zhvillimi i biznesit të vogël, si dhe zhvillimi i veprimtarive nxitëse si panaire e reklamanë vende publike; ç) organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme; d) shërbimi veterinar; dh) ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave e burimeve natyrore me karakter vendor. Tabela 31 paraqet realizimin e këtyre funksioneve nga NJQV-të e ZFT.

Tabela 31: Realizimi i funksioneve të zhvillimit ekonomik nga NJQV-të e ZFT

| | Bajram Curri | Bujan | Bytyc | Fierze | Lekhibaj | Lugaj | Margegaj | Tropojë |
|-----------------------------|--------------|-------|-------|--------|----------|-------|----------|---------|
| Plane dhe programe | x | x | x | x | x | x | x | x |
| Tregjet publike | x | | | | | | | |
| Panaire, reklama etj | x | | | | | | | |
| Shërbime mbështetese | x | | | | | | | |
| Shërbimi veterinar | x | x | x | x | x | x | x | x |
| Pyjet dhe kullotat komunale | x | x | x | x | x | x | x | x |

Sich shikohet nga tabela, hartimi i planeve dhe programeve të zhvillimit ekonomik vendor është funksion në çdo NJQV. Sidoqoftë, shpesh hartimi i planeve pranohet si funksion por nuk realizohet siç duhet. Nga ana tjetër, këto plane zakonisht janë pjesë e planeve strategjike të zhvillimit. Shërbimi veterinar dhe pyjet dhe kullotat komunale ju janë transferuar NJQV-ve të cilat kanë stafin përgjegjës për këto shërbime. Shërbimet e tjera si tregjet publike, veprimtaritë nxitëse si panaire e reklama, shërbimet në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor ofrohen vetëm nga bashkia Bajram Curri.

Funksionet lidhur me rendin dhe mbrojtjen civile përfshijnë: a) ruajtja e rendit publik për parandalimin e shkeljeve administrative dhe garantimi i zbatimit të akteve të komunës ose bashkisë; b) mbrojtja civile. Ky shërbim ofrohet nga policia bashkiake/komunale që janë struktura të ngritura pranë NJQV-ve. Bashkia bajram Curri ka një strukturë të organizuar për këtë qëllim me X staf. Në NJQV-të e tjera ky shërbim mungon.

Komunat e Zonës Funksionale Tropojë kanë të njëjtën gamë në dhënien e shërbimeve. Kështu në komuna struktura përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve është zyra e shërbimeve që ka të punësuar individë të cilët në përshkrimin e detyrave mbulojnë shërbime të ndryshme. Në

bashkinë Bajram Curri ka më shumë staf dhe një ndarje më specifike në departamente që janë përgjegjëse për shërbimet. Zyra e Shërbimeve është përgjegjëse kryesore për infrastrukturën dhe shërbimet publike. Skuadra të vecanta merren me pastrimin, gjelbërimin dhe dekorin.

Gjetjet kryesore dhe rekomandimet

Gjetjet kryesore:

- Shumë NJQV në zonat rurale nuk ofrojnë më shumë se 70% të shërbimeve që janë në ligjin e Pushtetit lokal. Komunitat pothuaj nuk ofrojnë shërbimet sociale, sportive, kulturore, etj. Gjithashtu edhe shërbimet që lidhen më zhvillimin ekonomik lokal pothuajse nuk ofrohen fare nga komunitat.

Rekomandime:

- Të bëhen studime dhe projekte për rivitalizimin e qendrës urbane, Bajram Currit, sidomos në perspektivën e zonës funksionale.
- Të bëhen studime dhe projekte për rivitalizimin e qendrave të tjera të zonës me tradita historike dhe kulturore si Bujan, Tropojë, etj. duke ruajtur karakteristikat e zonës.
- Të nxiset programe dhe projekte që nxisin zhvillimin e komunitetit në aspektin social-kulturor dhe ekonomik.

5.2 Organizimi vendor dhe struktura e personelit

NJQV paraqesin strukturën e organizimit të administratës në Këshillin Bashkiak apo të Komunës. Administratat janë të organizuara mbi bazë zyrash ose seksione, ku cdo zyrë ose seksion mund të ketë disa funksione, dhe personeli i përgjigjet detyrës funksionale të atij pozicioni. Në tabelat e mëposhtme është numri i punonjësve në NJQV-të e Tropojës si dhe organizimi i tyre.

Tabela 32: Numri i punonjësve në NJQV-të e Tropojës



| Njesia Vendore | Emertimi | Nr. i punonjesve |
|----------------|----------|------------------|
| Bashkia | B. Curri | 67 |
| Komuna | Tropoje | 19 |
| Komuna | Bytyc | 13 |
| Komuna | Lekbibaj | 16 |
| Komuna | Fierze | 16 |
| Komuna | Margegaj | 15 |
| Komuna | Bujan | 12 |
| Komuna | Llugaj | 12 |
| | | 170 |

Tabela 33: Organizimi i NJQV-ve të Tropojës

| | Bajram Curri | Bujan | Tropojë | Lugal | Margegaj | Fierzë | Lekbibaj | Bytyc |
|---|--------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Kabineti kryetarit | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Burimet Njerzore | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | | | |
| Kultura, arsim, komunikim. | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | | |
| Financa dhe buxheti | 3 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 1 |
| Programim zhvillim | 2 | | | | | | | |
| Urbanistika | 2 | | | | | | | |
| Shërbimet dhe mjedisi | 2 | 2 | 3 | 2 | 2 | 3 | 3 | 2 |
| Insp. Ndertimi | 1 | | | | | | | |
| Administrimi I pronave | 1 | | | | | | | |
| Të ardhurat lokale | 2 | | 2 | 1 | | | | |
| Shëndetsia/bujqësi dhe kontrolli ushqimit | 2 | 1 | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Ndihma ekonomike | 3 | 2 | 3 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Auditi I brendshem | 1 | | | | | | | |
| Policia vendore | 3 | | | 1 | | | | |
| Sektorët mbështetës dhe ndihmës | 4 | 1 | 2 | 1 | 2 | 2 | 3 | 2 |
| Shërbimet komunale,Pastrim gjelberim | 26 | | | | | | | |
| Cerdhe, konvikte | 6 | | | | | | | |
| Sporti | 1 | | | | | | | |
| Kultura | 1 | | | | | | | |
| Gjendja civile | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| QKR | 1 | | | | | | | |
| Totali | 67 | 12 | 19 | 12 | 15 | 16 | 16 | 13 |

Sic shikohet nga tabela janë gjithsej 170 punonjës që punojnë në administratën e tetë NJQV-ve në zonën e Tropojës. Për bazë janë marrë seksionet dhe drejtoritë në bashkinë Bajram Curri, e cila ka shume seksione pasi mbulon dhe shumë shërbime publike dhe ku janë të punësuar 67 punonjës ose rreth 40% e administratës lokale në nivel zone funksionale. NJQV në Tropojë kanë qenë të angazhuara dhe të hapura për të stimuluar dhe mbështetur zhvillimin e kapaciteteve njerëzore.

Më poshtë janë paraqitur organograma e bashkisë Bajram Curri dhe organograma tipike e komunave (në komuna të veçanta ka ndryshime, për shembull, komuna Margegaj ka ngritur edhe Sektorin e Turizmit.



Lart, Organograma e Bashkisë Bajram Curri Majtas, Organograma tipike e komunave

Zyrat dhe godinat e NJQV janë vendosur në qendrat e banuara. Në përgjithësi zyrat janë në kushte optimale për punën e administratës së NJQV

5.3 Buxhetet e Njësive Vendore

Buxhetet e NJQV-ve në përgjithësi vijnë nga të ardhurat që grumbullohen nga vetë NJQV-të, trasferta nga Ministria e Financave dhe fondi i investimeve që sigurohet për projekte të vecanta nga donatorët, programet dhe qeveria qendrore. Buxheti i bashkisë Bajram Curri në tre vitet e fundit paraqitet më poshtë.

Tabela 34: Buxheti i bashkisë Bajram Curri në tre vitet e fundit (2011-2013)

| Viti | Granti | Të ardhura | Gjithsej |
|------|------------|------------|------------|
| 2011 | 33,830,000 | 12,481,000 | 46,311,000 |
| 2012 | 35,490,000 | 22,542,000 | 58,032,000 |
| 2013 | 32,990,000 | 28,300,000 | 61,290,000 |

Sic shihet dhe nga tabela, buxheti është rritur nga viti në vit, kryesisht në sajë të rritjes së të ardhurave.

5.4 Strategjitë lokale të zhvillimit

Disa nga NJQV-të në zonën e Tropojës kanë kaluar nëpër procesin e hartimit të planeve lokale të zhvillimit. Bashkia Bajram Curri ka zhvilluar Planin Strategjik Tre-vjeçar (2012-2015). Komunitat Margegaj, Tropojë, Bujan kanë zhvilluar Strategjitë Afat-mesme të Zhvillimit (2009-2015). Zhvillimi i këtyre planeve është facilituar nga organizata të ndryshme të specializuara si Partnerët për Fëmijë (Bajram Curri) dhe Qendra për Zhvillimin e Integruar (margegaj dhe Tropojë).

B. PROGRAMI I ZONES FUNKSIONALE

6. VIZIONI I ZONËS FUNKSIONALE

Vizioni i ZF Tropojë (i jashtëm)

Tropoja, mikpritëse e vizitorëve vendas dhe të huaj të dashuruar pas turizmit malor.

Tropoja një atraksion turistik kryesor, në vend dhe në rajon, e zhvilluar në harmoni të plotë me burimet e shumta dhe tepër tërheqëse natyrore, lumenjtë, bjeshkët, florën dhe faunën e papërsëritshme, e bazuar në prodhimin bujqësor e blegtoral të zonës dhe në trashëgiminë e pasur historike dhe kulturore.

Tropoja një vend ku punohet dhe jetohe me cilësi.

Vizioni i ZF Tropojë (i brendshëm)

Zona Funktionale Tropojë, një zonë që:

- ✚ ofron shërbime cilësore dhe mundëson një zhvillim të qendrueshëm social ekonomik dhe cilësi jete për banorët e saj;
- ✚ krijon një mjedisi të përshtatshëm për fuqizimin ekonomik të qytetarëve të saj dhe kohezion social për komunitetin vendas;
- ✚ një angazhim qytetar dhe transparent, me përgjegjësi vendimmarrëse në zhvillimet aktuale të vendit;
- ✚ rikthen dëshirën e brezit të ri për të qendruar në vendin e tyre dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik e social të tij.

7. PROJEKT-IDETË KRYESORE PËR ZONËN FUNKSIONALE TROPOJE

7.1. Projekt-ide të zhvillimit ekonomik

| | |
|--------------------------------------|--|
| Titulli i projektit | <i>Ndertimi i tregut te produkteve bujqesore dhe blektorale ne qytetin e Bajram Currit</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bajram Curri, te gjitha NJQV-të e Zonës Funksionale do të përfitojnë</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>7,200,000 leke</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit.

Nje nga gjetjet kryesore të studimit mbi Zonën Funksionale Tropojë është se fermeret nuk janë të orientuar nga tregu dhe, në përgjithësi, prodhimi bujqësor dhe blegtoral përdoret për plotësimin e nevojave individuale të familjeve fermere. Një pjesë e vogël e prodhimeve bujqësore dhe blektorale tregëtohen në qytetin e Bajram Currit ose në funksion të turizmit në Luginën e Valbonës. Orientimi dhe mbështetja për fermerët për të dalë në treg apo për grumbullimin, përpunimin e marketimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale ka qenë e pamjaftueshme. Bajram Curri nuk ka një vend të përshtatshëm dhe sipas standarteve për tregëtimin e produkteve bujqësore dhe blektorale nga fermerët e fshatrave përreth. Mishi, qumështi, dhe produktet e tjera bujqësore dhe blektorale shiten drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë primitive nëpër rrugë. Vetëm një pjesë e vogël përpunohet në kushtet e shtëpisë, kryesisht për plotësimin e nevojave familjare dhe më pak për treg. Ka disa vende të përshtatshme për ndërtimin e tregut të produkteve bujqësore dhe blektorale. Një ndër këto vende mund të jetë Kojë në periferi të qytetit dhe me akses të lehtë për banorët e fshatrave përreth.

2. Objektivi/at specifike të projektit

Sigurimi i tregëtimit të produkteve bujqësore dhe blektorale sipas standarteve.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Furnizimi i tregut me produkte bujqësore dhe blektorale është rritur dhe përmirësuar.
2. Të ardhurat e familjeve fermere nga dalja në treg me produktet e tyre bujqësore dhe blektorale janë rritur.
3. Ambjenti në përgjithësi në qytetin e Bajram Currit është përmirësuar.

Nga ky projekt do të përfitonin të paktën rreth 200 fermerë të Zonës Funksionale Tropojë që do të tregëtonin produktet e tyre në kushte të përmirësuar dhe do të rrisnin të ardhurat e tyre.

Megjithëse tregu do të vendoset në qytetin e Bajram Currit, përfitues do të jenë të gjithë banorët dhe bizneset e zonës funksionale. Rreth 8000 banorë të qytetit Bajram Curri dhe rreth 6000 banorë të fshatrave të komunave përreth—Fierzë, Bujan, Llugaj, Tropojë, Margegaj, Bytyc, dhe Lekbibaj--do të përfitonin duke pasur mundësi të blejnë/shesin produkte bujqësore dhe blektorale në kushte të përmirësuara.

4. Aktivitetet e projektit

1. Përgatitja e projektit teknik.
2. Studimi i fizibilitetit dhe vendosja e tarifës për përdoruesit e tregut.
3. Sistemimi i sheshit 3,000 metër katror (gërmim, sistemim, kanalizim, asfaltim)
4. Vendosja e tryezave të tregëtimit që akomodojnë 200 fermerë.

Kohezgjatja e realizimit të projektit është rreth 6 muaj.

5. Pjekuria e projektit

Projekti është në fazën e projekt-idesë. Nuk ka ndonjë projekt teknik të zhvilluar apo studim fizibiliteti. Kosto është e përafërt, e vendosur bazuar në eksperiencat e ngjashme në NJQV-tw e tjera.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e financimit mund të jenë fondet publike (nga Bashkia Bajram Curri apo qeverisja qendrore) dhe donatorët potencialë.

Realizimi i punimeve do të bëhet nëpërmjet kontraktimit të kompanive të ndërtimit fituese të tenderit publik të zhvilluar nga Bashkia.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e përafërt e projektit është 7,200,000 lekë përfshirë:

1. Përgatitja e projektit teknik (700,000 lekë).
2. Studimi i fizibilitetit dhe vendosja e tarifës për përdoruesit e tregut (përfshirë në 1).
3. Sistemimi i sheshit 3,000 metër katror (gërmim, sistemim, kanalizim, asfaltim, furnizim me ujë, etj.) (4,500,000 lekë)
4. Vendosja e tryezave të tregëtimit që akomodojnë 200 fermerë (2,000,000 lekë).

| | |
|--------------------------------------|--|
| Titulli i projektit | <i>Venia në funksionim i kanalit vadites në fshatin Babinë të komunës Tropojë</i> |
| Tipi i projektit | <u>Zhvillim ekonomik</u> / Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt |
| Vendndodhja e projektit | <i>Fshati Babine dhe Sopot, komuna Tropoje</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>6,500,000 leke</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Sistemi ekzistues i ujitjes në bujqësi nuk mbulon nevojat e fermerëve për vaditjen e tokave bujqësore. Në vitin 2014, ujitet vetem 27% e sipërfaqes së mbjellë ose 42 % e sipërfaqes potenciale (në krahasim me një standart prej 70% të totalit të fondit tokës që duhet të ujitet). Komuna e Tropojës ka siperfaqën më të madhe të tokës bujqësore në zonën e Tropojës—rreth 1900 ha nga 7300 ha që ka e gjithë zona funksionale Tropojë. Nga kjo siperfaqe, vetëm rreth 500 ha ose 27% e sipërfaqes ujitet. Kjo ka ndikuar edhe në rendimentin e prodhimit si dhe lënien djerrë të tokave. Babina dhe Sopotit kanë sipërfaqen më të madhe në komunën e Tropojës dhe të zonës së Tropojës në përgjithësi. Venia në funksionim e kanalit ujitës Begaj-Babinë prej 5 km do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e prodhimit bujqësor në Babinë dhe Sopot dhe në komunën e Tropojës dhe zonën funksionale Tropojë në përgjithësi.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

Rritja e prodhimit bujqësor në komunën e Tropojës nëpërmjet rritjes së aftësisë ujitëse për tokën bujqësore në Babinë dhe Sopot.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Siperfaqja bujqësore e ujitur në Bobinë dhe komunën Tropojë është rritur ndjeshëm.
2. Të ardhurat e fermerëve të Babinës dhe komunës së Tropojës janë rritur.
3. Furnizimi me produkte bujqësore dhe blektorale për zonën funksionale Tropojë është përmirësuar.

Rreth 200 familje fermere me rreth 1000 banorë do të përfitojnë nga ky projekt. Fermerët e Babinës dhe Sopotit të komunës Tropojë do të përfitojnë direkt. Në komunën Tropojë që zë rreth 20% të territorit të zonës funksionale, jetojnë rreth 20% e popullsisë së zonës. Indirekt, do të përfitojnë banorët e qytetit Bajram Curri si dhe bizneset e përqëndruara në shërbime dhe turizëm në komunat e tjera sidomos atë të Margegajt.

4. Aktivitetet e projektit

1. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin e kanalit vaditës Begaj-Babine, 5 km i gjate.
2. Tenderimi i punimeve për ndërtimin e kanalit vaditës Begaj-Babinë.

3. Realizimi i punimeve për venien në funksionim të kanalit vaditës (gërmime, pastrime, betonime, ndërtimi i pusetave, etj.)
4. Takime ndërgjegjësuese me fermerët—shoqatën e përdoruesve të ujit për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të ujit për vaditje.

5. Pjekuria e projektit

Projekti është në fazën e projekt idesë. Nuk ka ndonjë studim fizibiliteti apo studim të detajuar/projekt teknik për këtë projekt. Kosto është një vlerësim paraprak i përafërt. Kanali ekziston por është i dëmtuar dhe jo funksional.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e financimit mund të jenë nëpërmjet fondeve publike (të qeverisjes vendore apo qendrore si Ministria e Bujqësisë) apo të donatorëve të huaj që mbështesin zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e projektit është 6,500,000 lekë përfshirë:

1. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin e kanalit vaditës Begaj-Babinë, 5 km i gjatë—500,000 lekë
2. Tenderimi i punimeve për ndërtimin e kanalit vaditës Begaj-Babinë—pa kosto.
3. Realizimi i punimeve për vënien në funksionim të kanalit vaditës (gërmime, pastrime, betonime, ndërtimi i pusetave, etj.)—6,000,000 lekë.
4. Takime ndërgjegjësuese me fermerët—shoqatën e përdoruesve të ujit--për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të ujit për vaditje—pa kosto

| | |
|--------------------------------------|--|
| Titulli i projektit | <i>Vënia në funksionim e kanalit vaditës rezervuari i Letajt-Mjekërbardh (Zogaj) i komunës Bytyç</i> |
| Tipi i projektit | <i><u>Zhvillim ekonomik</u>/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Fshati Zogaj, Prush, komuna Bytyç</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>8,000,000 leke</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Sistemi ekzistues i ujitjes në bujqësi nuk mbulon nevojat e fermerëve për vaditjen e tokave bujqësore. Në vitin 2014, ujitet vetëm 27% e sipërfaqes së mbjellë ose 42 % e sipërfaqes potenciale (në krahasim me një standart prej 70% të totalit të fondit tokës që duhet të ujitet). Komuna e Bytycit ka rreth 15 % të tokës bujqësore në zonën e Tropojës--980 ha nga 7300 ha që ka zona. Nga kjo sipërfaqe, vetëm 225 ha ose 22% e sipërfaqes ujitet. Kjo ka ndikuar edhe në rendimentin e prodhimit si dhe lënien djerrë të tokave. Zogaj dhe Prush janë nga fshatrat që kanë sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore në komunën e Bytycit. Vënia në funksionim e kanalit ujitës nga rezervuari i Letajt në Mjekërbardh (lagje e fshatit Zogaj) do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e prodhimit bujqësor në këtë fshat dhe në komunën e Bytycit në përgjithësi.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

Rritja e prodhimit bujqësor në komunën e Bytycit nëpërmjet rritjes së aftësisë ujitëse për tokën bujqësore në Zogaj dhe Prush.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Sipërfaqja bujqësore e ujitur në Zogaj dhe Prush dhe komunën Bytyç është rritur ndjeshëm.
2. Të ardhurat e fermerëve të Zogajt dhe komunës së Bytycit janë rritur.
3. Furnizimi me produkte bujqësore dhe blektorale për zonën funksionale Tropojë është përmirësuar.

Rreth 120 familje fermere me rreth 650 banore do te perfitojne nga ky projekt. Fermeret e komunes Bytyc do te perfitojne direkt nga ky projekt. Ne komunen Bytyc qe ze rreth 20% te territorit te zones funksionale, jetojne rreth 12% e popullsisë se zones.

4. Aktivitetet e projektit

1. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin e kanalit vaditës 7 km i gjatë.
2. Tenderimi i punimeve për ndërtimin e kanalit vaditës.
3. Realizimi i punimeve për venien në funksionim të kanalit vaditës (gërmime, pastrime, betonime, ndërtimi i pusëve, etj.)

4. Takime ndërgjegjësuese me fermerët—shoqatën e përdoruesve të ujit për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të ujit për vaditje.

Projekti realizohet për 6 nuajt.

5. Pjekuria e projektit

Projekti është në fazën e projekt idesë. Nuk ka ndonjë studim fizibiliteti apo studim të detajuar/projekt teknik për këtë projekt. Kosto është një vlerësim paraprak i përafërt. Kanali ekziston por është i dëmtuar dhe jo funksional.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e financimit mund të jenë nëpërmjet fondeve publike (të qeverisjes vendore apo qendrore si Ministria e Bujqësisë) apo të donatorëve të huaj që mbështesin zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e projektit është 8,000,000 lekë përfshirë:

1. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin e kanalit vaditës, 7 km i gjatë—800,000 lekë
2. Tenderimi i punimeve për ndërtimin e kanalit vaditës—pa kosto.
3. Realizimi i punimeve për vënien në funksionim të kanalit vaditës (gërmime, pastrime, betonime, ndërtimi i pusetave, etj.)—7,200,000 lekë.
4. Takime ndërgjegjësuese me fermerët—shoqatën e përdoruesve të ujit--për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të ujit për vaditje—pa kosto

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Ngritja e qendrës për përpunimin e frutave të stinës</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bajram Curri, të gjitha NJQV-të e Zonës Funktionale do të përfitojnë</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>10,000,000 leke</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Një nga gjetjet kryesore të studimit mbi Zonën Funktionale Tropojë është se fermerët nuk janë të orientuar nga tregu dhe, në përgjithësi, prodhimi bujqësor dhe blegtoral përdoret për plotësimin e nevojave individuale të familjeve fermere. Një pjesë e vogël e prodhimeve bujqesore dhe blektorale tregëtohen në qytetin e Bajram Currit ose në funksion të turizmit në Luginën e Valbonës. Orientimi dhe mbështetja për fermerët për të dalë në treg apo për grumbullimin, përpunimin e marketimin e prodhimeve bujqesore dhe blegtorale ka qenë e pamjaftueshme. Vetëm një pjesë e vogël përpunohet në kushtet e shtëpisë, kryesisht për plotësimin e nevojave familjare dhe më pak për treg. Një ndër rekomandimet e studimit është që duhet të mbështeten përpjekjet për grumbullimin, përpunimin e marketimin e prodhimeve bujqesore dhe blegtorale. Kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në sigurimin e standarteve të sigurisë dhe cilësisë dhe rritjen e të ardhurave nga shitja e produkteve.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

Rritja e të ardhurave nga prodhimet lokale nëpërmjet përpunimit dhe valorizimit të tyre.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Furnizimi i tregut, sidomos operatorëve turistike, me produkte lokale bujqësore dhe blektorale të përpunuara është rritur dhe përmirësuar.
2. Të ardhurat lokale janë rritur si pasojë e valorizimit nga përpunimi i frutave dhe produkteve bujqësore dhe të pyllit në përgjithësi.

Nga ky projekt do të përfitonin fermerët e zonës funksionale Tropojë që do të gjenin një treg të gatshëm për tregëtimin e produkteve të tyre dhe do të rrisnin të ardhurat e tyre. Megjithatë qendra do të vendoset në qytetin e Bajram Currit, përfitues do të jenë të gjithë fermerët dhe bizneset e zonës funksionale.

4. Aktivitetet e projektit

1. Studimi i fizibilitetit.
2. Përgatitja e projektit teknik.
3. Sigurimi i lejeve të nevojshme nga pushteti vendor dhe/ose qendror.

4. Ndërtimi i qendrës.
5. Promovimi i qendrës tek prodhuesit lokalë.

Kohëzgjatja e realizimit të projektit është rreth 12 muaj.

5. Pjekuria e projektit

Projekti është në fazën e projekt-idesë. Nuk ka ndonje projekt teknik të zhvilluar apo studim fizibiliteti. Kosto është e përafërt, e vendosur bazuar në projekte të ngjashme.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e financimit mund të jenë fondet nga qeverisja qendrore (në kuadrin e projekteve në mbështetje të zhvillimit të bujqësisë dhe agro-përpunimit) dhe kreditimi nga bankat. Bashkia do të mbështesë projektin tek financuesit potencial dhe do të pajisë ndërmarrësin me lejet e nevojshme.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e përafërt e projektit është 10,000,000 lekë.

| | |
|--------------------------------------|--|
| Titulli i projektit | <i>Ndërtimi i shtigjeve turistike në zonën e Tropojës</i> |
| Tipi i projektit | <u>Zhvillim ekonomik</u> / Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt |
| Vendndodhja e projektit | <i>Komunat Bujan, Tropojë, Lekbibaj</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | 3,700,000 lekë |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Analiza e zhvillimit ekonomik të zonës funksionale Tropojë ka evidentuar potencialin e madh turistik të zonës dhe se bukuritë dhe pasuritë natyrore e bëjnë Tropojën një destinacion të rëndësishëm të turizmit malor. Njëkohësisht ka nënvizuar se Lugina e Valbonës është një ndër atraksionet kryesore të Tropojës, por edhe të mbare Shqipërisë dhe rajonit. Por gjithashtu është theksuar se Tropoja ka shumë atraksione të tjera turistike të pashfrytëzuara që duhet të jenë në vëmendjen e vendim-marrësve lokalë dhe qëndrorë si Ceremi, Curraj Epërm, Liqeni i Ponarëve, Vargmali i Bjeshkëve, etj. Është e rëndësishme që këto destinacione të promovohen dhe të zhvillohet infrastruktura (rrugore, turistike, etj.) për në këto destinacione. Në këtë projekt propozohet ndërtimi i shtigjeve turistike nga Bujani drejt Majës së Hekurave dhe Currajt e Epërm, nga Lekbibaj drejt Currajt të Epërm, dhe nga Tropoja drejt Ceremit. Aktualisht, shtigjet turistike nuk kanë infrastrukturën e nevojshme turistike (shenjat orientuese, tabelat informuese, ndërhyrje për sigurinë e vizitorëve, etj.).

2. Objektivi/at specifikë të projektit

1. Përmirësimi i infrastrukturës turistike në zonën e Tropojës.
2. Shtimi i atraksioneve turistike të vizitueshme në zonën e Tropojës.
3. Rritja e numrit të vizitorëve dhe ditëve të qëndrimit të tyre në Tropojë.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Shtigje turistike me infrastrukture të përmirësuar dhe të promovuara për turistët potencialë.
2. Numri i turisteve që vizitojnë zonat e Bujanit, Tropojës dhe Lekbibaj rritet.
3. Numri i ditëve të qëndrimit të turisteve kur ata vizitojnë Tropojën rritet.
4. Zhvillimi i turizmit malor në komunat Bujan, Tropojë dhe Lekbibaj dhe për pasojë të ardhurat e familjeve lokale në këto komuna rriten.

Popullsia që përfiton direkt nga këto ndërhyrje është ajo e komunave Bujan, Tropojë dhe Lekbibaj që përbëjnë rreth 45% të sipërfaqes së zonës funksionale Tropojë dhe të popullsisë së saj. Indirekt përfitojnë banoret dhe bizneset e bashkisë së Bajram Currit.

4. Aktivitetet e projektit

1. Dizenjimi i shtigjeve turistike

- Bujan-Markaj-Cervena-Cukal-Maja e Hekurave
 - Bujan-Markaj-Velesht-Qafa e Kolshit-Qereq-Mulaj-Curraj i Eperm
 - Lekbibaj-Vrana-Qafa e Mrrise-Curraj i Eperm
 - Lekbibaj-Shengjergj-Btoshe-Qereq-Mulaj-Curraj i Eperm
 - Lekbibaj-Curraj i Poshtem-Curraj i Eperm (bregut te lumit te Lekbibaj)
 - Tropoje-Sulbice-Doberdol-Valbone-Cerem
2. Realizimi i punimeve për shtigjet turistike
- Vendosja e shenjave/tabelave orientuese (100 tabela orientuese)
 - Dizajnimi i hartave turistike per seicilin shteg (6 shtigje turistike)
 - Vendosja e tabelave informuese me hartat perkatese ne fillim te seicilit shteg (6 shtigje turistike).
 - Ndërtimi i zonave të soditjes (3 vende--në Majën e Hekurave, Cukal, Curraj i Epërm)
 - Ndertimi i urave të vogla dhe gardheve mbrojtëse në zona të rrezikshme për turistët (10 nderhyrje).
3. Ndërgjegjësimi i komunitetit për ruajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e turizmit malor.
- Kohëzgjatja e realizimit të ndërhyrjes është 8 muaj.

5. Pjekuria e projektit

Ky projekt është në fazën e projekt idesë. Nuk ka ndonjë projekt apo ndonjë ndërhyrje lidhur me vendosjen e infrastrukturës turistike në këto zona (drejt Curraj të Epërm, Qerem dhe Majës së Hekurave).

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Financuesit e mundshëm të projektit mund të jenë projektet e ndryshme të realizuara nga organizata vendase dhe të huaja (si për shembull ato ndërkufitare me Kosovën apo Malin e Zi) ose Bashkia Bajram Curri.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e projektit është 3,500,000 lekë përfshirë:

1. Dizajnimi i shtigjeve turistike (6 shtigje turistike, 300,000 leke)
2. Realizimi i punimeve per shtigjet turistike
 - Vendosja e shenjave/tabelave orientuese (100 tabela orientuese, 800,000 leke).
 - Dizajnimi i hartave turistike per seicilin shteg dhe printimi i tyre (6 shtigje turistike, 360,000 leke)
 - Vendosja e tabelave informuese me hartat perkatese ne fillim te seicilit shteg (6 shtigje turistike, 540,000).
 - Ndertimi i zonave te soditjes (3 vende--ne Majen e Hekurave, Cukal, Curraj i Eperm, 900,000 leke).
 - Ndertimi i urave te vogla dhe gardheve mbrojtese ne zona te rrezikshme per turistet (10 nderhyrje, 600,000 leke).
3. Ndergjegjesimi i komunitetit per ruajtjen dhe permiresimin e infrastruktures turistike dhe promovimin e turizmit malor (pergatitje dhe printim flete-palosje, 200,000 leke).

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në komunën e Bytycit.</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Kam, perfitues jane te banoret e komunes Bytyc si dhe ato te zones se Hasit.</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>900,000,000 leke</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Në analizën e zhvillimit ekonomik dhe të gjendjes së shërbimeve publike në zonën funksionale Tropojë, një nga gjetjet kryesore është se infrastruktura rrugore në disa pjesë të Tropojës sidomos në komunën Lekbibaj dhe Bytyc është e vështirë. Një alternativë për banorët e Bytycit, sidomos fshatrave Kam, Kepenek, Zogaj, Prush, për tu lidhur me Kukësin dhe Kosovën është edhe nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Prushit. Kjo rrugë është malore që lejon shpejtësi të vogël (30-40 km/orë) dhe e vështirë në dimër kur ka borë. Kjo rrugë përdoret kryesisht nga banorët e komunës Bytyc që kufizohen me Hasin. Gjendja e rruges që lidh Kamin me Qafë Prushin është e keqe. Gjatësia e kësaj rruge është 20 km.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

1. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për banorët e komunës së Bytycit.
2. Lehtësimi i lëvizjes së banorëve të komunës Bytyc drejt Kosovës dhe Hasit/Kukësit.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Infrastruktura rrugore e komunës Bytyc e përmirësuar.
2. Lëvizja e njerëzve dhe mallrave mes komunës Bytyc dhe Hasit dhe/ose Kosovës është lehtësuar.
3. Cilësia e jetesës e banorëve të Bytycit është përmirësuar

Nga ky projekt do të përfitonin rreth 1600 banorë të fshatrave Kam, Kepenek, Zogaj, dhe Prush që përbëjnë rreth 60% të popullsisë së komunës Bytyc. Komuna Bytyc përbën rreth 15% të sipërfaqes së zonës funksionale Tropojë dhe 8% të popullsisë.

4. Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore janë:

1. Zhvillimi i projektit teknik.
2. Tenderimi i punimeve.
3. Realizimi i punimeve.

5. Pjekuria e projektit

Projekti është në fazën e projekt-idesë. Nuk ka ndonjë projekt teknik të zhvilluar. Kosto është e përafërt, e vendosur bazuar në projektet e ngjashme në zonë.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e financimit mund të jenë fondet publike (nga Bashkia Bajram Curri apo qeverisja qendrore) dhe donatorët potencialë.

Në rastin e realizimit nga Bashkia, realizimi i punimeve do të bëhet nëpërmjet kontraktimit të kompanive të ndërtimit, fituese të tenderit publik të zhvilluar nga Bashkia.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e përafërt e projektit është 900,000,000 lekë për:

1. Zhvillimi i projektit teknik.
2. Tenderimi i punimeve.
3. Realizimi i punimeve.

| | |
|--------------------------------------|--|
| Titulli i projektit | <i>Informimi i shpejtë dhe efektiv i turistëve që duan të vizitojnë Tropojën.</i> |
| Tipi i projektit | <u>Zhvillim ekonomik</u> / Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bajram Curri, përfitues janë te gjitha njesite e tjera vendore ne Tropoje.</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>4,020,000 leke</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Në analizën e zhvillimit ekonomik dhe të gjendjes së shërbimeve publike në zonën funksionale Tropojë, një nga gjetjet kryesore është se megjithë përmirësimin e promovimit të Tropojës si destinacion turistik, akoma mbetet shumë për të bërë për të mundësuar përfitimin maksimal nga atraksionet turistike të zonës. Së pari, promovimi lidhet kryesisht me Luginën e Valbonës. Në Tropoje ka vetëm një zyrë të informacionit turistik të vendosur në Margegaj (Lugina e Vlabonës). Së dyti, shumë pak është bërë për promovimin e atraksioneve të tjera të rëndësishme turistike nga Njësitë e tjera Vendore, përfshirë edhe Bashkinë Bajram Curri. Në përgjithësi promovimi bëhet nga agjensitë turistike që organizojnë grupet e turistëve. Mangësi i identifikuar në vargun e atraksioneve është se zona prezanton në mënyrë të varfër trashëgiminë e saj natyrore dhe kulturore, drejt një tregu që e vlerëson shumë këtë element si motiv i rëndësishëm për të vizituar zonën. Turizmi nuk është i orientuar, por kryesisht i zhvilluar në baza të inisiativës dhe mendimit individual.

Ndër rekomandimet kryesore lidhur me zhvillimin e turizmit janë: (1) Zona ka arsye të forta për t'a vizituar të cilat duhet t'i përforcojë dhe promovojë. Këto arsye duhet t'u komunikohen qartë si turistëve të huaj, ashtu edhe atyre vendas. Duhet të transmetojmë me efektivitet mesazhin se rajoni ofron një numër të atraksionesh të dukshme. (2) Në zhvillimin e atraksioneve të reja, mund të përmenden atraksionet e "forta" (si turizmi malor dhe qëndrimi i turistëve në shtëpitë pritëse në fshatra) dhe atraksionet e "buta" (që përdorin burimet ekzistuese që ndonëse kanë nevojë për pak investim, nuk kërkojnë shumë kapital përfshirë objektet historike, evenimentet tematike, kulturore dhe tradicionale, panairët e produkteve tipike të zonës, dhe kuzhina tradicionale për vizitorët e servirur në mënyrë tradicionale). (3) Të shihet mundësia e ngritjes së zyrave turistike edhe në vende të tjera dhe të përmirësohe informacioni turistik. (4) Eshtë e nevojshme që zhvillimi i turizmit të orientohet. Në këtë kontekst, është i rëndësishëm Zhvillimi i Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit për të gjithë zonën funksionale Tropojë.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

1. Informimi i turistëve nëpërmjet krijimit të zyrës turistike
2. Promovimi i resurseve dhe atraksioneve të zonës si dhe ndërgjegjësimi i komunitetit në mbrojtjen e tyre.
3. Rritja e mirëqenies së komunitetit nëpërmjet zhvillimit të turizmit malor
4. Rritja e kapacitete të stafit për menaxhimin e projekteve.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Shërbim i informimit të turistëve është ngritur dhe funksionon.
2. Resurset e komunës janë të evidentuara dhe të bëra publike
3. Rritja e mirëqenies së komunitetit është siguruar.
4. Kapacitetet teknike të stafit për menaxhimin e projekteve është ngritur.

Nga ky projekt do të përfitonin familjet pritëse dhe operatorët turistik në të gjithë zonën funksionale Tropojë. Megjithatë zyra do të vendoset në qytetin e Bajram Currit, përfitues do të jenë të gjithë banorët dhe bizneset e zonës funksionale. Rreth 8000 banorë të qytetit Bajram Curri do të jenë përfitues indirekt të projektit.

4. Aktivitetet e projektit

1. Zhvillimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Turizmit për Zonën Funktionale Tropojë dhe printimi i tij në 500 kopje.
2. Rritja e kapacitetit të stafit për menaxhimin e projekteve të turizmit.
3. Krijimi i zyrës së informacionit turistik (pajisja e saj)
4. Dizajnimi i hartave turistike për secilën Njësi Vendore të Zonës Funktionale Tropojë dhe printimi i tyre (8 njësi)
5. Vendosja e tabelave informuese për atraksionet turistike të njësisë dhe Tropojës në përgjithësi në secilën njësi vendore (8 njësi).
6. Dizajnimi dhe printimi i fletë-palosjeve me informacion turistik (10,000 copë).

5. Pjekuria e projektit

Projekti është në fazën e projekt-idesë. Nuk ka ndonjë projekt teknik të zhvilluar. Kosto është e përafërt, e vendosur bazuar në eksperiencat e ngjashme në NJQV-të e tjera.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e financimit mund të jenë fondet publike (nga Bashkia Bajram Curri apo qeverisja qendrore) dhe donatorët potencialë si dhe organizatat jo-fitimprurëse të vendit dhe të huaja të fokusuara në zhvillimin e turizmit.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e përafërt e projektit është 4,020,000 lekë përfshirë:

1. Zhvillimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Turizmit për Zonën Funktionale Tropojë dhe printimi i tij në 500 kopje. (2,000,000 leke).
2. Rritja e kapacitetit të stafit për menaxhimin e projekteve të turizmit. (përfshirë në 1).
3. Krijimi i zyrës së informacionit turistik (pajisja e saj) (600,000 leke)
4. Dizajnimi i hartave turistike për secilën Njësi Vendore të Zonës Funktionale Tropojë dhe printimi i tyre (8 njësi, 480,000 leke)
5. Vendosja e tabelave informuese për atraksionet turistike të njësisë dhe Tropojës në përgjithësi në secilën njësi vendore (8 njësi, 640,000 leke).
6. Dizajnimi dhe printimi i fletë-palosjeve me informacion turistik (10,000 copë, 300,000 lekë).

7.2. Projekt-ide për përmirësimin e shërbimeve publike

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Rikonstruksioni i lulishtes “28 Gushti”, Bajram Curri</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bashkia Bajram Curri</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>5,400,000 lekë</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Qyteti i Bajram Currit ka një popullsi prej 8250 (sipas gjendjes civile), të ndarë në tre lagje përkatësisht “28 gushti”, “Dardania” dhe “Partizani”. Lagjia “28 Gushti” ka rreth 1300 banorë, rreth 240 familje dhe ndodhet në qendër të qytetit, ku janë të vendosura institucionet kryesore shtetore si bashkia, nenprefektura, sigurimet shoqërore, Zyra e Punës dhe administrata e Këshillit të qarkut. Në këtë lagje, edhe pse e vogël, mungojnë kushtet minimale të hapsirave publike midis pallateve. Në një sipërfaqe prej 600 m², banorët nuk gëzojnë një mjedis sipas standarteve të pranuar për një jetë komunitare të kulturuar. Mungojnë hapsirat e gjelbërta, rrugët midis pallateve, trotualet dhe ndriçimi. Banorët e kësaj lagje dhe sidomos fëmijët dhe të moshuarit nuk kanë vende të përshtatshme për tu çlodhur dhe argëtuar. Për fëmijët mungojnë këndet e lojrave dhe hapsirat për të kaluar kohën e lirë dhe pa u rrezikuar. Nuk ka patur investime të mëparshme në këtë lagje. Projekti është një nevojë e komunitetit dhe si e tillë është në përputhje me studimin e ZF Tropojë përse i përket përmirësimin të kohezionit social të komunitetit.

2. Objektivat specifike të projektit

Objektivat specifike të projektit përfshijnë:

1. Përmirësimi kushteve të komunitetit për çlodhje dhe argëtim në lagjen “ 28 gushti”, qyteti Bajram Curri.
2. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e ambjenteve publike.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

Rezultatet e pritshme të projektit përfshijnë:

1. Sipërfaqeve të gjelbërta të shtuara në mjediset publike të lagjes “28 Gushti”;
2. Mjedise të përshtatshme për lëvizjen e banorëve dhe ndriçimin e lagjes “28 Gushti”;
3. Sipërfaqe çlodhëse të shtuara për banorët elagjes “ 28 Gushti”;
4. Komunitet i ndërgjegjësuar për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Numri i popullsisë përfituese: rreth 1300 banorë të qytetit Bajram Curri (ose rreth 20% e popullsisë së qytetit Bajram Curri); banorët e njësisve të tjera vendore që marrin shërbime të ndryshme.

Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore të projektit përfshijnë:

1. Sistemimi i terrenit në një sipërfaqe prej 400 m²;
2. Ndërtimi i trotuareve në hasirat midis pallateve të lagjes “ 28 Gushti”;
3. Ndriçimi i lagjes “ 28 Gushti”;
4. Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe vendosja e stolave;
5. Krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta;
6. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Afati i përfundimit të projektit--3 muaj.

4. Pjekuria e projektit

Propozimi është në fazën e një projekt ideje.

5. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Projekt propozimi përfshihet në funksionet e drejtpërdrejta të bashkisë Bajram Curri.

Financuesit e projektit përfshijnë: Bashkia, komuniteti, biznesi, donatorët vendas e të huaj.

6. Kostot e projektit

Kostua totale e projektit 5,400,000 lekë

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Shtimi i kapacitetit të depos së ujit të ujësjellësit të Bajram Currit</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ <u>Shërbime Publike</u>/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Quku i Dunishës, NJQV-të e Zonës Funktionale që do të përfitojnë: Bashkia Bajram Curri, komunat Bujan, Llugaj, Margegaj, Tropoje</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>80,000,000 leke</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve SH.A. furnizon me ujë rreth 70 % të popullsisë së Tropojës përfshirë qytetin e Bajram Currit si dhe fshatrat e komunave në afërsi të ujësjellësit si Margegaj, Shoshan, Kocane, Fushë Lume, Cernice dhe Sopot dhe po shtrihet edhe ne Dojan dhe Bujan. Tropoja ka burime ujore të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të popullsisë me ujë. Megjithatë, furnizimit me ujë të pijshëm ibanesave nuk është në nivelin e kënaqshëm. Cilësia e shërbimit është e pakënaqshme. Edhe në qytet, orët e furnizimit me ujë janë të pakta. Banorët e qytetit furnizohen me ujë 3 herë në ditë me nga 4 orë/ditë secila ndërsa banorët e fshatrave furnizohen 3 herë në ditë me nga 1 orë secilën herë. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë është e reduktuar duke bërë që cilësia e shërbimit për banorët të ulet. Gjate periudhes se veres, sasia e ujit me te cilën furnizohet qyteti dhe fshtrat ulet. Nje arsye eshte sasia e pamjaftueshme e ujit ne burim.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm i qytetarëve të zonës funksionale Tropojë.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Rrjet i përmirësuar për furnizimin me ujë të pijshëm në sasi dhe cilësi
2. Shtimi i kapacitetit prurës të ujësjellësit të fshatit Gjadër nëpërmjet ndërtimit të një burimi ujqor më parametra cilësorë.
3. Rritja e cilesise se jeteses se banoreve te zones funksionale

4. Aktivitetet e projektit

1. Përcaktimi i vendit të përshtatshëm për marrjen e ujit ne Valbone;
2. Pergatitja e projektit teknik;
3. Tenderimi i punimeve;
4. Shtrimi i tubave dhe lidhja e tyre me tubacionin kryesor—2 km;
5. Ndertimi i vepres se marrjes dhe depos se ujit;

Kohezgjatja e realizimit te projektit është rreth 12 muaj.

5. Pjekuria e projektit

Ky projekt është vazhdim i një projekti të mëparshëm të ujësjellësit të Bajram Currit. Ndryshimet në prurjet e ujit kanë bërë të nevojshëm shtimin e sasisë së ujit për ujësjellësin nga burime të tjera. Valbona është përcaktuar si vendmarrja më e përshtatshme. Ka një studim paraprak. Kosto është e përafërt e bazuar në këtë studim paraprak.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e mundshme të financimit: Ministria e Transportit dhe Infrastruktura dhe Bashkia Bajram Curri dhe donatorët potenciale të interesuar në zonën e Tropojës.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e projektit është rreth 80,000,000 leke përfshirë:

1. Përcaktimi i vendit të përshtatshëm për marrjen e ujit në Valbonë;
2. Përgatitja e projektit teknik; 3,000,000 leke
3. Tenderimi i punimeve;
4. Shtrimi i tubave dhe lidhja e tyre me tubacionin kryesor—2 km; 55,000,000 leke
5. Ndërtimi i vepres së marrjes dhe depos së ujit; 22,000,000 leke

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Vënia në efikasitet të plotë e ujësjellësit të Bajram Currit.</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bajram Curri, Margegaj, Shoshan, Kocane, Fushë Lume, Cernice, Sopot, Dojan dhe Bujan</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>20,000,000 leke</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem eshte nje nder sherbimet publike kryesore. Ne analizen e Zones Funktionale Tropoje, sherbimi i furnizimit me uje eshte identifikuar si nje problem kryesor dhe jane perfshire rekomandime te rëndësishme pershire: Përmirësimi i menaxhimit të furnizimit me ujë duhet të jetë prioritet i qeverisjes vendore; Eshtë e nevojshme të vendosen matësive dhe përcaktohet tarifa e ujit dhe plani për mbledhjen e saj; Kryerja e një studimi fizibiliteti për sistemin e ujit të pijshëm dhe KUZ për gjithë territorin e Tropojës dhe zhvillimi i një plani për menaxhimin e ujit dhe kanalizimeve.

Cilësia e shërbimit të furnizimit me ujë të konsumatorëve është e dobët. Konsumatorët nuk furnizohen në mënyrë të vazhdueshme (banorët e qytetit furnizohen me ujë 3 herë në ditë me nga 4 orë/ditë secila ndërsa banorët e fshatrave furnizohen 3 herë në ditë me nga 1 orë secilën herë) dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë është e reduktuar në vend që të rritet. Performancë në administrimin dhe menaxhimin e ujit të pijshëm është e dobët për shkak të mungesës së planeve për menaxhimin e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, nivelit të ulët të arkëtimeve, dhe kostos së lartë të shërbimit (kryesisht për shkak të efikasitetit të ulët, amortizimit të lartë, shpenzimeve të larta administrative, borxheve që i kanë ndërmarrjes së ujësjellësit klientët). Niveli i ulet i arketimeve lidhet si me mungesën e matësive dhe te një sistemi modern dhe të besueshëm faturimi dhe arkëtimi ashtu dhe me tarifën e ulet. Për konsumatorët familjarë, është përcaktuar një tarifë për shërbimin për çdo abonent prej 160 lekë/muaj për person (sipas çertifikatës së gjendjes familjare). Arsyeja është sepse matësit e ujit nuk funksionojnë dhe/ose ekzistojnë. Kjo tarifë mbledhet në rreth 35% dhe mbulon kostot në rreth 35-40%. Eshtë e nevojshme të vendosen matësat dhe përcaktohet tarifa e ujit dhe plani për mbledhjen e saj. Gjithashtu, është e nevojshme të rritet ndërgjegjesimi i komunitetit për përdorimin e ujit dhe pagesën e tarifave.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

Përmirësimi i furnizimit me ujë të banorëve të zonës funksionale nëpërmjet menaxhimit efektiv të ujësjellësit.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Infrastruktura e furnizimit me ujë të pijshëm për banorët e Bajram Currit dhe fshatrave përreth është funksionale.

2. Te ardhurat nga tarifat e shërbimit janë rritur duke kontribuar në mbulimin e kostos.
3. Qeverisja vendore ka një studim fizibiliteti për menaxhimin e furnizimit me ujë të pijshëm.
4. Komuniteti është ndërgjegjësuar lidhur me shërbimin publik të furnizimit me ujë dhe nevojën e përdorimit efikas të ujit të përdorimit efikas të ujit të pijshëm.

Nga kjo nderhyrje përfitojnë rreth 13,000 banorë të Bashkisë Bajram Curri dhe komunave Bujan, Margegaj, Tropoje dhe Llugaj (ose 45% e popullsisë që jeton në rreth 30% të territorit).

4. Aktivitetet e projektit

1. Riparimi i elementeve të infrastruktures (puseta, etj.) sipas parametra teknikë të kërkuar dhe për të bërë të mundur vendosjen e matesave.
2. Vendosja e 2000 sahatëve cilësore të matjes së konsumit të ujit për konsumatorët familjare, bizneset dhe institucionet.
3. Studimi i fizibilitetit, miratimi i paketës fiskale, dhe rishikimi i rregullores të funksionimit të shërbimit.
4. Aktivitete për ndërgjegjesimin e komunitetit për përdorimin efektiv të ujit dhe domosdoshmerinë e pagesës së tarifave të rishikuara (takimeve me publikun gjatë zbatimit të projektit, përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve sensibilizuese për komunitetin).

5. Pjekuria e projektit

Projekti është në fazën e projekt idese. Ka pasur një investim të rëndësishëm në ujesjellesin e Bajram Currit i cili është në përfundim të sipër. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë zhvillimit të studimit del se në këtë moment matesit të ujit ose nuk ekzistojnë ose nuk janë vendosur. Nga ana tjetër nuk ka më para të lidhura me investimin e lartpërmendur për blerjen/vendosjen e matesave.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e mundshme të financimit të këtij projekti janë Ministria e Transportit dhe Infrastruktures, bashkia Bajram Curri, dhe donatorët potenciale të huaj. Projekti do të realizohet nga Ndermarrja e Ujesjellesit (vendosja e matesave) në bashkëpunim me kompani të specializuara (studimi i fizibilitetit dhe rishikimi i rregullores së menaxhimit të shërbimit) dhe organizata të shoqërisë civile (për ndërgjegjesimin e komunitetit).

7. Kostot e projektit

Kosto totale e projektit-20,000,000 leke e ndare sipas aktiviteteve si vijon:

1. Riparimi i elementeve të infrastruktures (puseta, etj.) sipas parametra teknikë të kërkuar dhe për të bërë të mundur vendosjen e matesave. (4,800,000)
2. Vendosja e 2000 sahatëve cilësore të matjes së konsumit të ujit për konsumatorët familjare, bizneset dhe institucionet. (14,000,000 leke)
3. Studimi i fizibilitetit, miratimi i paketës fiskale, dhe rishikimi i rregullores të funksionimit të shërbimit. (1,000,000 leke)
4. Aktivitete për ndërgjegjesimin e komunitetit për përdorimin efektiv të ujit dhe domosdoshmerinë e pagesës së tarifave të rishikuara (takimeve me publikun gjatë zbatimit të projektit, përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve sensibilizuese për komunitetin). (200,000 leke)

| | |
|--------------------------------------|--|
| Titulli i projektit | <i>Përmirësimi i furnizimit me ujë për banorët e Llugajt, Luzhës dhe Rrogamit.</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Fshatrat e Llugajt, Luzhës dhe Rrogamit</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>100,000,000 lekë</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem eshte nje nder sherbimet publike kryesore. Ne analizen e Zones Funktionale Tropoje, sherbimi i furnizimit me uje eshte identifikuar si nje problem kryesor dhe jane perfshire rekomandime te rendesishme pershire: Përmirësimi i menaxhimit të furnizimit me ujë duhet të jetë prioritet i qeverisjes vendore; Shtrirja e shërbimit të furnizimit me ujë ne zonat qe nuk mbulohen nga ky sherbim. Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve SH.A. furnizon me ujë rreth 70 % të popullsisë së Tropojës përfshirë qytetin e Bajram Currit si dhe fshatrat e komunave në afërsi të ujësjetës si Margegaj, Shoshan, Kocane, Fushë Lume, Cernice dhe Sopot dhe po shtrihet edhe ne Dojan dhe Bujan. Fshatrat e komunes Llugaj (Llugal, Luzhe, Rrogam) megjithese kane mundesine te kene akses ne ujesjetesin e qytetit, nuk jane te perfshire ne skemen e furnizimit me uje.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

Permiresimi i furnizimit me uje ne fshatrat Llugaj, Luzhe, Rrogam dhe ne zonen funksionale Tropoje ne pergjithesi.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Infrastruktura e furnizimit me uje eshte permiresuar.
2. Furnizimi me uje i banireve te fshatrave Llugal, Luzhe dhe Rrogam eshte permiresuar ndjeshem;
3. Cilesia e jetes e banoreve te fshatrave Llugaj, Luzhe, Rrogam eshte rritur nepermjet aksesit tek uji i rrjedhshem.

Banoret e nje Njesie Vendore—Llugajt--dhe konkretisht banoret e fshatrave Llugaj, Luzhe, Rrogam (rreth 2000 banore ose rreth 70% e popullsisë se komunes Llugaj dhe 8% te popullsisë se pergjithshme te zones funksionale). Komuna Llugaj ze rreth 10% te territorit te zones funksionale.

4. Aktivitetet e projektit

1. Pergatitja e projektit teknik;
2. Tenderimi i punimeve;
3. Shtrimi i tubave dhe lidhja e tyre me tubacionin kryesor;
4. Vendosja e matesave te ujit;
5. Ndergjegjesimi i komunitetit per perdorimin efektiv te ujit dhe pagesen e tarifave te konsumit te ujit.

Kohezgjatja e realizimit te projektit eshte rreth 12 muaj.

5. Pjekuria e projektit

Kjo nderhyrje do te ishte pjese e nje projekti me te madh per shtrirjen e sherbimit ne te gjithë territorin e zones funksionale ku eshte fizibel. Ndërmarrja e Ujës-jellës Kanalizimeve SH.A. furnizon me ujë rreth 70 % të popullsisë së Tropojës përfshirë qytetin e Bajram Currit si dhe fshatrat e komunave në afërsi të ujës-jellës si Margegaj, Shoshan, Kocane, Fushë Lume, Cernice dhe Sopot dhe po shtrihet edhe ne Dojan dhe Bujan. Fshtrat e medhenj te komunes Llugaj—Llugaj, Luzhe dhe Rrogam—duhet te perfitojne nga ky sherbim gjithashtu.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e mundshme te financimit te ketij projekti jane Ministria e Transportit dhe Infrastruktures, bashkia Bajram Curri, dhe donatoret potenciale te huaj. Projekti do te realizohet nga Ndermarrja e Ujesjellesit (vendosja e matesave) ne bashkepunim me kompani te specializuara (shtrirja e tubave) bazuar ne procedura te tenderimit publik dhe organizata te shoqerise civile (per ndergjegjesimi i komunitetit).

7. Kostot e projektit

Vlera totale e projektit eshte rreth 100,000,000 leke perfshire:

1. Pergatitja e projektit teknik (3,000,000 leke);
2. Tenderimi i punimeve;
3. Shtrimi i tubave dhe lidhja e tyre me tubacionin kryesor (93,000,000 leke);
4. Vendosja e matesave te ujit (4,000,000 leke);
5. Ndergjegjesimi i komunitetit per perdorimin efektiv te ujit dhe pagesen e tarifave te konsumit te ujit.

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Menaxhimi efektiv i mbetjeve në Zonën Funktionale Tropojë</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bashkia Bajram Curri, komunat Bujan, Fierze, Llugaj, Margegaj, Tropoje</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>23,000,000 lekë</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Menaxhimi i mbetjeve urbane ne zonen funksionale Tropoje eshte identifikuar si nje problem kryesor ne studimin e realizuar per zhvillimin ekonomik dhe gjendjen e sherbimeve publike.

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane realizohet në kuptimin e mirëfilltë vetëm në Bashkinë Bajram Curri. Komunat Bujan, Margegaj, Tropojë, Llugaj dhe Fierzë e ofrojnë atë ose në mënyrë sporadike ose shumë të kufizuar. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet në masën 100% për popullsinë dhe familjet e bashkisë Bajram Curri, ndërsa në 4 komunat e tjera te permendura me siper kjo përqindje varion nga 38%-64%.

Ka një bashkëpunim mbi baza informale midis bashkisë Bajram Curri dhe pesë komunave përreth saj--Bujan, Margegaj, Tropojë, Llugaj dhe Fierzë--në menaxhimin e mbetjeve që konsiston në përdorimin nga këto komuna të vend-depozitimit të mbetjeve të bashkisë Bajram Curri. Vend-depozitimi i autorizuar për mbetjet urbane dhe inerte behet në Kojë që është një gropë natyrale me sipërfaqe 1.5 ha dhe ndodhet 3.5 km larg qytetit të Bajram Currit.

Shërbimi i pastrimit është ditor në bashkinë Bajram Curi dhe javor në komuna. Në bashkinë Bajram Curri, grumbullimi i mbetjeve bëhet me krahë dhe transporti i tyre me makina të thjeshta sepse kamionët teknologjikë janë jashtë funksionit për arsye teknike. Bujan, Margegaj, Tropojë, Llugaj dhe Fierzë kanë infrastrukturë të dobët—numër të vogël kontenierësh dhe mungesë kamionësh teknologjike. Në komuna, ka kontenierë vetëm në qendrat e komunës. Fshatrat e tjerë në përgjithësi nuk kanë konteniere dhe i hedhin mbeturinat nëpër përrenj, duke ndotur mjedisin dhe ujrat.

Të ardhurat e gjeneruara nga mbledhja e tarifës së pastrimit janë të ulëta për të mbuluar koston e shërbimit. Në Bashkinë Bajram Curri, të ardhurat përbëjnë rreth 38% të koston. Arsyet lidhen me tarifën e ulët të pastrimit (700 lekë/familje në vit, 1500 lekë/biznes, 2500 lekë/biznes të madh dhe 3000 lekë /institucion në vitin 2013) dhe shkallën e ulët të realizimit të pagesave (19% për familjarët, 53% për bizneset e vogla dhe 68% për bizneset e mëdha). Komunat pothuaj nuk kanë asnjë të ardhur nga menaxhimi i mbetjeve.

Megjithë përpjekjet e kohëve të fundit, rritja e kërkesavë për menaxhimin e mbetjeve nga zhvillimi i turizmit malor, sidomos në komunën Margegaj, nuk ka gjetur përgjigjen e duhur. Nuk ka një plan të menaxhimit të mbetjeve për Njësitë individuale të Qeverisjes Vendore dhe as për zonën funksionale. Nuk ka politika dhe rregullore të brendshme për menaxhimin e mbetjeve.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

1. Menaxhimi efektiv dhe efikas i mbetjeve urbane nëpërmjet bashkëpunimit ndërvendorë të 6 njësive vendore.
2. Ndërgjegjësimi i komunitetit të zonës për mbajtjen e një mjedisi të pastër.
3. Rritja e kapaciteteve të stafeve të 6 njësive vendore për menaxhimin e mbetjeve dhe zbatimin e projekteve.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Zona funksionale Tropoje ka nje plan per menaxhimin e intergur te mbetjeve per te gjithë zonen funksionale;
2. Nje skeme efektive dhe efikase per menaxhimin e mbetjeve eshte krijuar dhe funksionon;
3. Infarstruktura e grumbullimit te mbetjeve urbane eshte permiresuar.
4. Komuniteti eshte ndergjegjesuar per hedhjen e mbeturinave ne kosha dhe pikat e caktuara dhe pagesat e tarifes se pastrimit.

Numri i popullsise perfituese: 25,000 banore te 6 NJQV-ve (me shume se 90% e popullsise dhe 75% te territorit te ZFT) perfshire bashkine Bajram Curri dhe komunat Fierze, Llugaj, Bujan, Margegaj dhe Tropoje.

4. Aktivitetet e projektit

1. Hartimi i planit te menaxhimit te mbetjeve per te gjithë zonen funksionale Tropoje
2. Ngritja e kapaciteteve te bashkise per menaxhimin efektiv te mbetjeve
3. Ngritja e struktures institucionale dhe pergatitja e rregulloreve per nenaxhimin efektiv te mbetjeve.
4. Pergatitja e specifikimeve teknike, pergatitja e kriterëve te vecanta dhe specifike.
5. Investimi per permiresimin e infrastruktures se grumbullimit te mbetjeve (blerja e 2 makinave teknologjike per transportimin e mbetjeve, blerja e 300 kontenjerve per hedhjen e mbetjeve urbane, rrethimi dhe sistemimi i gropes se mbetjeve ne Koje, blerja e kompaktorit per gropen e mbetjeve).
6. Aktivitete per ndergjegjesimin e komunitetit.

Projekti do te realizohet brenda 12 muajve.

5. Pjekuria e projektit

Projekti eshte ne fazen e project idese. Ne kuadrin e ofrimit te ketij sherbimi, disa vjet me pare bashkia Bajram Curri ka blere kontenjere dhe dy makina teknologjike. Kontenjeret jane te pamjaftueshem dhe makinat teknologjike nuk jane funksionale (teknikisht).

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e mundshme të financimit të këtij projekti janë Ministria e Transportit dhe Infrastruktura, bashkia Bajram Curri, dhe donatorët potenciale të huaj. Projekti do të realizohet nga bashkia Bajram Curri në bashkëpunim me kompani të specializuara (plani I menaxhimit të mbetjeve dhe rregulloret e menaxhimit të shërbimit, rrethimi dhe sistemimi I gropës, vendosja e kazanëve) dhe organizata të shoqërisë civile (për ndërgjegjësimin e komunitetit).

7. Kostot e projektit

Kosto totale e projektit—23,000,000 leke

1. Hartimi i planit të menaxhimit të mbetjeve për të gjithë zonën funksionale Tropojë (3,000,000 leke)
2. Ngritja e kapaciteteve të bashkisë për menaxhimin efektiv të mbetjeve (përfshirë në 1).
3. Ngritja e struktura institucionale dhe përgatitja e rregulloret për menaxhimin efektiv të mbetjeve (përfshirë në 1).
4. Përgatitja e specifikimeve teknike, përgatitja e kriterëve të vecanta dhe specifike (përfshirë në 1).
5. Investimi për përmirësimin e infrastrukurës së grumbullimit të mbetjeve (blerja e 2 makinave teknologjike për transportimin e mbetjeve, blerja e 300 kontejnerëve për hedhjen e mbetjeve urbane, rrethimi dhe sistemimi i gropës së mbetjeve në Kojë, blerja e kompaktorit për gropën e mbetjeve). (20,000,000 leke)
6. Aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit.

Shënim: Ky projekt, në varesi të mundësive për financim, mund të realizohet si i tërë ose pjesë pjesë, dmth duke u copëtuar në dy-tre projekte më të vogla:

- Hartimi i planit të menaxhimit të mbetjeve për zonën funksionale Tropojë
- Sistemimi i gropës së depozitimit të mbetjeve urbane në Kojë
- Blerja e kamioneve teknologjike dhe kontejnerëve

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Zyra me një ndalesë-Bajram Curri</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ <u>Shërbime Publike</u>/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bajram Curri</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>6,200,000 leke</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Nje nder problemet kryesore te identifikuar nga forumi i zones funksionale Tropoje eshte informimi i qytetareve dhe komunikimi efektiv dhe i shpejte me ta lidhur me ceshtje te ndryshme qe ata kane me qeverisjen vendore. Informimi/komunikimi me qytetaret behet ne format tradicionale. Bashkia Bajram Curri nuk ka nje zyre me nje ndalese ku qytetaret te informohen shpejt dhe me cilesi per ceshtje te ndryshme ne interes te tyre.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

1. Përmirësimi i informimit në kohë dhe me cilësi i komunitetit lidhur me të drejtat e tyre dhe shërbimet e Komunës.
2. Ngritje e kapaciteteve për menaxhimin dhe administrimin sa më efektiv të komunikimit me publikut.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

1. Bashkia zotëron dhe vë në përdorim një sistem të organizuar, centralizuar dhe digjitalizuar për informimin në kohë dhe me cilësi të qytetarëve.
2. Kapacitet më i lartë i stafit në përdorim, administrim të të dhënave dhe ofrim të shërbimeve të kërkuara.
3. Rritja e ndërjegjësimit të komunitetit lidhur me çështjet e informimit, komunikimit dhe rrjedhimisht pjesëmarrjes/partneritetit dhe vendimarrjes në qeverisje.

Perfituesit do te jene 8,000 qytetaret e Bajram Currit si dhe, pas zgjedhjeve te reja per qeverisjen lokale, 28,000 banoret e zones funksionale Tropoje.

4. Aktivitetet e projektit

1. Dizajimi i Z1N, pergatitja e rregullores se funksionimit te saj.
2. Instalimi i pajisjeve teknike dhe sistemit.
3. Trajnimi i stafit mbi përdorimin dhe funksionimin e rrjetit.
4. Hedhja në rrjet e të dhënave e administrueshme nga bashkia.
5. Shkëmbim përvoja me NJQV te tjera qe e kane realizuar Z1N me pare.
6. Aktivitete nderjegjjesuese me komunitetin mbi promovimin e modelit të informacionit.

Projekti do te realizohet per 6 muaj.

5. Pjekuria e projektit

Projekti është në fazën e projekt-idese. Nuk ka ndonjë projekt teknik të zhvilluar. Kosto është e përafërt, e vendosur bazuar në eksperiencat e ngjashme në NJQV të tjera.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Burimet e financimit mund të jenë fondet publike (nga Bashkia Bajram Curri apo qeverisja qendrore) dhe donatorët potenciale si dhe organizatat jo-fitimprurese të vendit dhe të huaja të fokusuar në zhvillimin e turizmit.

Në rastin e realizimit nga Bashkia, realizimi i punimeve do të bëhet nëpërmjet kontraktimit të kompanive të ndërtimit fituese të tenderit publik të zhvilluar nga Bashkia.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e projektit është 6,200,000 leke përfshirë:

1. Dizajnimi i Z1N, përgatitja e rregullores së funksionimit të saj (1,500,000 leke)
2. Instalimi i pajisjeve teknike dhe sistemit (4,500,000 leke).
3. Trajnimi i stafit mbi përdorimin dhe funksionimin e rrjetit (përfshirë në 1).
4. Hedhja në rrjet e të dhënave të administrueshme nga bashkia.
5. Shkëmbim përvojë me NJQV të tjera që e kanë realizuar Z1N me pare (200,000 leke).
6. Aktivitete ndërgjegjësuese me komunitetin mbi promovimin e modelit të informacionit.

| | |
|--------------------------------------|--|
| Titulli i projektit | <i>Ndërtimi i murit rrethues dhe krijimi i mjediseve të përshatshme në shkollën e mesme dhe 9- vjeçare në qytetin e Bajram Currit.</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillimi ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bajram Curri</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>21,000,000 lekë</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Shkolla e mesme e qytetit Bajram Curri është shkolla me e madhe në ZF Tropojë. Në të ndjekin shkollën rreth 700 nxënës dhe punojnë 45 mësues. Pranë saj ndodhet shkolla 9-vjeçare “Ali Podrimja”, e cila është ndërtuar në vitin 2012 dhe çdo vit frekuentohet nga rreth 500 nxënës dhe 30 mësues. Të dyja shkollat, ndodhen në një territor të përbashkët, i cili nuk është i rrethuar me mur rrethues. Shkolla e mesme nuk siguron kushte të përshatshme për procesin mësimor dhe edukativ të nxënësve. Një nga problemet kryesore, përveç murit rrethues është çatia e dëmtuar, e cila pikon vazhdimisht gjatë periudhës së dimrit. Gjithashtu, oborri i shkollës nuk ka kushtet minimale të një mjedisi për edukimin e nxënësve. Këndet sportive janë jashtë funksionimit, nuk ka gjurmë të mjedisve të mëparshme sportive për shak të mosmirëmbajtjes së tyre. Shkollën 9-vjeçare, nuk ka ofruar qysh në fillim një mjedis të përshatshëm për pushimiet e nxënësve ndërmjet orëve mësimore dhe ato sportive. Shpesh, mjediset jashtë shkollës frekuentohen nga persona të tjerë, dhe është e pamundur mbajtja në kontroll e tyre. Për rrjedhojë ka patur raste të konflikteve ndërmjet të rinjve dhe personave jashtë shkollës, fenomene negative si përdorimi i cigares, drogës, etj. Shkolla e mesme mbledh nxënës edhe nga komunat Margegaj, Bujan e Tropoja fshat, Llugaj etj., pasi është në preferencën e tyre për të studjuar në qytet. Rrethimi i oborrit dhe krijimi i mjediseve të përbashkëta, të përshatshme, sportive dhe çlodhëse për nxënësit dhe mësuesit do të ulë rrezikun e ndërhyrjeve nga jashtë dhe do të krijojë një mjedis të kulturuar në shkollë. Projekti është në përputhje me studimin e ZF Tropojë përsa i përket përmirësimit të kohezionit social të komunitetit.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

Objektivat specifikë të projektit përfshijnë:

1. Krijimi i një mjedisi të përshatshëm për procesin mësimor, edukativ dhe sportiv për nxënësit e dy shkollave, respektivisht shkollës së mesme dhe shkollës 9-vjeçare “Ali Podrimja” në qytetin e Bajram Currit
2. Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe personelit mësimdhënës për mirëmbajtjen e mjediseve të krijuara dhe luftës kundër fenomeneve negative si konflikti, droga dhe trafikimi njerëzor.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

Rezultatet e pritshme të projektit, bazuar në objektivat e e mësipërme përfshijnë:

1. Mjedis fizik i sigurtë rrethues për të dy shkollat;

2. Çatia e shkollës së mesme e rikonstruktuar;
3. Infrastrukturë e përmirësuar e oborrit dhe këndit të shkollave;
4. Të rinj të sensibilizuar për mirëmbajtjen e mjedisit të krijuar.

Përfituesit e projektit përfshijnë 1200 nxënës të dy shkollave, 75 mësues dhe komuniteti në tërësi të 4 njësi vendore përfshirë qytein Bajram curri, Margegaj, Bujan Llugaj, Tropojë fshat, etj.

4. Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore për realizimin e objektivave dhe rezultateve të pritshme përfshijnë:

1. Ndërtimi i murit rrethues dhe sistemimi i mjedisit;
2. Riparimi i çatisë së ndërtesës së shkollës së mesme;
3. Ndërtimi i mjediseve sportive;
4. Fushatë ndërgjegjëse me nxënësit e shkollave të projektit për mirëmbajtjen e mjedisit dhe luftën kundër fenomoneve negative si konflikti/drogat/trafikimi njerëzor.

Periudha e realizimit të projektit është 6 muaj.

5. Pjekuria e projektit

Propozimi është në fazën e një projekt ideje.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Projekti përfshihet në funksionet e përbashkëta të bashkisë. Ai do të zbatohet nga bashkia Bajram Curri në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore.

Financuesit përfshijnë: bashkinë Bajram Curri, Drejtorinë Arsimore, komunitetin e nxënësve dhe mësuesve.

7. Kostot e projektit

Vlera e projektit do të jetë 21,000,000 lekë

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Rehabilitim i qendrës së komunës Bytyç, Tropojë</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Komuna Bytyç</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>9,800,000 lekë</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Komuna Bytyç ka një popullsi prej rreth 2200 banorë, sipas Zyrës së Gjendjes Civile. Qendra e kësaj komune, ndodhet në fshatin Pac, i cili ka një popullsi prej 400 banorë. Pranë kësaj qendre ndodhen disa institucione shtetore, private, dhe religjioze duke përfshirë administratën e njësisë vendore, qendrën shëndetsore, shkollën 9 vjeçare, xhaminë e fshatit dhe biznese të vogla private. Si e tillë, qendra e komunës Bytyç është e frekuentuar nga banorët e fshatit dhe fshatrave të tjerë që kërkojnë kryesisht shërbime publike si dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare. Qendra e komunës ofron një mjedis të papërshtatshëm për banorët e fshatit Pac dhe fshatrave të tjerë. Në një sipërfaqe prej 1500 m², e konsideruar si qender komune, mungojnë mjediset e gjelbërta, trotuarët për kalimtarët si dhe ndriçimi i sheshit. Njëkohësisht po në këtë shesh kalojnë edhe ujrat që përdoren për vaditjen e tokave, i cili është i amortizuar. Prej kohësh nuk është investuar në këtë drejtim. Ky mjedis është i papërshtatshëm për lëvizjen e komunitetit, i cili bëhet më i vështirë në kohën dimrit. Fëmijët që frekuentojnë shkollën kalojnë në rrugët me baltë dhe shpesh me rrezik për shkak të mungesës së trotuareve dhe ndriçimit. Nevoja për përmirësimin në këtë qendër është e dukshme. Projekti është në përputhje me studimin e ZF Tropojë përsa i përket përmirësimit të kohezionit social të komunitetit.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

1. Përmirësimi i lëvizjes për banorët e fshatit Pac, qendra e komunës Bytyç nëpërmjet rregullimit të territorit, trotuareve dhe ndriçimit.
2. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për mirëmbajtjen e investimit.

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

Projekti i propozuar do të ndikojë në:

1. Trotuarë për kalimtarët, banorë të fshatit Pac dhe fshatrave të tjerë.
2. Ndriçim të përshtatshëm përgjatë trotuareve të qendrës së komunës.
3. Kanal vaditës i rikonstruktuar;
4. Mjedis të përshtatshëm dhe të kulturuar për banorët e fshatit Pac dhe banorëve të fshatrave të tjera që marrin shërbime publike pranë komunës Bytyç.
5. Banorë të kënaqur për mjediset e krijuara.

Numri i popullsisë përfituese: 400 banorë të komunës Bytyç (25% e popullsisë së komunës Bytyç; rreth 1800 banorë të fshatrave të tjera, brenda territorit të komunës Bytyç.

4. Aktivitetet e projektit

Aktivitete e projektit për realizimin e objektivave të mësipërme përfshijnë:

1. Sistemimi i sheshit të qendër komunës;
2. Ndërtimi i trotuarëve;
3. Vendosija e ndriçimit;
4. Ndërgjegjësimi i komunitetit.

Projekti do të realizohet për një periudhë 4 mujore.

5. Pjekuria e projektit

Projekti i propozuar është në fazën e një projekt ideje. Nuk ka projekte pranë komunës për sistemim rregullimin e qendrës së komunës për mungesë të fondeve. Është një nevojë jetike dhe me prioritet për këtë komunë.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Rregullimi dhe sistemimi i ambjenteve publike është funksion i drejtpërdrejtë i komunës. Si i tillë, ai do të zbatohet nga komuna Bytyç.

Financimi i projektit do të bëhet nga: Komuna, komuniteti, donatorët vendas dhe të huaj.

7. Kostot e projektit

Kosto totale e projektit është 9,800,000 lekë

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Rikonstruksioni i lulishtes “Dardania”, Bajram Curri</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ <u>Shërbime Publike</u>/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bashkia Bajram Curri</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>11,200,000 lekë</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Qyteti i Bajram Currit ka një popullsi prej 5340 banorësh, të ndarë në tre lagje përkatësisht “28 gushti”, “Dardania” dhe “Partizani”. Lagjia “Dardania”, e pozicionuar në verilindje dhe juglindje të qytetit Bajram Curri. Ajo ka rreth 3350 banorë dhe rreth 800 familje. Në këtë lagje mungojnë kushtet për një jetë të përshtatshme dhe të kulturur në komunitet. Në një sipërfaqe prej 1000 m², banorët nuk gëzojnë një mjedis sipas standarteve, pasi hapsirat publike janë në gjendje jo të përshtatshme për shkak të mungesës së buxheteve për mirëmbajtjen e tyre. Aktualisht, ka një mungesë të hapsirave të gjelbërta dhe rrugëve midis pallateve. Po ashtu, trotuaret dhe ndriçimi mungojnë. Në këtë lagje është rritur vazhdimisht edhe nevoja e vendeve të parkimit, të cilat më parë nuk janë konsideruar si mjedise të nevojshme për komunitetin. Banorët e kësaj lagje dhe sidomos fëmijët dhe të moshuarit nuk kanë vende të mjaftueshme për t’u çlodhur dhe argëtuar. Kryesisht, për fëmijët janë të pamjaftueshme këndet e lojrave dhe hapsirat për të kaluar kohën e lirë dhe pa u rrezikuar. Ka një kënd lojrash të ndërtuar në vitin 2010, por shumë I vogël. Investimet e mëparshme në këtë lagje janë të pakta. Projekti është në përputhje me studimin e ZF Tropojë për sa i përket përmirësimit të kohezionit social të komunitetit.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

Objektivat specifike përfshijnë:

1. Përmirësimi kushteve të komunitetit për çlodhje dhe argëtim në lagjen “Dardania”, qyteti Bajram Curri.
2. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e ambjenteteve publike

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

Rezultatet e pritshme të projektit përfshijnë:

1. Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta;
2. Krijimi i mjediseve të përshtatshme për lëvizjen e banorëve, ndriçimin dhe parkimin e automjeteve;
3. Rritja e sipërfaqeve çlodhëse për banorët,
4. Komuniteti i ndërgjegjësuar për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Numri i popullsisë përfituese: rreth 3350 banorë të qytetit Bajram Curri (rreth 40 % e popullsisë së qytetit Bajram Curri).

4. Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore te projektit përfshijnë:

1. Sistemimi i terrenit në një sipërfaqe prej 1000 m²;
2. Ndërtimi i trotuareve;
3. Ndriçimi i lagjeve;
4. Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe vendosja e stolave;
5. Sistemimi i vendit të parkimit;
6. Krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta;
7. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Afati i përfundimit të projektit 6 muaj

5. Pjekuria e projektit

Propozimi përfshihet në funksionet e drejtpërdrejta të bashkisë Bajram Curri. Ky propozim është në fazën e një projekt ideje.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Projekti do të realizohet nga bashkia Bajram Curri.

Financuesit e projektit përfshijnë: Bashkia, komuniteti, biznesi, donator vendas dhe të huaj.

7. Kostot e projektit

Kostua totale e projektit 11,200,000 lekë

| | |
|--------------------------------------|---|
| Titulli i projektit | <i>Ndërtimi i lulishtes “Partizani”, Bajram Curri</i> |
| Tipi i projektit | <i>Zhvillim ekonomik/ <u>Shërbime Publike</u>/ Projekte që mobilizohen shpejt</i> |
| Vendndodhja e projektit | <i>Bashkia Bajram Curri</i> |
| Buxheti total i paravlerësuar | <i>12,600,000 lekë</i> |

1. Sfondi dhe analiza e problemit

Qyteti i Bajram Currit ka një popullsi prej 5340 banorësh, të ndarë në tre lagje përkatësisht “28 gushti”, “Dardania” dhe “Partizani”. Lagjia “Partizani” e pozicionuar në pjesën veriperëndimore të qytetit ka rreth 3600 banorë dhe 840 familje. Në këtë lagje, ku banojnë rreth 43% e banorëve të qytetit Bajram Curri, mungojnë kushtet për një jetë të përshtatshme dhe të kulturur në komunitet. Në një sipërfaqe prej 1500 m², banorët nuk gëzojnë një mjedis sipas standarteve, pasi hapsirat publike janë në gjendje jo të përshtatshme për shkak të mungesës së buxheteve për mirëmbajtjen e tyre. Aktualisht, ka një mungesë të hapsirave të gjelbërta dhe rrugëve midis pallateve. Po ashtu, trotuaret dhe ndriçimi mungojnë. Në këtë lagje është rritur vazhdimisht edhe nevoja e vendeve të parkimit, të cilat më parë nuk janë konsideruar si mjedise të nevojshme për komunitetin. Banorët e kësaj lagje dhe sidomos fëmijët dhe të moshuarit nuk kanë vende të përshtatshme për t’u çlodhur dhe argëtuar. Kryesisht, për fëmijët mungojnë këndet e lojrave dhe hapsirat për të kaluar kohën e lirë dhe pa u rrezikuar. Investimet e mëparshme në këtë lagje pothuaj nuk ekzistojnë më. Projekti është në përputhje me studimin e ZF Tropojë përsa i përket përmirësimit të kohezionit social të komunitetit.

2. Objektivi/at specifikë të projektit

Objektivat specifike përfshijnë:

1. Përmirësimi kushteve të komunitetit për çlodhje dhe argëtim në lagjen “Partizani”, qyteti Bajram Curri.
2. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e ambjenteve publike

3. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit

Rezultatet e pritshme të projektit përfshijnë:

1. Sipërfaqe të gjelbërta të shtuara;
2. Mjedis të përshtatshme për lëvizjen e banorëve, ndriçimin dhe parkimin e automjeteve;
3. Sipërfaqe çlodhëse të shtuara për banorët,
4. Komunitet i ndërgjegjësuar për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Numri i popullsisë përfituese: rreth 3600 banorë të qytetit Bajram Curri (rreth 43 % e popullsisë së qytetit Bajram Curri).

4. Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore te projektit përfshijnë:

1. Sistemimi i terrenit në një sipërfaqe prej 1500 m²;
2. Ndërtimi i trotuareve;
3. Ndriçimi i lagjeve;
4. Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe vendosja e stolave;
5. Sistemimi i vendit të parkimit;
6. Krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta;
7. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Afati i përfundimit të projektit 6 muaj

5. Pjekuria e projektit

Propozimi përfshihet në funksionet e drejtpërdrejta të bashkisë Bajram Curri. Ky propozim është në fazën e një projekt ideje.

6. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit

Projekti do të realizohet nga bashkia Bajram Curri.

Financuesit e projektit përfshijnë: Bashkia, komuniteti, biznesi, donator vendas dhe të huaj.

7. Kostot e projektit

Kostua totale e projektit 12,600,000 lekë

8. PËRSHKRIMI I STRUKTURAVE DHE PROCESIVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË ZONËS: ORGANIZIMI I QEVERISJES LOKALE PAS REFORMËS TERRITORIALE-ADMINISTRATIVE

Bazuar në reformën territoriale-administrative, Zona Funktionale Tropojë korrespondon me një Njësi Vendore e cila do të përmbledhë të tetë NJQV-të aktuale të rrethit të Tropojës me bashkinë Bajram Curri në qendër të saj. Bazuar në eksperiencën lidhur me funksionimin e modeleve të deritanishme si dhe në kontributin e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në zbatimin e reformës territoriale-administrative, është sugjeruar një organogramë e Bashkisë së re të Bajram Currit që bazohet në strukturën aktuale të Bashkisë Bajram Curri duke integruar struktura të reja të nevojshme për të siguruar zhvillimin ekonomik dhe pëmirësimin e shërbimeve publike në të gjithë territorin e ZFT.

Struktura e re e ZFT do të mbështetet në strukturat ekzistuese të NJQV-ve, duke marrë për bazë bashkinë e Bajram Currit dhe strukturën tipike organizative të komunave. Ajo synon integrimin e strukturave të mëparshme duke ju përgjigjur funksioneve të qeverisjes lokale sipas ligjit.


Aktualisht bashkia e Bajram Currit ka strukturën më të plotë dhe është e organizuar në seksione, ndërsa komunat në zyrë/sectorë. Në kushtet e një njësie vendore më të madhe dhe përmbledhëse të njëjësive ekzistuese vendore, sugjerohet që struktura e re organizative e bashkisë Bajram Curri të ngrihet në një nivel më të lartë, në nivel drejtorish.

Pas zgjedhjeve lokale, bashkia Bajram Curri mund të organizohet në 9 drejtori kryesore—shërbimet mbështetëse, shërbimet publike, planifikimi territorit, ndihma ekonomike, zhvillimi ekonomik, arsimit dhe kultura, të ardhurat, politikat dhe planifikimi strategjik, dhe juridike--të cilat lidhen me funksionet kryesore. Gjithashtu përfshihen edhe njësi për marrëdhëniet me njësitë administrative, policia bashkiake, njësi e auditit dhe policia bashkiake.

Cdo drejtori ka disa sektorë, që lidhen me funksione më specifike. Çdo sektor lidhet me seksionet ekzistuese në bashkinë e Bajram Currit dhe ka të shtuara funksione për sektorë që kanë gene karakteristikë të komunave dhe territorit rural. Në strukturën e re organizative, theksohet zhvillimi ekonomik, sidomos bujqësia dhe turizmi, dhe zhvillimi i plotikave dhe planifikimit strategjik. Gjithashtu synohet ofrimi i shërbimeve për të gjithë popullsinë e zonës funksionale. Zhvillimit social do t'i kushtohet vemendje për të rritur cilësinë e jetës shoqërore në territorin e ZFT. Gjithashtu ndryshimet që sugjerohen kanë të bëjnë me rritjen e efektivitetit të punës së njësisë së re vendore. Në këtë kuadër, do të jetë edhe sektori i marrëdhënieve me donatorët dhe projektet do të merret me hartimin dhe zbatimin e projekteve bazuar në planet strategjike.

Në këtë strukturë do të jenë disa sektorë që lidhen si me monitorim dhe auditin, sigurinë publike/policia bashkiake, zyrë e informimit me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivat, të cilat kanë funksione të pavarura dhe në shërbim të gjithë qeverisjes lokale. Gjithashtu, nga kjo strukturë do të menaxhohen edhe funksionet e deleguara (QKR+QKL, Gjendja Civile).

Për përmbushjen e funksioneve kryesore, është e nevojshme të shtohet personeli i specializuar sipas departamenteve. Organograma që sugjerohet për bashkinë e re të Bajram Currit është paraqitur në vazhdim.



Struktura e mundshme organizative e Bashkisë Bajram Curri

9. PROCESI I PREGATITJES SË PROGRAMIT TË ZONËS FUNKSIONALE TROPOJË

Procesi i përgatitjes së programit të Zonës Funktionale Tropojë kaloi nëpër disa faza kryesore përfshirë:

1. Krijimin e Forumit të Zonës Funktionale Tropojë;
2. Grumbullimin e të dhënave dhe analizën e tyre;
3. Zhvillimin e draftit të studimit mbi zhvillimin ekonomik, shërbimet publike, dhe organizimin e qeverisjes lokale në Zonën Funktionale Tropojë;
4. Diskutimet me Forumin lidhur me draftin e studimit dhe reflektimi i sugjerimeve të tyre në studimin përfundimtar;
5. Zhvillimi i vizionit të ZFT dhe projekt-ideve lidhur me zhvillimin ekonomik dhe shërbimet publike.

Krijimi i Forumit të ZFT

Forumit të ZFT u krijua në shtator 2014 pas komunikimit të vazhdueshëm me aktorë lokalë dhe identifikimit të anëtarëve potencialë. 19 vetë që përfaqësojnë bashkinë Bajram Curri, komunat Tropojë, Bytyç, Fierzë dhe Bujan, institucionet e de-koncentruara (Seksioni i Arsimit dhe Bujqësisë), shoqërinë civile (Integrimi, Grupi Lokal i Veprimit Bjeshtet e Nemuna, dhe Alpin) dhe biznesin i janë bashkuar Forumit. Kontributi i koordinators lokal, i identifikuar bazuar në eksperiencën e bashkëpunimit të mëparshëm dhe angazhimin lokal, ka qenë thelbësor për realizimin me sukses të aktiviteteve të Forumit dhe studimit mbi ZFT.

Grumbullimi i të dhënave dhe analiza e tyre

Aktivitetet kryesore të realizuara në kuadrin e mbledhjes së të dhënave përfshijnë kërkim në zyrë dhe intervistat individuale dhe të grupit (fokus). Të dhënat u mbledhën nga dokumentet kryesore ekzistuese përfshirë Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut të Kukësit, Planet Strategjike të Bajram Currit, Margegajt dhe Tropojës, Draftin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit (2014-2020), Censusin e vitit 2011, dhe statistikat lokale (nga NJQV-të, Seksioni i Bujqësisë, Seksioni i Arsimit, Seksioni i Shendetësisë, dhe QKR). Gjithashtu u përdorën faqet e internetit të Qarkut Kukës, INSTAT, Ministrisë së Turizmit dhe Planifikimit Urban, të dhënat nga dldp dhe organizata të tjera partnere, etj. Me rëndësi të veçantë për grumbullimin e të dhënave ishin takimet/intervistat individuale me aktorë të rëndësishëm lokal dhe me grupe fokus—me punonjes të NJQV-ve përgjegjës për shërbimet publike, specialistët e bujqësisë, specialistët e turizmit—dhe takimet e forumit. Të dhënat e grumbulluara u analizuan për të vlerësuar gjendjen dhe parë tendencat kryesore dhe zhvilluar një draft të pare të studimit mbi Zonën Funktionale Tropojë.

Zhvillimi i draftit të studimit mbi zhvillimin ekonomik, shërbimet publike, dhe organizimin e qeverisjes lokale në Zonën Funktionale Tropojë

Bazuar në të dhënat e grumbulluara dhe analizën e tyre, u zhvillua drafti i Studimit mbi ZFT. Studimi u përqëndrua në çështjet e zhvillimit ekonomik, veçanërisht bujqësinë dhe turizmin malor, gjendjen e shërbimeve publike dhe hapat për përmirësimin e tyre, dhe organizimin e qeverisjes lokale.

Diskutimet me Forumin lidhur me draftin e studimit dhe reflektimi i sugjerimeve të tyre në studimin përfundimtar

Përveç diskutimeve individuale dhe komunikimit në formë elektronike me pjesëtarë individuale të Forumit lidhur me studimin, një takim i veçantë i Forumit të ZFT u organizua për të diskutuar mbi studimin për plotësimin e të dhënave të paraqitura dhe përmirësimin e studimit në tërësi. Sugjerimet e pjesëmarrësve u pasqyruan në studimin përfundimtar mbi ZFT.

Zhvillimi i vizionit të ZFT dhe projekt-ideve lidhur me zhvillimin ekonomik dhe shërbimet publike

Konkluzionet dhe rekomandimet nga studimi mbi gjendjen ekonomike në ZFT dhe zhvillimin e ardhshëm ekonomik, gjendjen e shërbimeve publike dhe përmirësimin e tyre në të ardhmen, dhe organizimin e qeverisjes lokale u përdorën për zhvillimin e vizionit të ZFT dhe 17 projekt-ideve për zhvillimin ekonomik (6) dhe shërbimet publike (11). Identifikimi dhe zhvillimi i vizionit dhe projekt-ideve ishte fryt i punës së përbashkët me koordinatorin lokal dhe anetarë të Forumit të ZFT. Një takim i veçantë i Forumit u organizua për diskutimin e projekt-ideve dhe vizionit të ZFT. Sugjerimet e pjesëmarrësve u reflektuan në dokumentin përfundimtar të studimit.

ANEKSE*Analiza SWOT për sektorin e bujqësisë*

| Pikat e forta | Pikat e dobta |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Bujqësia është një nga sektorët potencial më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Tropojës. • Tokë pjellore dhe e përshtatshme për pemëtari dhe vreashtari. • Burime ujore për të mbuluar nevojat e bujqësisë për ujitje. • Zhvillimi i frutikulturës (gështenja, kumbulla, molla, etj.). • Kultivimi i bimëve të arave me destinacion blegtorinë. • Bimë mjeksore dhe aromatike të shumëllojshme. • Traditë dhe kushte natyrore—kullota të bollshme në bjeshkë--për zhvillimin e blegtorisë. • Ka kushte të favorshme për mbarështrimin e llojeve të ndryshme të blegtorisë (dhëntë e dhitë, gjedhë për mish, bletari, etj.). • Bujqësia factor nxitës për zhvillimin e turizmit veror dhe dimror. • Bimët medicinale dhe eterovajore ndodhen me shumicë në rrethin Tropje | <ul style="list-style-type: none"> • Niveli kulturor dhe profesional i specialistëve dhe fermerëve në rrethin Tropojë. • Aftësi ujitëse të pamjaftueshme, kanale ujitëse të vjetëruara, dhe kapacitet i pamjaftueshëm i shoqatave të përduesve të ujit. • Mekanizimi bujqësor i pamjaftueshëm. • Burime financiare të pamjaftueshme. • Kreditë e buta mungojnë për fermerët. • Sipërfaqe e vogël e pronës për fermer. • Mungesa e qendrave të përpunimit të fruta perimeve. • Mungesa e përpunimit të qumshtit dhe mishit (baxho, thertore, punishte përpunimi mishi, etj.). • Mungesa e impjanteve të përpunimit të bimëve mjeksore. • Mungesa e kryerjes së shërbimeve në kulturën e gështenjës. • Burime njerëzore të pamjaftueshme dhe të pakualifikuara për bujqësi dhe blegtori. • Mungesa e depove frigoroferike. • Mungesa e dëshirës për të punuar në bujqësi. • Mungesa e tregjeve për tregëtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale të zonës. • Mungesa e planeve lokale të zhvillimit. |

| Mundësitë | Pengesat |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Kullota natyrore që mund të mbështesë dyfishn e krerëve të blegtorisë. • Terren i favorshëm për kultivimin e llojeve të ndryshme të bimëve të arave, pemëve frutore, bimëve medicinal. • Kushte të favorshme për kultivimin e bimëve medicinale dhe aromatike. • Vëmendje në rritje e qeverisë qendrore dhe agjensive të zhvillimit dhe donatorëve ndaj zonave malore. • Bashkëpunimi ndërkuftar dhe rajonal. • Vendndodhja, afërsia me Kosovën dhe Malin e Zi. | <ul style="list-style-type: none"> • Emigrimi dhe migrimi i brendshëm. • Mungesa e burimeve financiare. • Mungesa e fuqisë puntore. • Formalizimi i pronës mbi token bujqësore. Mos-azhornimi i plotë i pronësisë mbi tokën. • Formalizimi i pronësisë mbi masivet e gështenjës. • Infrastruktura e dobët për një numër të madh të fshtreve të largët. • Mungesa e organizimeve lokale (shoqata, etj.) për fermerët në bujqësi dhe blegtori. • Pengesa ligjore/fiskale për shkëmbimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale me Kosovën. • Vështirësi në transportin e produkteve drejt qendrës së Shqipërisë për shkak të distancës dhe kostove të larta. |

| Pikat e forta | Pikat e dobta |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Shumëllojshmëria e turizmit <ul style="list-style-type: none"> ○ malor, ○ kulturor, ○ lumor, ○ kurativ, ○ alpin, ○ familjar, ○ etnografik, etj. • Restorante tradicionale (lidhur me arredimin) • Gatime tradicionale <ul style="list-style-type: none"> ○ maza e zier, ○ leqenik, ○ fli, ○ buk n'dorë, ○ bukë çerepi, ○ çorbë, ○ pite, etj • Ka interes për të investuar në turizëm. • Interesi i emigrantëve për tu kthyer në vendin e tyre. • Numri i turistëve të vendit dhe të huaj--gjermanë, çek, zviceran, anglezë, amerikan—dhe nga Kosova ka ardhur duke u rritur çdo vit. • Ka destinacione të mundhsme turistike që nuk janë të njohura dhe shfrytëzuara. • Në përgjithësi, nuk ka ndërtime të betonuara; Shumica e ndërtimeve kanë ndjekur traditën. • Ekzistenca e rrugëve relativisht të mira për të shkuar në destinacionet turistike. | <ul style="list-style-type: none"> • Turizmi nuk është i orientuar (i zhvilluar kryesisht në baza të inisiativës dhe mendimit individual) • Promovim i dobët i turizmit (guidat, hartat, zyrat turistike, etj. të pamjaftueshme, informacion i pamjaftueshëm në internet) • Turizmi lumor nuk është shfrytëzuar • Mungesa e zyrave turistike në tërë territorin e rrethit: Ka vetem një zyrë turistike në Valbonë. • Mungon sinjalistika turistike e mjaftueshme. • Mungesa e menaxhimit të mbetjeve në zonat turistike si dhe në qendrat e banuara. • Dëmtimi i pyjeve. Prerja e pakontrolluar e pyjeve. • Gatimet tradicionale nuk po trashëgohen tek brezat e tjerë e shoqeruar me tendencën për gatime të huazuara nga kuzhina të tjera. • Niveli i ulët i shërbimit për turistët dhe vizitorët në përgjithësi në hotele, bujtina, bar-restorante, etj. • Kapacitete të pamjaftueshme për shërbime turistike, sidomos në kuadrin e tendencës në rritje të numrit të vizitorëve. • Mungesa e kapaciteteve njerëzore lidhur me ekonominë e tregut (menaxhimin efektiv të bizneseve të turizmit). • Mos-azhurnimi i plotë i pronësisë mbi tokën. |

| Mundësitë | Pengesat |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura rrugore e përshtatshme për të shkuar në pikat turistike. • Energjia elektrike në Valbonë është e rregullt. • Fauna (trofta, kaprolli, ujku, dhia e eger, macja e eger, ariu) dhe flora e pasur (boronica, blini, “ilaçi i zemres”, etj.) • Terreni i përshtatshëm për ski (Ceremi, Valbona, Padeshi, Liqeni i Ponarëve). • Zonat e mbrojtura--Parku kombëtar Valbonë, Parku Natyror Lekbibaj. • Koridoret turistike: Tropojë-Kosovë-Shkodër (Bjeshkët e Nëmuna). • Bashkëpunimi ndërkuftar dhe rajonal. • Vendndodhja, afërsia me Kosovën dhe Malin e Zi. | <ul style="list-style-type: none"> • Mungon infrastruktura rrugore në zonat të ndryshme me potencial turistik si Liqeni i Ponarëve, Vargmali i Bjeshkëve. • Energjia elektrike jo e garantuar (veçanërisht në dimër) në disa zona të Tropojës me potencial në zhvillimin e turizmit. • Mos-mbulimi i plotë i Luginës së Valbonës (dhe destinacioneve të tjera potenciale turistike) nga operatorët celularë. • Bllokimi i lejeve të ndërtimit. • Nuk ka kreditim të sektorit në kushte favorizuese (nuk ka mbështetje të mjaftueshme nga shteti për iniciativat në fushën e turizmit; Kreditimet private janë me interesa të larta). • Mentaliteti i banorëve për zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit. |

| Pikat e forta | Pikat e dobta |
|---|--|
| <p><i>Shërbimi: Furnizimi me ujë të pijshëm</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me ujë të pijshëm që bëhet pjesërisht për shumicën e Njësave Vendore (Bashkia Bajram Curri dhe komunat Margegaj, Bujan, LLugaj dhe Tropojë) • Burimi i furnizimit nga ujësjellësi i Valbonës. • Është në funksionim linja kryesore, ndërsa rrjeti i brendshëm për komunën Margegaj dhe në qytet është ndërtuar pjesërisht. Në komunën LLugaj ka filluar projekti por ka mbetur për fonde. • Komunat Bytyç, Fierzë dhe Lekbibaj kanë burime ujore të mjaftueshme. | <p><i>Shërbimi: Furnizimi me ujë të pijshëm</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me ujë të pijshëm për komunitetin është i pamjaftueshëm (në qytet 2-3 herë në ditë me nga 1 orë, ndërsa në komuna 1 herë nga 1 orë, çdo familje ka depositë si në fshat dhe qytet) • Shkollat nuk kanë ujë të pijshëm. • Në Komunat Fierzë dhe LLugaj ujësjellsi funksionon me pompë ngritje që kërkon shumë energji elektrike (që bën që kosto të jetë e lartë). • Ujësjellsi i Bashkisë së Bajram Currit është jo funksional (menaxhim i dobët, mungojnë matësat në masën 60%). • Mungojnë mjetet financiare për ujësjellsin në komunat Bytyç dhe Fierzë. • Burimi aktual nuk është i mjaftueshëm për furnizimin me ujë në periudhën e verës. • Mungojnë specialistët, inxhinjerët hidro për ujësjellsin. • Niveli i arkëtimeve për furnizimin me ujë është problem i madh. • Ndërmarrja e ujësjellësit me aksione të përbashkëta me bashkinë nuk rezulton efektive. |
| <p><i>Shërbimi i pastrimit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendgrumbullimi i mbetjeve ekziston | <p><i>Shërbimi i pastrimit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Në brendësi të lagjeve të qytetit nuk ka kosha të vegjël. • Mungon përpunimi i mbeturinave. • Në zonat rurale mungojnë vendgrumbullimet dhe koshat. • Nuk bëhet klasifikimi i mbetjeve për shkak të mungesës së koshave. • Mungon transporti i mbeturinave me mjete shkarkuese. • Mungojnë kanalet e ujrave të zeza dhe gropat septike në komuna. • Ujrat e zeza derdhen në lumenj. • Kolektori i qytetit për ujrat nga rreshjet nuk është përfunduar për shkak të mungesës së fondeve. • Bashkia ka si vend grumbullimi një gropë natyrale. |
| <p><i>Shërbimi i gjelbërimit</i></p> | |

| | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Tre lagjet e qytetit Bajram Currit janë pjesërisht të rregulluara. • Në komuna nuk ka kënde lojrash, gjelbërim dhe vende çlodhje. | |
| Mundësitë | Pengesat |
| <p><i>Shërbimi: Furnizimi me ujë të pijshëm</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka vendburime ujore • Ka vullnet për bashkëpunim ndërvendor | <p><i>Shërbimi: Furnizimi me ujë të pijshëm</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka mungesë investimesh • Niveli i ulët ekonomik |
| <p><i>Shërbimi i pastrimit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Në komuna ka sipërfaqe të mundëshme për vendgrumbullimin e mbetjeve | |